


Vangjel S. Kule  
KRONIKË  
E NJË  
JETE

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

814-32

K 78



81432

K98.

VANGJEL S. KULE

# KRONIKË E NJË JETE

(Tregim për Heroin e Popullit Hajdar Tafa)



21083

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»

Lexova dokumentat e partisë të Hajdar Tafës, relacionin e komandës së Brigadës së Sigurimit të Shtetit mbi rrethanat e vrasjes së tij, motivacionin e Kuvendit Popullor që e shpalli Hero të popullit dhe materiale të tjera, por, për të shkruar mbi jetën e veprimtarinë e Hajdarit, ato ishin të pamjaftueshme.

Shkova në Goriçan, në fshatin e Hajdarit. U njoha me njerëzit e afërm të tij. Mësova për fëmijërinë e heroit, vuajtjet e dikurshme nga çifligari dhe gehallarët. Aty u informova për një shokun e Hajdarit, me të cilin ai kishte kaluar së bashku periudhën e lavdishme të Luftës nacionalçlirimtare. E quajnë Ali. Është nga fshati Vloshëm i Fierit.

Xha Murati, i ati, me atë fytyrën e rreshkur nga pleqëria, më vështroi e buzëqeshi.

— Sikur nuk po të mban vendi, — më tha dhe shkundi mbi tavëll hirin e cigares.

— Më duhet të shkoj patjetër.

Xha Murati vështroi në mënyrë kuptimplote nga e shoqja dhe tha:

— Aliut do t'i çoj lajm të vijë këtu...

— Duam ta shikojmë edhe ne, se e kemi në vend të Hajdarit, — u hodh në çast Lemja.

Të nesërmen në drekë Aliu erdhi në Goriçan. Ishte një mesoburrë me fytyrë të hequr dhe me pak mustaqe, që i nxinin në buzën e sipërme. Kur e pashe për herë të parë, tek hyri në dhomën e madhe



të shtëpisë së xha Muratit, të them të drejtën, pata një dridhje të lehtë, sepse atë çast m'u duk sikur vetë Hajdari, për të cilin do të shkruaja kallëzimin tim, erdhi aty nga thellësia e viteve për të biseduar me mua. Kjo ishte përshtypja e parë që m'u krijua, ndoshta edhe nga fakti që xha Murati e të tjerë më folën gjatë për të dhe për shoqërinë që kishte me Hajdarin.

— Ja, ku e ke! Besoj se unë bëra aq sa kisha mundësi. Ky do të të njohë me jetën e Hajdarit më mirë se kushdo tjetër.

Këto fjalë tha xha Murati kur, pasi ishim përsëndetur me Alinë, ky i fundit u ul në karrige pranë meje dhe nxori paqetën. Mori një cigare, e vuri në buzë dhe nisi të kërkonte shkrepjen. Xha Murati i zgjati menjëherë një çakmak të vjetër me kapak bronci.

— Ndize me këtë timen, or bir, se këto të shkreta nuk të lënë kurrë në baltë, — tha ai dhe qeshi. Rrudhat e fytyrës iu thelluan edhe më tepër. Aliu vështroi me përmallim plakun dhe psherëtiu.

Kur i shpjegova se çfarë kërkoja, fytyra i mori një pamje të gëzuar. Ai dëgjonte me vërejtje kur unë i tregoja se ç'kisha lexuar në biografinë e Hajdarit.

— Të gjitha ashtu janë, si i ke lexuar, — tha më në fund, — por unë do të flas për Hajdarin, ashtu si e kam njohur. Dhe nuk e kam njohur pak. — Pasi heshti një çast, nisi të më tregonte.

Më 25 korrik 1944 kompania jonë ndodhej në fshatin Karkanjos. Qemë grumbulluar nën hijen e një arre të madhe. Unë dhe Hajdari kishim pesë ditë që ishim radhitur në rreshtat partizane. Si të rinj dhe djem fshati, që gjithë kohën e kishim ka-



luar duke kullotur bagëtinë, rrinim pak të drojtur..

Komisari i kompanisë u ngrit në këmbë. Grykën e këmishës e kishte zberthyer nga vapa përvëluese. Ai nisi të na fliste për luftën dhe për fitoret e ushtrisë partizane kundër forcave gjermane dhe të Ballit, pastaj na tregoi për qehajanë e fshatit dhe e përfundoi bisedën me këto fjalë:

— Gjyqi partizan i batalionit nuk pati mëshirë për qehajanë. Krimet që kishte bërë i pagoi me kokë. Ja, kështu do të veprohet me të gjithë ata, që u kanë vringëllirë armët fshatarëve...

Pasi mbaroi mbledhja, u shtrimë me Hajdarin dhe për një çast nuk folëm. Duke vështruar drejt qiellin, dëgjova që ai psherëtiu.

— Të vjen mall për njerëzit e shtëpisë? — e pyeta.

— As më thua, komisari qytetar është apo fshatar?

— Ka qenë çirak te një këpucëbërës, — iu përgjegja i sigurt, se dy ditë më parë e kisha dëgjuar duke folur me atë partizanin që bënte edhe punën e opingarit në kompani.

— Me ato që na tha, më kujtoi brengat e mia, që më kanë mbetur ende të gjalla. — dhe ai psherëtiu përsëri. — Kam lindur në fshatin Banaj. Prej andej na përzuri Xhevdet Beu që e kishte çiflikun e tij dhe ne u detyruam të vendoseshim në Goriçan-Pasha, në çiflikun e Beut. Kur u shpërngulëm e morrëm rrugën e muhaxhirrllëkut, unë isha ende në djep, por ato që kanë vuajtur njerëzit e shtëpisë, i di të gjitha, se, kur vjen fjala, ata i tregojnë me urrejtje. Pastaj, kur u bëra i zoti i vetes dhe prindërit më dhanë kopenë e deleve, që ishte përgjysmë me çifligarin,

gjithë-gjithë njëzet kokë, njoha qehajabashin ogurzi. Gjyshi, që atëhere ishte gjallë dhe babai, më porositën disa herë që delet t'i ruaja me kujdes, se çdo e keqe që do të ndodhte në kope, në radhë të parë do të rëndonte mbi shtëpinë tonë.

Kur vura kopenë përpara, isha shend e verë. Kujdesesha aq shumë për delet sa gjyshi, xhaxhallarët dhe babai e kishin të mbledhur mendjen.

Midis qingjave zgjidhja më të rriturin, më të bukurin dhe e mësoja manar. Por dora e qehajabashit m'i rrëmbente manarët për çdo vit dhe ia dërgonte beut. Qaja me të madhe, por ai as që donte t'ia dinte për lotët e mi. Kështu na e bënte qehajabashi edhe kur korrej gruri e misri. Djalli! I numëronte demekët e grurit e togjet e misrit dhe aty, sy për sy, i shtonte ato, që të na rrëmbente sa më shumë.

Kur partizanët filluan luftën kundër fashistëve, qehajai ynë nuk linte fjalë të keqe pa nxjerrë nga goja. Në fshat askush nuk i besonte, se të vërtetën ata e mësonin kur shkonin në Berat, për pazar. Nuk vonoi dhe qehajai, me dyfekun në sup, nisi të përralliste për luftën kundër të huajit, por, ama, që kjo luftë të bëhej kur të vinte koha. Në kokë kishte ngjeshur një qylaf të bardhë me një shqiponjë e thoshte: «Shqipëria e Shqiptarëve! Vdekje tradhëtarëve!». Kështu ai u radhit në rreshtat e Ballit Kombëtar dhe rrinte me fashistët italianë e më vonë me gjermanët te ura e Hasan Beut. Tani, o Ali, që pushkën e kam hedhur në sup... — dhe fjalën e ndërpreu.

— Kompania të grumbullohet, — u dëgjua zëri i komandantit.

U vumë në rresht. Por ne dalloheshim nga par-



tizanët e tjerë, pasi ishim nga më të lekosurit, ashtu siç jetonim në fshat.

Komandanti na urdhëroi të dilnim nga rreshti.  
— Shkoni te intendenti të visheni, se qenkeni me fat. Ai është atje te ajo kasollja, — dhe na e tregoi me dorë.

Me trup isha ca i shkurtër dhe në fytyrë i rrumbullakët, ndërsa Hajdari i gjatë e i hollë, fytyrëhequr.

Veshëm rrobat verore gjermane dhe vështruan duke buzëqeshur njëri-tjetrin. Pastaj vrapuam të zinin kompaninë që kishte nisur rrugën në varg. Pasi ecëm ndonjë orë, u dha urdhëri për pushim. Hajdari hoqi këpucën. Gishtat e këmbës dhe thembra i qenë skuqur.

— Të paska dërmuar, — i thashë.

— Do hapen, do hapen, — tha ai dhe e futi këmbën përsëri në këpucë.

Në të perënduar të diellit, të katër kompanitë e batalionit të rinisë u grumbulluan. Gati të gjithë ishim të një moshe. Partizanët e partizanet ia nisën këngës. Ne të dy rrinim e vështronim me habi ata që ishin aq të gëzuar. E vërteta ishte se edhe neve na e kishte qejfi të këndonim, por ja që diçka e brendshme, ndoshta mbeturinë e asaj jete të mbyllur që patëm kaluar, ngrinte kokën e nuk na linte, sidomos përpara shoqeve.

Atë natë kompania jonë mbeti në fshat dhe ne u ndamë në baza. Në shtëpinë e parë, në të hyrë të fshatit, komandanti caktoi Remziun, skuadërkomandantin, Letën, përgjegjësen e rinisë së kompanisë, Shqiponjën, infermieren, Lonin, që kishte mitralozin e lehtë, së bashku me ndihmësin dhe ne të dy.

I zoti i shtëpisë na futi brenda dhe, sa u ulëm,



na uroi mirëseardhjen. Në krye u ul Remziu, në anën tjetër Loni, kurse ne të tjerët në fund. Leta me Shqiponjën shkuan në dhomën ku ishin gratë.

Remziu ishte nga Skrapari, partizan prej një viti e gjysmë. Kur ishte në çetat e Skraparit, si edhe më vonë, kishte marrë pjesë në shumë luftime, kështu që vendet i dinte me pëllëmbë. Loni kishte hyrë në rreshtat partizane në janar të vitit 1944 dhe kishte dhënë prova trimërie, prandaj edhe i qe besuar mitralozi i lehtë. Rrapushi, ndihmësmitralieri, ishte partizan prej afër tre muajsh.

Biseda me të zotën e shtëpisë shkoi shtruar. Remziu tregonte për luftimet që ishin zhvilluar.

— Mirë ua keni bërë të mallkuarve, — tha i zoti i shtëpisë. — Edhe vëllai im ka dalë partizan. Po bën muajin e dytë që ka shkuar dhe nuk e di se ku ndodhet. — Pastaj na vështroi mua dhe Hajdarin dhe vuri buzën në gaz.

— Po këta qenkan bërë tamam gjermanë! I paskan të gjitha të reja, veç strehet e kapeleve u kanë mbuluar fytyrën, — tha.

— I kemi partizanë të rinj. Nga shtëpia erdhën të leckosur, sa dhe qeni nuk kishte ku t'i kapte. Po ja që na u ndodhën gjermanët. Ua zumë para dy javësh në depo. Me rrobat e armët e tyre do të pajisim shokët tanë gjersa ta shporim këtë racë të egër.

— Drejt e ke, ashtu është. Po ju, more shokë, nga ju kemi? — na u drejtua i zoti i shtëpisë.

— Këtej nga këto anë, — i thashë.

Atë çast hyri Leta.

— Më jepni kapat t'u qepim nga një yll, — tha ajo dhe zgjati dorën drejt nesh. U vështroam sy në sy me Hajdarin, pastaj hoqëm kapat dhe ia dorëzuam Letës, që sakaq kaloi në dhomën tjetër.

— Vajzat u bënë trime, më u lumtë! — tha i zoti i shtëpisë.

— Trime që ç'ke me të, — i tha Remziu. — Leta në operacionin e qershorit u plagos në pulpën e majtë dhe, megjithatë, as që do t'ia dijë. Po të jesh në krah me të, duhet të kesh kujdes se të turpëron, aq trime është. Madje komisari i batalionit e ka këshilluar të mos hidhet në sulm e të mos shkojë përpara e larg shokëve. Unë, në një farë mase, i jap të drejtë Letës. Ka mbetur e vetme në këtë botë. Gjermanët i kanë vrarë babanë e të dy vëllezërit. Nëna i ka vdekur dy muaj të shkuara nga plagët që kishte marrë atë ditë që i vranë burrin e djemtë.

— Paska të drejtë, — shtoi i zoti i shtëpisë.

Remziu vazhdoi:

— Ajo kërkon të hakmerret kundër gjermanëve, pa llogaritur vdekjen. Një ditë e pyeta se si i bënte zemra që qeshte dhe këndonte. Po a e dini se si m'u përgjegj? «Lufta është ajo që do të na shpëtojë. Kur të vendosim pushtetin tonë e të jetojmë në liri, ata që kanë vdekur do të gëzojnë aqsa edhe të gjallët. Kjo është ajo që më jep forcë të luftoj e të mos e peshoj edhe jetën».

— Qenka plot mend, i lumtë! — tha i zoti i shtëpisë dhe u ngrit të merrte ibrikun e legenin që ishin në fund të dhomës.

— Lëre, mos u mundo, se i lajmë vetë duart. — foli Remziu dhe u ngrit në çast.

U shtrua darka. Në mes të sofrës ishte një tas me gjizë të skuqur, një tenxhere me dhallë dhe qepë. Erdhën Leta dhe Shqiponja, të cilat, ndërkaq, kishin qëndisur nga një yll të kuq në kapelet tona. Kur i vumë në kokë, Hajdarit i shndriti fytyra dhe më



pa sikur donte të më thoshte: «Tani, o Ali, u bëmë  
tamam partizanë».

— Vdekje fashizmit! — tha Remziu dhe vështroi  
nga ne.

— Liri popullit! — u përgjegjëm ne, kurse Haj-  
dari brofi në këmbë. Të gjithë ia plasën gazit.

Pas darke Shqiponja lexoi komunikatën e Shta-  
bit të Përgjithshëm mbi fitoret e brigadave kundër  
forcave gjermane e të Ballit. Pastaj nisi përsëri bi-  
seda.

— Nga sa klasë shkollë keni? — pyeti Leta.

— Në fshatin Goriçan nuk ka pasur shkollë, —  
u përgjegj Hajdari dhe uli sytë i pezmatuar.

— Po ti, Ali?

— Pa shkollë jam, — i thashë me gjysmë zëri.

Ajo përdrodi buzët me pakënaqësi, por shpejt  
qeshi dhe tha:

— Besoj se nuk do t'ju mungojë vullneti për të  
mësuar. Doni të mësoni?

— Si nuk duam! — iu përgjegjëm njëzëri.

— Do të flas nesër me komisarin dhe do të mun-  
dohem të gjej abetare e fletore që t'ia fillojmë sa  
më parë. Duhet të fitojmë kohën e humbur.

\*  
\* \* \*

— Si partizanë të rinj, ne u vumë përpara shumë  
detyrash, që kërkonin punë e mund. Më urgjente ish-  
te të mësonim taktikën e luftës partizane, të njih-  
nim e të përdornim armët, të bëheshim qitës të mirë,  
të hidhnim bombat e granatat.

Remziu ishte i palodhur në punë dhe i rreptë.



Ai na fliste për format e luftimeve, duke na e konkretizuar me episode të ndryshme. Më në fund e mësuam përdorimin e armëve.

Krahas me këtë detyrë të lodhshme, bashkë me Letën uleshim çdo pasdite në hijen e pemëve dhe fillonim të mësonim shkrim e këndim. Kur filluam të shkruanim gërmat e para, na dridheshin duart dhe mezi mundëm t'i stisnim dy a tri të sakta. Leta qeshte me ato krabat tona. Hajdari e vështronte, ulte kokën dhe niste t'i shkruante për së dyti e për së treti, por megjithatë, gërmat i bënte për faqe të zezë.

— Ja kështu, — i thoshte Leta dhe me dorën e saj merrte dorën e tij që mbante lapsin dhe së bashku shkruanin gërmën «a».

— Tani do ta shkruaj vetë, se e mësova, — hidhej pas pak Hajdari, dhe me kujdes, po shumë ngadalë, hiqte vizat. Këtë punë bënte ajo edhe me mua, pa u mërzhitur. Me durimin e shembëllin e saj, ajo na vuri në sedër aq shumë, sa, kur gjenim rast, nxirrnim abetaret, lexonim pjesën e këndimit, pastaj ushtrojmë dorën në të shkruar.

Në kompani për çdo ditë mësonim gjëra të reja. Aty përpara syve tanë, me tri batanie e me drunj u bë një si skenë.

Dalëngadalë partizanët u grumbulluan aty përreth. Po vinin edhe burrat e djemtë e fshatit.

— Komisari, duket, do të mbajë fjalë, — më tha Hajdari, duke vështruar shokët që po vendosnin çarçafin në atë pjesë të faqes, që ishte e hapur.

— Me siguri. Por do të ketë ndonjë gjë me rëndësi që po e bëjnë kështu, — shtova unë.

— Qetësi, se do të fillojë shfaqja, — foli komandanti.

— Hajdari më vështroi si me habi dhe më afroi kokën te veshi:

— Çfarë tha ashtu komandanti?

— As që kuptova gjë, por duket do të mbajë ndonjë lloj fjalimi, — dhe e ndërpreva fjalën se dikush, që nuk dukej nga brenda asaj skene, lëvizi çarçafin e doli. Ishte një partizan, që nderoi me grusht. Të gjithë duartrokitën. Habia jonë ishte se atë partizan e shikonim për herë të parë.

— Ç'kanë që qeshin? — i thashë Hajdarit me zë të ulët.

— Dal të shohim, — dhe vështrimi ynë u mbërthye te partizani, i cili u kollit e tha:

— Grupi teatral i batalionit do të shfaqë për popullin e fshatit dhe për partizanët e kompanisë tre skeçe. Tani do të shihni pjesën «Ballistët e pulave», — dhe, pasi nderoi, u zhduk prapa çarçafit.

Të dy e humbëm toruan dhe prisnim me padurim të shihnin çfarë do të bëhej më tej, se fjalët «teatër» e «skeçe» i dëgjonim për herë të parë.

U ngrit çarçafi. Një grua plakë e dy ballistë. Plaka kishte pulën në dorë dhe nuk e lëshonte sadoqë ata ia tërhiqnin. Plasi një e qeshur, që nuk kishte të mbaruar, kurse neve po na kujtoheshin ballistët ashtu të gjallë, siç i kishim parë në të vërtetë. Pas skeçit të parë ne pamë skeçin «Prova e madhe», që fliste për qëndrimin e vendosur të një komunisti përpara torturave të fashistëve. Këtë pjesë e ndjemë aq shumë, sa sytë na u mbushën me lot. Pastaj në skenë dolën dy partizanë e një partizane, të cilët kënduan këngë të ndryshme. Më në fund u shfaq skeçi «Fundi i beut».

Kur mbaroi shfaqja, ne ndjeheshim të gëzuar.



Me jetën plot gjallëri e me stërvitje të pandërprerë, ditët në kompani na kalonin pa i kuptuar. Episodet që tregonin shokët për luftën, ishin të pambaruara dhe nga më të ndryshmet. Secila ishte si një pjesë e veçantë e tërë luftës partizane. Hajdari dëgjonte me vëmendje. Në sytë e tij shikoje diçka të pakënaqur. Një pasdite, tek rrinim të veçar, ai më buzëqeshi dhe më hodhi dorën në sup.

— Të gjithë shokët e kompanisë e, ndoshta, dhe të batalionit kanë se çfarë tregojnë për luftën, o Ali, kurse neve goja na mbeti kyçur. Duhet doemos të bëjmë diçka që, në mos qofshim sa shokët, të paktën t'i kemi zbrazur njëherë këto, — dhe pushkën që kishte në dorë e shtrëngoi aq fort, sikur ajo të ishte fajtorë.

— Drejt e ke. Do pres dhe ca ditë, pastaj do flas me Remzinë.

— Ti, po të duash, prit, kurse unë atij, sapo të vijë nga mbledhja, do t'ia them hapur.

E pashë drejt në fytyrë që i qe skuqur edhe më shumë nga dielli. Sytë i shkëlqenin nga një dëshirë e brendshme që e mundonte. Nga mënyra se si foli, u binda se ai do ta kërkonte me këmbëngulje.

Në të perënduar të diellit, Hajdari pa komandantin, komisarin, së bashku me skuadërkomandantët, që dolën nga shtëpia ku qenë mbledhur. Ai u ngrit më këmbë, hodhi pushkën në sup dhe rregulloi vezmet e bombat e lidhura në brezin e trashë prej lëkure.

— Po vinë duke qeshur, — më tha ai.

Atë kohë zëvendëskomandanti i kompanisë i fryu bilbilit.



— Kompania të grumbullohet sipas skuadrave,  
— thirri ai me zërin e trashë.

U vumë në rresht. Komandanti filloi të fliste:  
«Shokë, me të rënë errësira, do të nisim rrugën dhe  
aty nga mesi i natës do të zëmë vend te Lisi i Langores.  
Forcat gjermane e balliste janë vendosur në kala,  
brenda e përreth qytetit të Beratit.» Pastaj ai na  
foli gjatë për detyrat që i qenë ngarkuar kompanisë  
sonë.

Hajdari bëri buzën në gaz. Ajo, për të cilën ne  
ishim aq të shqetësuar, po merrte fund.

Intendenti i kompanisë, së bashku me një partizan,  
ishin përtej, te një dardhë. Sipas skuadrave, shkum  
am atje dhe secili mori nga një copë bukë misri e  
pak gjizë.

Me të mbërritur te Lisi i Langores, u ndamë në  
pozicione. Zëmë vënd pranë një bregoreje të vogël  
të veshur me shkurre. Kishte akoma dhe tri orë natë.  
Loni u fsheh pranë një shkurreje dhe ndezi cigaren.

— Gjersa të feksë, merrni nga një sy gjumë, —  
tha Remziu, pasi caktoj rojet.

U shtrimë të flinim.

Në të aguar u zgjuam e brofëm në këmbë nga  
krisma e topave që qëllonin andej nga ana tjetër.

— Ja nisën. Këtë punë kemi gjithë ditën. Kini  
kujdes kur të lëvizni se do të na zbulojnë, — foli  
Remziu.

Vështrimet tona u qepën andej nga dëgjoheshin  
krismat e topave. Në vendin ku ndodheshim, qytetin  
dhe armikun i kishim nën vete. Forcat e Ballit qëndronin  
në kishën e Shëndëlliut, ndërsa në kala, në lagjen  
e përroit dhe te xhamia e Plumbit, kishte forca  
gjermane.

— Shikoni mirë vendet se këtej kemi për të zbritur, — tha zëvendëskomandanti. Pastaj ai urdhëroi Lonin e ndihmësin e tij të zinin vend më poshtë për vëzhgim.

Dy orë më vonë, unë dhe Hajdari shkuam të zëvendësonim Lonin e ndihmësin e tij. Bënte një vapë që të merrte frymën. Ne ishim futur në mes të një shkurreje mbuluar me një drizë. Artileria gjermane kishte heshtur. Poshtë lumi i shterur nga thatësia, kishte mbetur si një vijë e hollë dhe zalli zbardhte në të dy anët.

Vëzhgonim objektivat e caktuara. Pas dy orësh, kur erdhën shokët e tjerë për të na zëvendësuar, ne shkuam e u ulëm te shokët, nën hijen e ullishtave.

— Vdekje fashizmit, — dëgjuam papritur një zë. Ngritëm kokat dhe pamë komandantin e batalionit, me atë trupin e gjatë mbështetur mbi një shkop. Automatikun e kishte hedhur në sup dhe dylbitë i kishte varur mbi gjoks.

— Liri popullit, — iu përgjegjëm të gjithë njëzëri e sakaq u ngritëm në këmbë. Ai u përshëndet me të gjithë ne.

— Ku janë shokët e komandës? — pyeti pastaj Remzinë. Ata njiheshin që kur ishin me çeta në Skrapar.

Kur komandanti u largua, ashtu duke çaluar, Remziu na tregoi se si gjatë operacionit të dimrit atij i kishin ngrirë këmbët nga dëborra dhe ia kishin prerë gjishtat.

Pak më vonë komandanti i kompanisë na grumbulloi të gjithëve dhe na foli për situatën e brendshme, për forcat gjermane e balliste që po përpëliteshin për vdekje nga goditjet e ushtrisë partizane; më në fund na lexoi komunikatën e Shtabit të Përgjithshëm.



Pas tij u ngrit komandanti dhe na bëri të ditur se kompania do të nisej për veprim. Ai na foli për rrugët që duhej të ndiqnim gjatë sulmit dhe gjatë tërheqjes për t'u kthyer në bazë. Detyra ishte të sulmonim me zjarr të dendur forcat gjermane në kala dhe forcat balliste të kisha e Shëndelliut. Sipas ndarjes, dy skuadra, ku bënte pjesë dhe skuadra jonë, do të godisnin forcat balliste në Shëndëlli. «Qëllimi është që, me goditje të vazhdueshme, të mos e lëmë armikun asnjëherë të qetë», shtoi ai më në fund.

Pregatitjet i përfunduam me të rënë errësira. Petroja, që ishte më i gjati nga trupi në skuadër, shkoi të merrte ushqimin.

Ndërkohë që ishim duke ngrënë, ndihmësmitralieri i tha Lonit:

— Pa shiko në torbë, mos të ka mbetur ndonjë copë bukë?

— Nuk kam, o derëbardhë, — iu përgjegy Loni.

Hajdari u ngrit, i shkoi pranë Rrapushit dhe i dha copën e vet të bukës.

— Po ti për vete? — i thashë i habitur.

— Ai ka uri.

— Të shkojmë, se ora po vete njëmbëdhjetë, — tha Remziu dhe nisi rrugën.

E ndoqëm njëri pas tjetrit. Zbritëm gjer poshtë, te vendi ku bënim vëzhgim. Po Qerimin dhe Thanasin, dy shokët e skuadrës sonë, nuk i gjetëm aty. Qëndruam për një kohë të heshtur. Pas pak aty u dha komandanti.

Nisëm të ecnim nga ana e djathtë e pozicionit ku ishte një grup ballistësh. Nga drita e hënës, rruga duket mirë. Buzë rrëpirës takuam të dy shokët që vëzhgonin. Ata i njoftuan komandantit se ballistët ishin



futur në kishë, ndërsa tre grupe nga pesë vetë ishin vendosur në pozicione.

U afruam edhe ca në drejtim të pozicionit. Ishte qetësi e plotë. Dëgjuam që një ballist i tha shokut të vet:

— Gjermanët do të sjellin forca të tjera.

— Nuk e besoj, — u përgjegj tjetri.

— Për nder! Ma tha komandanti me gojën e tij.

— Do të bëjnë mirë, se na kanë mbyllur si moun në çark.

Po rrinim si të gozhduar në vend që mos të shkaktonim zhurmë.

— Remzi! Merr një shok e nisu. Mundohu të afroresh pa u diktuar, — i tha komandanti.

— Petro, hajde, — dhe të dy u larguan duke u zvarritur.

Ne të tjerët nisëm të zvarriteshim pak më nga e djathta në drejtim të pozicionit.

Hajdarin e kisha në krah. I qemë afruar aq tepër pozicionit, sa dallonim hijen e rojes, që lëviste sa nga njëra anë në tjerën. Kur hija qëndroi në një vend pa lëvizur e u kollit, dy hije të tjera u ngritën dhe e rrëzuan përdhe.

— Oh, — u dëgjua një zë e në atë çast krisi mitralozi.


— Me granata, — thirri komandanti.

Ato plasën me krisma aq të mëdha, sa gjithë vendi u trondit. Mitralozi vazhdonte të qëllonte. Hodhëm dhe nga një granatë e bëmë pak përpara. Ndërkohë krismat e armëve plasën në katër anët e qytetit.

Loni qëllonte me mitraloz në drejtim të pozicionit. Pasi hodhi një granatë, komandanti thirri:

— Përpara, shokë!

21083



U futëm në pozicion, ndërsa Loni nisi të hapte zjarr në drejtim të portës së kishës. Tre ballistë i gjetëm të shtrirë jashtë pozicionit, pranë një mitralozi. Zjarri i dendur i mitralozëve që qëllonin nga kisha, na detyroi të shtriheshim. Nuk ishte e mundur të lëviznim. Artileria gjermane në kala qëllonte pa pushim dhe gjylet me fishkëllimë kalonin mbi kokat tona e pëlcisnin me zhurmë të llahtarshme.

Komandanti mori mitralozin që ishte aty, e rregulloi shpejt e shpejt dhe hapi zjarr në drejtim të kishës.

— Të hidhemi me granata për nga porta, — thirri ai. — Përpara, shokë!

U ngritëm, po nuk arritëm të hidhnim asnjë hap, se zjarri i mitralozave na mbërtheu në vend.

— Ah, qenët, po luftojnë derrçe, — foli Loni me inat.

Luftuam ndonjë orë e më shumë, por nuk ishte e mundur të bënim asnjë hap përpara. Më në fund skuadra tjetër arriti te dera e kishës, dhe granatat plasën njëra pas tjetrës. Mitralozët armiq vazhdonin të qëllonin pa pushim. Megjithatë mundëm të tërhiqeshim, duke u zvarritur, deri sa kaluam në anën tjetër të kodrës.

Në të aguar forcat e kompanisë po grumbulloheshin. Atë çast pamë Nesimin, partizanin e skuadrës së tretë, që ishte plagosur në krah. Ishte i pari i plagosur që shikonim. Na erdhi shumë keq. Por, kur mësuam se Remziu atë ballistin që ishte roje e kishte prurë të gjallë, zemra na u bë mal.

— Tre atje dhe ky i katërti do ta paguajnë krahun e Nesimit, — më tha Hajdari duke turfulluar me inat.

Kompania u grumbullua te ullishtat. Qemë të lo-



dhur e të rraskapitur. U shtrimë për të pushuar. Hajdarin e kapiti gjumi. Edhe mua po më rëndonin qepallat.

Pasditja na u bë më e vështirë se nata. Gjermanët na i dërgonin gjylet e sharapnelit nga kalaja dhe ato pëlcsnin mbi kokat tona, në mënyrë të llahtarshme. U bëmë njësh me tokën e, megjithatë, nuk kishim siguri, se copat e mëdha e të vogla të hekurit, binin nga lart me forcë aq të madhe, sa nga shkëmbi shkëputnin cifla guri.

Zumë vend duke pritur të gatshëm armikun; e dinim që, pas goditjeve me artileri, gjermanët e kishin në taktikën e tyre sulmin. Qëndronim në pozicione pa lëvizur. Remziu, duke u zvarritur, erdhi te ne.

— Do t'i presim me batare. Duhet patjetër t'i thyejmë. Atëhere do ta shohim se si do ta mbajnë frymën për në kala, — dhe me dorë i rrahu shpatullat Hajdarit. — Kini kujdes! Sapo Loni të hapë zjarr me mitraloz mos prisni shenjë tjetër. A më kuptuat?

Dhe Remziu u nis drejt Lonit. Pritëm për një kohë të gjatë, po gjermanët nuk u dukën. Veshët po na zienin akoma nga krismat e gjyleve, të cilat kishin më shumë se një orë që nuk dëgjoheshin më. Në të perënduar të diellit, u dha urdhëri që kompania të grumbullohej.

Leta, sa na pa, buzëqeshi.

— Dita sot na humbi, po do ta zëvendësojmë nesër, — tha ajo.

— Faji nuk është yni, — i tha Hajdari duke rrotulluar kapelen nëpër duar.

Partizanët ia nisën lehtë këngës «Malet me blerim mbuluar». Edhe ne filluam të këndonim.

Ditët që rodhën më vonë u bënë të rënda, se ato

kërkonin sakrifica e lodhje. M'u kujtua komisari i batalionit kur na tha:

— Armiku, bashkë me mbeturinat e reaksionit, do të rezistojnë. Ai do të bëhet më i egër e më gjakosor, se po e sheh vdekjen e sigurt. Lufta do të jetë e ashpër, e pandërprerë dhe qëndrimi ynë duhet të jetë edhe më i vendosur. Ne duhet t'i mbysim ata atje, në strofkën ku janë fshehur...

Dhe me të vërtetë ashtu po ndodhte! Ne shkronim herë te kisha e Shëndëlliut, në kala, herë poshtë, në lagjen e Përroit te xhamia e Plumbit, ku ndodheshin forcat gjermane dhe lufta ndizej e ashpër. Thuajse u mësua me aksionet, ato u bënë pjesë e jetës sonë.

Edhe mësimi na kishte bërë për vete. Leta, shoqja e mësuesja jonë, ishte e kënaqur me punën e saj, se ne kishim filluar të lexonim e të shkruanim pa gabime. Ngandonjëherë, kur mbaronim mësimin, shtroheshim me të në bisedë të lirë. Madje ajo shpesh na këshillonte që, kur të shkronim në ndonjë shtëpi, apo të takonim persona të veçuar, t'u propagandonim atyre luftën tonë për çlirimin e atdheut. Dhe gjithmonë ajo thoshte: «Mos mendoni të thoni fjalë të mëdha, po të flisni ashtu siç e ndjeni vetë ju që rrëmbyet armët e u radhitët në rreshtat partizane».

Puna e shokëve tanë na bëri aq aktivë, sa na dukej sikur në rreshtat partizane kishim një kohë të gjatë. Se sa shumë kisha mësuar, veten time e shikoja si në pasqyrë te Hajdari. Ai kishte ndryshuar natyrë. Fliste me shokët, shoqet e me fshatarët pa u skuqur në fytyrë. Qeshte e këndonte si dhe të tjerët. Herëherë ai ia merrte këngës, ndërsa unë ia ktheja e të tjerët mbanin iso.



\*  
\*   \*  
\*

Remziu u kthye i gëzuar nga mbledhja e partisë. Menduam se do të kishte ndonjë lajm të mirë për të na dhënë, prandaj po prisnim gojëhapur. Ai na vësh-troi një për një, pastaj i qetë si gjithmonë nxori ku-tinë e duhanit dhe nisi të dridhte cigaren. Atë çast vëmendjen na e tërhoqi mushka e kompanisë, që po zbriste duke vrapuar, dhe Nurja, që po e ndiqte nga pas. Kur Nurja u pengua dhe këmbadorazi eci ca metra e përsëri u ngrit, ne ia dhamë të qeshurit.

Hajdari u ngrit dhe, duke vrapuar, i preu rrugën mushkës. Ajo qëndroi. Pasi e kapi për freri, duke qeshur, Hajdari ia dorëzoi mushkën Nures që sapo arriti duke marrë frymë me vështirësi. Ky i fundit e tërhoqi frerin me zemërim dhe u largua duke mallëkuar kafshën që tani i shkonte nga pas si e penduar.

— Është djalë i papërtuar dhe trim, — i tha Remziu Lonit, duke vështruar Hajdarin.

— Ka vullnet të madh e jo llafe. Copë i bëri duart, sa arriti të mësojë ta zbërthejë e ta mbërthejë mitralozin. Parmbrëmë, kur sulmuan gjermanët te xhamia, e kisha në krah. Duke u zvarritur e pa zhur-më, ai iu afrua pozicionit ku gjermanët kishin ven-dosur mitralozin. Sa hapën zjarr ata, u hodhi një-rën gjallë në tokë. Na grinë me atë djall mitraloz, nuk qe e mundur të bënim përpara, prandaj edhe u dety-ruam të tërhiqeshim, — ia pat Loni.

Ndërkohë, sipër te qafa u dukën partizanët e kompanisë së parë.

— Po këta përse vijnë? — tha Loni me habi.

— Do të bëhet mbledhja e batalionit, — u përgjegj Remziu, dhe fytyra e tij mori një pamje që tregonte se fshihte diçka.

Qëndruam të heshtur, duke vështruar kreun e kolonës ku valëvitej flamuri i batalionit.

— Ngrihuni të shkojmë te ata, — tha Remziu e nisi rrugën i pari.

Po vargu i partizanëve nuk kishte të sosur, se, pas kompanisë së parë, dha ballë kompania e tretë e pastaj e katërta.

U grumbulluam shpejt e shpejt sipas kompanive. Zëvendëskomandanti i batalionit, pasi dha urdhërin «gatitu!», shkoi drejt t'i paraqiste forcën komandantit. Hajdari, me bisht të syrit, më vështronte mua. M'u duk sikur donte të më thoshte diçka po nuk kishte mundësi, se ne ishim në qëndrim «gatitu». Me t'u dhënë urdhëri «qetësohu!», ai m'u afrua e më tha:

— A e di përse... — dhe nuk arriti të fliste më shumë.

— Shokë partizanë! — u dëgjua zëri i komandantit. — Batalioni ka marrë urdhër të niset me shpejtësi në Kuçovë për të goditur forcat gjermane.

— Jemi gati! — u përgjegjën njëzëri partizanët.

Pastaj ai na shpjegoi se ç'duhej të bënim ne për t'u ndalur dorën gjermanëve, që Kuçovën mos ta bënin shkrumb e hi.

Batalioni, pa shumë ceremoni, nisi marshimin në varg, duke lënë prapa malin e Tomorrit dhe kalanë, nga ku forcat gjermane, të mbrojtura nga ato muret e trasha qindravjeçare, villnin zjarr për t'i shpëtuar vdekjes.



Pasi bëmë dy orë rrugë, qëndruam për të pushuar. Ishte errësirë dhe rruga mezi dallohej.

Nisëm përsëri rrugën dhe ecëm pa u ndalur. Në të aguar mbërritëm në afërsi të qafës së Spitalit. Përtej ishin gjermanët, strukur në pozicionet e përgatitura prej kohësh. Hajdari vështronte i humbur në mendime. Andej thellë, prapa atyre kodrave që dukeshin si në mjegull, ishte Goriçani, ku jetonin njerëzit e afërt të tij.

— Atë kohë gjermanët nisën të na qëllonin me artileri.

— Me gjyle po na presin rrufjanët, — i thashë dhe u shtriva.

— Le të qëllojnë sa të duan, lëkura jonë është mësuar, — ma pat Hajdari.

Kodrat mbi ne u bënë tym. Sapo dëgjonim kris-mën e topave e pastaj fishkëllimën e gjyleve që çanin ajrin, prisnim të shtyrë, gjersa ato pëlcisnin. Dy orë rresht na qëlluan. Kur krismat pushuan, veshët tanë gumëzhnin ende nga ato plasjet e zhurmshme.

Në mbrëmje të gjitha skuadrat u përgatitën për sulm. Do të sulmonim gjermanët te qafa e Spitalit e në vende të tjera. Ecëm njëri pas tjetrit, gjersa mbërritëm në afërsi të pozicionit, pastaj nisëm të zvarriteshim. Nën dritën e zbetë të hënës, telat me gjëmba dukeshin si vija të zeza e të çrregullta dhe mbi to dalloheshin kutitë bosh të lidhura për të shkaktuar zhurmë.

Iu afruam shumë pranë gardhit me tela. Roja gjermane nuk dukej në pozicion. Granatat i kishim nxjerrë dhe po rrinim gati. Remziu, Thanasi dhe Hajdari kaluan me shpejtësi nga e majta dhe humbën në errësirë. Do të prisnim sa të kalonin ata në

anën tjetër. Sipas planit, gjermanët do t'i vinim midis dy zjarreve.

Të shtrirë barkas e të heshtur po qëndronim duke pritur Petron që po hapte një vrimë në gardh për të hyrë brenda. Aty jashtë gardhit isha i qetë, por, kur Petrua na dha shenjë të hynim në atë vrimën e ngushtë, si kornizë e vdekjes, zemra nisi të më rrihte me forcë. Në vrimat e betonit, që dukeshin si zgavra, qenë vendosur tytat e mitralozëve. Jashtë gardhit ishin Loni dhe Rrapushi, me mitraloz, që do të na mbulonin me zjarr gjatë tërheqjes...

Sa i qemë afruar pozicionit, lart në qiell u duk fishekzjarri i kuq. Krisma e granatave brenda në pozicion tronditi vendin. Forcat partizane sulmuan nga të katër anët.

Duket se gjermanët po e prisnin një gjë të tillë. Na goditën me një zjarr të dëndur. Vendi u nderz flakë. Në drejtimin tonë një mitraloz nisi të qëllonte me breshëri. Na gozhdoi në vend. Por goditjet e Remziut, të Thanasit dhe të Hajdarit nga prapa e bënë të heshtte. Bëmë përpara dhe iu afruam bunkerit. Mitralozi u zgjua me zjarr të fortë dhe ne nuk ishim në gjendje të lëviznim as përpara dhe as të tërhiqeshim. Petroja hodhi një granatë. Ra mu brenda me shpërthim. Zjarri vazhdoi gati një orë. Ndërkohë Loni hapi zjarr nga përtej gardhit. Ishte shenja e tërheqjes. Gjermanët u gënjyen dhe hynë në duel. Përfituam nga rasti, ndryshe do të kishim ngelur brenda, si miu në çark.

Mëngjezi për ne qe me telashe, se gjermanët filluan të na godisnin me artileri e murtaja. Na u desh të qëndronim tri orë nën goditjen e gjyleve. Pastaj ra prapë qetësi.



Intendenti lajmëroi që të shkonim të merrnim bukën. Rrapushi doli vullnetar.

— Shko! Pa ngrënë, ty nuk të mban vendi, — i tha Loni dhe u mbështet pas ferrës.

Rrapushi qeshi dhe u largua pa kthyer përgjegje.

— Ai çdo gjë e bën, por vetëm pa ngrënë nuk duron dot. Duhet të ketë tënjën në bark që s'ka të ngopur. Mbrëmë, kur u nisëm për në aksion, më kërkoi bukë. Ia zura tytën me një copë që më kishte mbetur në torbë. Po më e keqja është se ma bëri zakon të mbaj bukë për atë djall, — shtoi Loni ndërsa ne ia dhamë gazit.

Në mbrëmje Remziu na lexoi komunikatën e Shtabit të Përgjithshëm ku njoftohej çlirimi i qytetit të Beratit nga forcat partizane dhe sukseset e Ushtrisë nacionalçlirimtare kundër forcave gjermane e balliste. Gjithashtu ai na njoftoi se komanda e batalionit ka urdhëruar që goditjet kundër gjermanëve të ishin të pandërprera, ditë e natë, me qëllim që armiku të ishte nën presionin tonë.

Pas shumë luftimesh që zgjatën gati një muaj, në mëngjezin e 17 tetorit gjylet që fluturonin në ajër me fishkëllima të llahtarshme, pëlçisnin me krisma të mëdha. Kodrat u bënë tym dhe neve na dukej sikur do të hapej dheu. Nuk mund të lëviznim, se mbi kokat tona predhat e sharapnelit ndaheshin në qindra copra të vogla.

Gjermanët po e shfrynin inatin me zjarr dhe hekur. Donin të na shastisnin, të na trembnin dhe, mes pluhurit të përhirtë, të ngritur shtëllunga, të na varrosnin të gjallë.

Por ne ishim bërë njësh me tokën. Kështu qëndruam tetë orë. Pastaj në qiell pamë fishekzjarrin e kuq.

Remziu u ngrit në këmbë.

— Përpara, partizanë! — briti dhe shkoi duke vrapuar.

— Përpara, partizanë! — pasoi Hajdari.

Vendin e kishte mbuluar tymi i zi, që dilte nga distileria, përzier me flakën e madhe që po ngrihej drejt qiellit.

Te qafa, ku ishin pozicionet e gjermanëve, nuk gjetëm rezistencë dhe zbritëm drejt centralit.

Sakaq plasën minat dhe toka nën këmbët tona u lëkund. Dy repartet mekanike ndihmëse që ishin pranë centralit u hodhën në erë.

Duke qëlluar iu afruam centralit dhe nuk i lamë kohë praparojës gjermane të ndizte minat.

Me luftë i ndoqëm gjermanët deri jashtë Kuçovës. Ata ia mbathën në drejtim të Lushnjes. Kur u kthyem në qytet, populli, që kishte dalë në rrugë, na përshëndeste e na përqafonte i gëzuar. Ashtu, duke brohoritur, popull e partizanë, u grumbulluam te sheshi. Një nga anëtarët e shtabit hipi mbi një kamion të shkatërruar dhe nisi të fliste për këtë fitore të madhe. Të gjithë dëgjonin me vëmendje. «Vështroni se çfarë shkatërrimesh kanë bërë barbarët. Po, ata donin që këtë pasuri ta kthenin në gërmadhë, por nuk ia arritën...»

— Rroftë Partia Komuniste Shqiptare! — u dëgjua një zë.

— Rroftë! Rroftë! — bërtiti turma, duke duar-trokitur.

— Rroftë shoku Enver Hoxha!

— Rroftë! Rroftë!

Festa vazhdoi me këngë e valle gjer natën vonë. Në fund anëtarët e Këshillit nacionalçlirimtar të qytetit na ndanë nëpër baza; Thanasin, Hajdarin dhe



mua na caktuan të shkonim në shtëpinë e një punëtori të distilerisë. Korieri i Këshillit na shoqëroi deri te porta. I zoti i shtëpisë na priti ngrohtë dhe bëri çmos të na kënaqte. Bisedën e shtrua për bukuri. Folëm për luftën tonë kundër pushtuesve dhe tradhëtarëve.

Më në fund i zoti i shtëpisë tha i kënaqur: «Kryesorja, more djem, është se luftën mbi armiqtë e fituam. Megjithëse shkatërrimet në pusët e impiantet, siç i patë edhe ju, janë të mëdha, ne duart i kemi të forta, do t'i ngrëmë, se ato janë tonat. Ju vazhdoni luftën, ndërsa ne këtu nuk do ta lëmë pa e nxjerrë naftën nga toka...»

Zemra na u bë mal nga këto fjalë.

Në mëngjez u përshëndetëm me të zotin e shtëpisë dhe u nisëm për të shkuar poshtë te centrali. ku qe caktuar vendi i grumbullimit.

\*  
\* \*

Ditët në Kuçovë na kaluan me punë. Shoqëro-  
nim specialistët italianë që hiqnin minat nga impi-  
antet e pusët. Pushtuesi nuk kishte lënë vend pa  
minuar. Edhe në mekanizmat e shkrepjes së topave  
i gjetëm ato të mallëkuara mina. Mjaftonte një lë-  
vizje e vogël që të hidheshe në erë së bashku me  
topin.

Vendi ishte kthyer në kantjer. Punëtorë e par-  
tizanë punonin për të vënë në shfrytëzim impiantet  
e pusët me kullat e shkatërruara. Ata grumbullonin  
hekura, prishnin muret gjysmë të rrëzuar dhe pasto-  
nin vendin për të filluar rindërtimin.

Nuk qëndruam shumë kohë në qytet që të shikonim rezultatet e asaj pune të vullshme, se batalioni nisi rrugën për në Lushnje. I ramë mes për mes fushave të pafund, kaluam fshatin Krutje dhe qëndruam në Karbunarë Aty mësuam se do të formohej Brigada X dhe se batalioni ynë do të hynte në efektivin e kësaj brigade.

Në mëngjez u grumbulluan të gjitha forcat partizane që do të bënin pjesë në brigadë. Remziu u emërua zëvendëskomandant i kompanisë sonë, ndërsa si komandant i skuadrës sonë u emërua Loni.

Në mbrëmje shkua në fshatin Gurëz. Unë dhe Hajdari u caktuam për të fjetur në një shtëpi që ishte në fund të disa lëndinave. I zoti i shtëpisë na priti i gëzuar. Sa na pa, ai na përqafoi. Po aq mirë na priti gruaja dhe vajza e tij, e cila, megjithëse vinte ca e dobët në trup, ishte mjaft tërheqëse. Flokët i kishte gështenjë e të bëra gërsheta. E quanin File.

Xhelali, i zoti i shtëpisë, i tha së shoqes të therte zogun e fundit që kishte mbetur pa ia marrë ballistët. I thamë të mos e bënte një shpenzim të tillë, po ai na vështroi e ia pat:

— E keni shumë gabim. Do ta ther se s'bën. Ju po luftoni edhe për ne. Dhe unë të mos ther një zog? There, o Merjeme! — iu drejtua më në fund së shoqes.

Hëngrëm sa u ngopëm e pastaj ia nisëm përsëri bisedës. Më tërhoqi vëmendjen Hajdari, se nga goja u bë bilbil. Duke treguar për luftën, ai hera-herës i buzëqeshte Files. Ajo e dëgjonte me vëmendje.

Kur ramë të flinim te qoshja, pranë njëri-tjetrit, Hajdari kthehej sa nga njëra anë në tjetrën. U mundua shumë gjersa e kapiti gjumi.

Në mëngjez i zoti i shtëpisë së bashku me gruan



dhe të bijën na përcollën gjer në fund të lëndinës. Në çastin që po u linim lamtumirën, Xhelali na tha:  
— Po të qëndroni edhe sonte, dukuni e mos t'ju vijë turp.

Mirëpo atë ditë u dha urdhër që brigada të rresh-tohej. Batalionet u radhitën njëri përkrah tjetrit. I deleguari i Shtabit të Përgjithshëm, një mesoburrë, me ca mustaqe të zeza, nisi të na fliste për luftën e batalioneve tona. Në fund ai tha:

— Shtabi i Përgjithshëm ka bindje se pjesëtarët e kësaj brigade do të dinë ta mbajnë lart emrin e nderin e saj.

Atë kohë buçitën brohoritjet për Partinë dhe Komandantin e Përgjithshëm.

Si u bë organizimi, brigada nisi rrugën. Sipas urdhërit që na u komunikua, do të shkonim të merrnim pjesë në luftën për çlirimin e kryeqytetit. Ishim të gjithë të gëzuar, mirëpo, në të dalë të Lushnjes, humorin na e prishi shiu që filloi. Rrugët e monopateve u bënë gjithë baltë që na ngjitej në këpucët. Shiu vazhdonte të bipte dhe më me furi. U lagëm deri në palcë.

Kishte dhe një orë natë, kur ne arritëm buzë lumit Shkumbin, që kishte nisur të fryhej nga ujët e shirave. U hodhëm me një trap në anën tjetër. Ende pa nisur rrugën, përtej në xhade u dëgjua zhurmë motorësh dhe pas pak u shfaq një autokolonë që nuk i dukej fundi.

— Ptu, ta marrë djalli! — shfryu komisari i batalionit dhe dha urdhër të zinin pozicione.

Hajdari m'u afrua pranë:

— Ç'pati kështu komisari?

— Ku e di unë, — i thashë, por nuk patëm kohë të bisedonim, se nisën krismat e mitralozëve.

Autokolona qëndroi. Lufta u ndez keq. Rrapushi ynë qëllonte me mitraloz dhe na mbulonte me zjarr që të çanim përpara. Iu afruam autokolonës, duke pritur me padurim sinjalin e sulmit.

Sakaq në drejtim të rrugës u dëgjuan uturima motorësh dhe më pas u dukën katër tanke të mëdhenj. Ata hapën zjarr të dëndur. Pas katër të parëve u dukën dhe gjashtë të tjerë. Nisëm të qëllonim drejt tyre, po çeliku që i mbulonte as që donte t'ia dinte nga plumbat tanë. Kështu, u detyruam të tërhiqeshim dhe të bëheshim njësh me tokën. Autokolona e cila pësoi disa humbje nisi rrugën e mbrojtur nga zjarri i tankeve.

U ngritëm dhe nisëm të marshonim. Qëndruam për të pushuar kur drita kishte zbardhur mirë. Mësuam se komisarari u kishte thënë shokëve, se çdo orë vonesë në rrugë pengonte planin për çlirimin e Tiranës, mbasi shtabi i korparmatës na kishte llogaritur si forca sulmi. Pastaj biseda u hodh te tanket e autokolonës gjermane.

— Kur shikoja ata që villnin zjarr kundër nesh, gjaku më hipi në kokë dhe u bëra gati të zvarritej drejt tankut të fundit. Mirëpo e mbajta veten, se nuk dija si i hapej kapaku, — i tha Hajdari Rrapushit dhe Thanasit.

— Po ta dija se kishe në mendje këtë gjë, unë i pari do të të mbuloja me zjarr, — shtoi Rrapushi.

Unë buzëqesha. Atë kohë u dha urdhëri të fillonim marshimin. Kodrat po i kalonim një rën pas tjetrës. Ndjenim lodhje nga balta që na ngjitej në këpucë e na i bënte plumb të rënda. Na u desh të ecnim në rrugë pa rrugë që të prisnim më shkurt. Kur mbërritëm në vendet e caktuara, qemë të lodhur e të raskapitur.



Remziu na erdhi në pozicione e na njoftoi të përgatiteshim se do të fillonim sulmin kundër gjermanëve. Ishte në të gdhirë të datës 11 nëntor, kur iu afruam pozicioneve të armikut. Sapo u hodhëm në sulm, ata na pritën me zjarr të dendur. Lufta u ndez e ashpër. Gjermanët luftonin me aq këmbëngulje, sa që ne nuk ishim në gjendje të çanim përpara. Një mitraloz qëllonte nga krahu i djathtë dhe po na paralizonte. Loni na u afrua dhe na urdhëroi ta ndiqnim. Rrapushi nisi të qëllonte drejt mitralozit, ndërsa ne ndoqëm Lonin. Kur iu afruam mitralozit, ndoqëm granatat njëri pas tjetrit dhe sulmuam. Kjo punë u bë aq shpejt, sa edhe ne nuk e morëm vesh kur u ndodhëm në pozicion. Gjermani kishte rënë përmbys pranë mitralozit.

Hajdari ishte përkrah Lonit. Një gjerman i plagosur u ngrit me automatikun në duar dhe mori në shenjë Lonin; në çast Hajdari, me shpejtësi të rrufeshme, i hodhi granatën. Ajo plasi mu përpara gjermanit, i cili mbeti përdhe i copëtuar.

I ndoqëm gjermanët këmba-këmbës gjersa ata na humbën nga sytë.

Nga ana e kryeqytetit dëgjohej oshëtimi e topave dhe e mortajave. Pasdite forcat partizane kishin çliruar gjysmën e kryeqytetit.

Të nesërmen në mëngjes, kur mjegulla ende nuk ishte shpërndarë, forcat gjermane filluan të na qëllonin me artileri e mortaja. Vendi përreth u bë tym e flakë.

Ndërkohë që gjylet binin me gjëmim, forcat gjermane u ishin afruar pozicioneve tona dhe, sapo artileria e mortajat pushuan, ata shpërthyen një sulm të tërbuar. Donin me çdo kusht të çinin rrugën nga Kashari, ku ishim ne, në drejtim të Vorës. Dëgjohe-

shin krisma automatikësh e mitralozësh dhe bombat plasën aty përpara nesh. Hodhëm granatat që kishim, po ata as që deshën t'ia dinin. Sulmonin drejt e pa u mbrojtur, si ata ujqët e uritur.

Pashë se drejt meje po vinte një gjerman trup-madh. I drejtova pushkën dhe tërhoqa këmbëzën. Fisheku nuk më ndezi. Lëviza shulin me shpejtësi, por ai derr m'u dha aty dhe më mbërtheu me duart e tij të forta si hekur. Megjithëse me trup isha shumë më i vogël se gjermani, u mundova të shpëtoja, por qe e pamundur. Ai më kishte zënë në fyt e po më shtrëngonte aq fort, sa sytë po më lëshonin xixa. M'u muarr fryma dhe sytë m'u errësuan. Atë çast Hajdari u dha prapa gjermanit dhe i përplasi pushkën mbi helmetë. Duart e tij u shkëputën nga fyti im dhe unë ndjeva se mushkëritë m'u mbushën me ajër. Gjermani ra përtokë dhe fytyra nisi t'i mbulohej me gjakun që i rridhte nga koka.

— Mblidhe mendjen e ngrehu, — më tha Hajdari e nisi të qëllonte.

Zura pozicion. Lëviza shulin dhe i futa fishekun. Pushka zuri të qëllonte për bukuri. Luftuam derrçe, siç i thonë fjalës, dhe i detyruam gjermanët të ndalonin sulmin. Pas pak u dha sinjali të hidhemi në kundërsulm. Atë ditë gjermanët u thyen keqas.

Pasdite armiku u mundua të çante darën e rrethimit nga ana ku luftonte kompania tjetër, por edhe atje pësoi të njëjtën gjë.

Tërë natën qëndruam të gatshëm në pozicione. Të ftohtët na preu dhe uria bënte punën e vet. Kishim dymbëdhjetë orë pa futur gjë në gojë. Në mëngjez shpejt na lajmëruan se erdhi ushqimi. Nustreti u caktua të shkonte ta merrte. Në çastin që ai po largohej, Rrapushi ngriti kokën.



— Hajde shpejt, ore djall, se pantallonat po na lëvizin e nuk kanë ku të mbahen.

— Fluturova, o Rrapush, — iu përgjegj ai dhe shpejtoi këmbët.

Megjithëse ishim në pozicione, Hajdari hapi abetaren dhe nisi të shkruante detyrat.

— Leta na bëri bilbila për tre muaj, jo llafe, — i thashë duke qeshur.

— Nuk thua shyqyr, se do të kishim mbetur dru, o lumë. Tani të paktën librin nuk do ta kthejmë me kokëposhtë.

— Ashtu është. Me ca vështirësi, po dy rreshta jam në gjendje t'ua shkruaj njerëzve, — shtova unë edhe atë çast pashë Letën që po vinte drejt nesh.

U gëzua shumë kur e pamë, se kishte tri ditë që nuk ishte dukur në kompani. Na përshëndeti të gjithëve ashtu siç e kishte zakon.

Pastaj u ul midis nesh dhe nisi të na tregonte për luftimet në kryeqytet, që, sipas fjalëve të saj, pritej të çlirohej nga ora në orë. Pastaj na tha se e kishin thirrur në komandën e brigadës, ku do t'i komunikonin se ku e kishin transferuar.

U përqaftua me të ashtu me zemër të pastër. Nuk do ta harronim kurrë. Ajo kishte qenë me ne aq e dashur dhe aq punëtore. Leta bëri të ecte dhe befas qëndroi:

— Thanas, kujdes se mos i lë pa thirrur këta të dy në mbledhje, — dhe u largua me të shpejtë.

— Përse do të bëhet mbledhja? — pyeta Thanasin.

— Për t'u pranuar në organizatën e rinisë. Rekomandimet për ju të dy i ka dhënë Leta dhe unë.

Veç do të keni parasysh të flisni e mos t'ju vijë turp...

— Ku dimë ne, o Thanas, se çfarë do na kërkohet? — i tha Hajdari.

Atë kohë erdhi Nustreti me torbën ngarkuar. Ai u ul e nisi të ndante copat e bukës në racione. Të parit i dha Rrapushit, i cili, sa e mori, futi një copë të madhe në gojë dhe nisi të mbllaçitej me bulçitë plot.

— Hajde, hajde! Furrë je! Mjerë ajo shtëpi që të ka, — i tha Vasua.

Ia plaçëm gazit, ndërsa Rrapushi hante dhe as që i bëhej vonë se ç'përrallisnim ne.

Nisëm të hanim të gjithë, po unë e Hajdari mendjen e kishim te mbledhja.

U grumbulluam jo shumë larg pozicioneve. Letën tani e zëvendësonte Thimi. Thanasi ishte ulur midis nesh.

Thimi u ngrit dhe nisi të fliste.

— Në mbledhjen e sotme, në rend të ditës do të kemi shqyrtimin e detyrave tona të mëtejshme luftarake dhe pranimin e dy shokëve tanë në radhët e rinisë komuniste.

Të gjithë ngritën duart dhe rendi i ditës u aprovua. Pasi na shpjegoi me hollësi detyrat që na prisnin, Thimi nisi të fliste për Hajdarin dhe për mua. Pastaj ai pyeti se kush donte të fliste. I pari e mori fjalën Thanasi, i cili foli gjatë për të kaluarën, cilësitë dhe vullnetin e Hajdarit. Pas tij folën edhe shumë të tjerë. Në fund fjala iu dha Hajdarit:

— Bujq i kam njerëzit në shtëpi dhe unë çoban kam qenë. Këtu në rreshtat partizane ju, shokë, më hapët sytë dhe më mësuat të vërtetën. Unë këtu mësova të shkruaj, të këndoj e të kuptoj forcën e madhe



të Partisë sonë. Po luftoj me gjithë zemër, të shporrin armiqtë e të fitojmë të drejtat tona...

Thimi iu drejtua shokëve të votojnë. Hajdari u pranua. E njëjta procedurë pune u ndoq edhe për mua. Më pranuan në radhët e rinisë komuniste ashtu si dhe Hajdarin. Mbledhja ende s'kishte mbaruar, kur u dha sinjali për t'u shpërndarë në pozicione. U ngritëm të gjithë me nxitim. Në të ikur e sipër i thashë Hajdarit:

— Ku paske qenë, more qerrata! Bilbil e kishe gojën...

— Jo më shumë nga ti.

— Të them të drejtën, në çastin kur u ngrita, m'u duk sikur do ta humbisja, po mendjen e mblo-dha shpejt. Fjalët më rridhnin pa i kuptuar fare.

— Edhe mua kështu më ndodhi, po i thashë vetes: «Hajdar, mbahu, se këta janë shokët e tu». Duket se kjo më dha kurajo.

U shpërndamë nëpër pozicione e qëndruam gjer-sa u errësua. Pastaj u tërhoqëm prapa kodrës dhe në pozicione lamë rojet. Ndezëm një zjarr të madh. U grumbulluam përreth dhe biseduam gjer vonë, sa na zuri gjumi.



Në të aguar zjarri ishte gati në të shuar. Shumë nga shokët u zgjuan duke u dridhur nga të ftohtët. Petroja hodhi një krah dru në zjarr e nisi t'i frynte. Loni thithi për të fundit herë bishtin e cigares dhe pastaj e hodhi në zjarr duke pështyrë:

— Ptu, ma hidhëroi gojën! — tha dhe pështeti kokën te kurrizi i Thanasit.

Sakaq erdhi korieri. Ai i tha Lonit që, së bashku me dy shokë të tjerë, të shkonte për zbulim përtej, nga ishin forcat gjermane.

— Hajdar, Ali, çohuni të shkojmë! — na tha Loni dhe porositi Petron të kishte kujdes skuadrën.

Kur u larguam nga shokët, Loni qëndroi. Fytyra e tij kishte marrë një pamje serioze.

— Me t'u afruar te pozicionet e tyre, ti, Hajdar, do të më dalësh nga e djathta dhe do të më ndjekësh nga pas, kurse ti Ali nga e majta. Puna është që të zbulojmë saktë vendin, — tha ai dhe nisi rrugën.

Të shtënat me artileri nga ana e kryeqytetit qenë rralluar. Hëna ndriste gjithë vendin dhe ne nuk e kishim të vështirë të shikonim rrugën.

Gjermanët, për çudi, nuk po jepnin shenja me fishekzjarre. Megjithatë ne ecnim me shumë kujdes, që të mos na diktonin. U futëm në një përrua dhe këmbadorazi dolëm në anën tjetër që qe e pjerrët thikë. Sa kaluam pyllin e shkurtër, iu afruam vendit ku qenë përqëndruar forcat gjermane. Të shtrirë barakas, qëndruam të heshtur për një kohë të gjatë. Duket se kjo heshtje po e shqetësonte Lonin dhe ai nisi të zvarritej përpara.

Nga ana e gjermanëve, nuk po dëgjonim më asnjë zhurmë. U drejtuam nga pozicioni që kishin pasur ditën. Qëndruam e po përgjonim. Asgjë e gjallë nuk dëgjohej.

— Prisni këtu! Po më qëlluan, hapni zjarr, — tha Loni dhe, duke u zvarritur, humbi në errësirë.

Unë dhe Hajdari rrinim të gatshëm. Nuk kaloi shumë dhe dëgjuam zhurmën e një guri. Me gishtin në këmbëzë po prisnim ndonjë lëvizje, po përsëri u



bë qetësi. Kur ja, u dha Loni. Ai na tha se qe futur në pozicion dhe gjermanët nuk qenë aty. Të tre zbri- tëm gjer poshtë, atje ku ishte vendkomanda e gjer- manëve. Të vetmet gjurmë që kishin mbetur qenë ca kuti bosh që shkëlqenin në dritën e hënës.

— Paskan ikur, — thashë unë gjithë inat.

— Hajdar, shko thuaj komandantit se ata janë larguar. Takohemi te ajo maja, — e urdhëroi Loni.

Ndërsa Hajdari u largua, ne u vërtitëm edhe një herë rrotull se mos, kushedi, gjenim ndonjë gjurmë. Mundimi na shkoi kot dhe u kthëm te vendi ku ki- shim lënë takimin.

Komandanti, komisari, Remziu dhe dy partizanë erdhën dhe na takuan aty te maja. Komandanti po- rositi dy partizanë të shkonin të njoftonin komandën e batalionit mbi largimin e gjermanëve dhe se ku do të vendosej kompania.

Çështë e vërteta, largimi i gjermanëve ashtu, natën, ishte diçka e çuditshme, së vendi qe një pikë strategjike e rëndësishme dhe mbronte krahët e for- cave gjermane që ndodheshin në kryeqytet.

Në këtë kohë dy shokë erdhën dhe i dhanë ko- mandantit të kompanisë një copë letër të zhubra- vitur që e dërgonte komisari i batalionit. Komandanti shpalosi letrën dhe sytë e tij shndritën nga gëzimi. Na vështroi dhe buzëqeshi:

— Shokë, Tirana u çlirua. Forcat gjermane e ba- lliste janë shpartalluar keq. Kompania jonë duhet të nisët për në fshatin Danaj, që të godasë e të shpar- tallojë forcat bashibozuke të Legalitetit e të Ballit Kombëtar.

Hajdari më përqafoi fort. Shkuam në vendin ku ndodhej kompania dhe komisari u dha partizanëve lajmin për çlirimin e kryeqytetit. «Urra, urre!», bro-

horitën të gjithë dhe hodhën kapelet përpjetë. «Rroftë Partia Komuniste!» «Rroftë Komandanti i Përgjithshëm, shoku Enver Hoxha!»

— Shokë, — vazhdoi komisari, — mbeturinat e armikut duhen asgjësuar, prandaj detyra jonë është që ata t'i ndjekim këmba-këmbës.

Hajdari më shikonte e qeshtë, pastaj m'u afrua:

— S'kanë ku të venë maskarenjtë, se, dhe në vrimë të miut të futen, ne do t'i gjejmë.

— Puna është t'i shpartallojmë sa më shpejt, — shtova unë dhe hodha në sup pushkën.

— Si mund të jetë Tirana? — më pyeti papritur Hajdari.

Ngrita supet, se dhe unë nuk kisha dalë kurrë nga kufijtë e fshatit tim.

— Thua si Berati? — vazhdoi ai.

— Ndoshta po, ndoshta dhe jo.

— A do të shkojmë edhe ne në kryeqytet?

— Ç'më pyet edhe ti kaq shumë, se mos e di unë se ç'mendim ka komanda...

— Mirë e ke. Pastaj, në mos shkofshim tani, do të shkojmë më vonë, se kryeqyteti tani është yni, — dhe ai më goditi lehtë me grushte në krahëror.

Batalioni nisi rrugën për në drejtim të Danajt dhe të Bërxullit, ku qenë përqëndruar forcat bashibozuke të Legalitetit. Në mbrëmje bëmë rrethimin, ndërsa në agim të ditës së re iu afruam shtëpive të para të fshatit. Përtej nga fshati Bërxullë plasi pushka. Bashibozukët na ndjenë, ata hapën zjarr me dy mitraloza. Ne nuk e zgjatëm, por u hodhëm në sulm me të thirrura: «Para partizanë!»

Qëndresën e tyre e thyem me granatat e para që hodhëm dhe hymë shpejt në fshat. Bashibozukët, të bindur tashmë se nuk kishin nga t'ia mbanin, hodhën



pushkët dhe u dorëzuan. I grumbulluam të gjithë dhe i vumë përpara. Më vonë forcat e kompanisë zunë të tjerë andej nga Bërxulli dhe i prunë aty. Numri i tyre dalëngadalë u bë 150 vetë. Bashibozukët e grumbulluar rrinin kokulur.

Komisari i batalionit u mbajti një fjalim të gjatë, pastaj pjesën më të madhe të tyre, që ishin të gënjyer nga reaksioni, i liruam. Disa prej tyre qëndruan vullnetarisht në radhët tona, kurse kryesorëve, që ishin të lidhur kokë e këmbë me armiqtë e që bëheshin gjithë-gjithë trembëdhjetë vetë, ua lidhëm duart dhe i nisëm për në shtabin e brigadës.

U dha urdhëri që kompania të rreshtohet.

— Do të shkojmë në kryeqytet, — tha komandanti e nisi rrugën i pari. Kënga «Në ato maja rripa-rripa...» ushtoi.

Natën vonë, të lodhur e të raskapitur, hymë në kryeqytet.



Batalionet e brigadës u rreshtuan te sheshi i madh përpara kazermave. Komandanti na dha lajmin e gëzuar se brigada jonë do të merrte pjesë në parakalim dhe na vuri detyra që të pregatiteshim gjatë ditëve që na kishin mbetur. E pritëm me brohoritje, pastaj iu përveshëm punës për t'u stërvitur. Mirëpo, të mësoje të ecje me komandë, paskesh qenë një punë e madhe për shumicën tonë që nuk kishim haber as se cila këmbë duhej hedhur më parë. Skuadërkomandantëve iu ngjir zëri duke thirrur gjithë ditën: «një, dy, një, dy.» U këputëm nga lodhja. Pas katër ditësh

sikur ia morëm anën, dhe hapi nuk na ngatërrohej aq shumë, si në fillim. Menduam se puna me kaq do të mbaronte. Po u gabuam. Komandanti i kompanisë na tha se detyra ishte që të mësonim të hidhnim hapin me muzikë. Shumë nga ne u habitën.

Në mbrëmje po rrinim me Hajdarin aty ndanë gardhit, pranë trupit të rojes.

— Qenka bela kjo puna e rreshtores, — i thashë atij.

— Dale, dale, mos u mërzit, do të kemi dhe shumë të tjera.

— Ç'të tjera? — e pyeta me habi.

— Rregullat që i duhen një ushtrie vullnetare të rregullt.

— Po ne rregullat i kemi.

— Zëvendëskomandanti i batalionit tha se, që të jemi të organizuar, duhet të fillojmë që nga mbajtja pastër e trupit, e kazermës...

— Po të jetë nevoja, të gjitha do t'i bëjmë, — tha plot vendosmëri Hajdari.

Dy ditë më vonë, aty te sheshi i madh përpara kazermave, buçiti muzika. Së bashku me Hajdarin dolëm me nxitim të shihnim. Ishte banda që ekzekutonte këngën e «Brigadës I Sulmuese».

Iu afruam pranë.

Ne të dy për herë të parë shihnim një bandë ushtarake.

Kur pushoi muzika, u rreshtuam dhe, sipas kompanive, filluam provat.

Mëngjezin e 28 Nëntorit brigadat u rreshtuan në bulevard për parakalim. Nuk po na pritej sa të shikonim Komandantin tonë të Përgjithshëm. U dha komanda «gatitu» dhe «për nder armë». Dëgjuam



mbyturazi kur u dha forca, e pastaj sheshi buçiti:  
«urra, urra!»

Sa doli shoku Enver në tribunë, banda filloi hymnin e flamurit. Kur mbaroi ekzekutimi, nga të katër anët shpërthyen brohoritje të fuqishme. Komandanti filloi fjalimin. Ai na kujtoi sakrificat dhe luftën që kishim bërë.

Kur u dha urdhëri për parakalim, e ndjenim veten të fortë e kryelartë, ashtu siç ishim në të vërtetë, se armikut i kishim dhënë drunë dhe e kishim shporrur nga trualli ynë. Në çastin që iu afruam tribunës, shtrimë hapin dhe sytë i mbërthyem te Komandanti ynë.

Pas parakalimit shkuam drejt në kazermë. Hajdari ishte në qejf, më hodhi krahun e më tërhoqi:

— Ama, fjalë burrash tha shoku Enver. I bëri të dridhen të gjithë armiqtë. Trim me fletë e kemi!

\*  
\* \*

Ditë më vonë na u qartësua nevoja e forcimit të disiplinës. Komisari, duke na folur për forcimin e ushtrisë si garanci e fitoreve, na lexoi fjalët e Komandantit të Përgjithshëm ku, midis të tjerash thuhej: «Mbeturinat e reaksionit nuk i kanë hedhur armët, por vazhdojnë në forma të ndryshme punën e tyre tradhëtare...

... Këtyre njerëzve të turpit dhe të korrupsionit, që për kolltuqe dhe për rehatë kanë ndihmuar okupatorin dhe tradhëtarët, u ardhka keq e u therka zemra «për të shkretët partizanë», që nuk «çmobilizohen». «Ç'na duhet kjo ushtri tani që u çlirua Shqi-

përia?», thërrasin, «Tani t'i hedhim armët dhe të marrim kazmat e lopatat»... Populli ynë dhe pushteti i tij mendon ndryshe: kurdoherë ka menduar ndryshe nga ata dhe, tamam për këtë arsye, ai rroku armët, luftoi e fitoi dhe tani do të vendosë vullnetin e tij. Ushtria jonë nuk i lëshon armët, deri sa të zhduket rreziku më i vogël për popullin...»

— E dëgjon, po na thotë të bëjmë sytë katër. — i thashë Hajdarit.

— More do t'i shtrëngojmë armët, se tyta e pushkës vendoska fatin tonë, — shtoi ai i vendosur.

Për ditë bënim mësim ushtarak dhe stërvitje. Por, ndërkohë, mësimin e shkrimit e të këndimit nuk e ndërpreme. Tani atë e bënim më të organizuar. Dora për të shkruar na qe stërvitur dhe lexonim pa na u marrë goja.

Gjithashtu, në mbledhjet e rinisë komisari i kompanisë ose i batalionit na fliste për situatën e brendshme dhe të jashtme. Aty midis nesh ndizeshin diskutime, se ishte pikërisht koha kur Këshilli antifashist kishte marrë vendimin për anulimin e borxheve dhe sistemi i vadiçjes u bë pronë e përbashkët e fshatarëve.

— Tani beu të hipë këtu e të shohë Stambollin, — tha Hajdari duke rrahur bërrylin me dorë. — Na e hëngri shpirtin, maskarai. Im atë pesë napolona i mori borxh, pesëmbëdhjetë vjet fajde kemi paguar dhe kurrë nuk u la ai i shkreti borxh.

— Kurse ne kaun nga agai e blemë për dy napolona e gjysmë. I paguam dy napolona dhe mbetëm keq për bukën e gojës. Po do ti që ajo gjysma e napolonit me kamatë u rrit dhe agai na u bë pjesëtar te kau, — u hodh e foli një tjetër.

— Toka u takon atyre që e punojnë dhe këtë



partia do ta bëjë realitet — tha komisari. — Tregëtarët nuk duan të paguajnë tatimet e jashtëzakonshme të luftës, ndërsa çifligarët e bejlerët duan të mbajnë fshehur drithin që është djersa e fshatarëve. Ne e dimë që ata do të rezistojnë, se shkojnë me shpresë se, kushedi, mos ndërrojë gjendja, por kot e kanë, se ne do t'ua marrim me forcë, do t'i shpronësojmë, që punëtori të bëhet zot i fabrikës dhe fshatari zot i tokës.

Në Tiranë nuk qëndruam gjatë. Me brigadën shkuaam në Gjirokastrë e pastaj në Delvinë. Atje u bë organizimi ynë i ri dhe ne u transferuam në Brigadën XX, ku na caktuan skuadërkomandantë. Iu përveleshëm punës.

Një ditë u mblodh e gjithë brigada. Do të na fliste komisari i brigadës.

Qemë grumbulluar te një shesh andej nga ura, ku shkonte rruga për në Sarandë. Të gjithë ishim ulur këmbëkryq. Komisari ishte një burrë i shkurtër, i hequr në fytyrë. Ai na foli për gjendjen e jashtme e pastaj për gjendjen e vendit dhe na njoftoi për aprovimin e ligjit mbi reformën agrare dhe krijimin e komiteteve të fshatarëve të varfër që do të merreshin me ndarjen e tokave.

Hajdarit ju mbushën sytë me lot. Komisari shpalosi gazetën e nisi të lexonte: «... Vendimi historik i Këshillit Antifashist mbi shpalljen e ligjit të reformës agrare do të depërtojë si rufe në të gjithë Shqipërinë dhe te dera e çdo kasolleje, çdo bujk shqiptar do t'i thotë gruas dhe kalamajve: «S'jemi më skllevër! Sot gjithë toka është jona, përjetë jona»...

U hodhëm përjetë nga gëzimi pastaj ia morëm këngës e valles si për dasmë.

— Babai e ka për ta puthur tokën, se ka hequr shumë, — më foli Hajdari e psherëtiu.

Pas disa kohësh ne lexuam në gazetë se Komandanti i Përgjithshëm u kishte dhënë me dorën e tij tapitë e tokave disa familjeve të Myzeqesë dhe u kishte thënë: «E trashëgoftshi brez pas brezi!». Çdo gjë kishte marrë fund.

Ditë më vonë në brigadë u derdhën letrat që dërgonin familjet, të cilat flisnin për reformën agrare. Edhe Hajdarit i erdhi një letër. Në çastin që po e hapte, duke buzëqeshur, unë bëra të largohesha.

— Dale, mos ikë, do ta lexojmë të dy, — dhe filloi ta lexonte.

Me sa më kujtohet, i ati i shkruante:

«I dashur biri im,»

Atë kohë ndjeva mall për njerëzit e mi dhe m'u bë sikur edhe unë po dëgjoja zërin e babait.

«Këtej na erdhi reforma agrare. Komitetin e fshatarëve të varfër, së bashku me inspektorin e reformës agrare dhe teknikun që do të maste tokat, i pritëm si s'ka më mirë, me këngë e valle. Morëm tokën që e kemi vaditur me djersë. Na ra në pjesë edhe toka te gryka e përroit që ti e kishe sevda. Partia na dha edhe tapitë. Qehajai i ka ulur veshët, ka mbetur si ai qeni i zgjebosur...»

Kur Hajdari mbaroi së lexuari, mbeti një çast i habitur, pastaj tha:

— Desha të më shkruante dhe më shumë babai. Duket se ata maskarenjtë qenkan gjallë dhe nuk i paskan futur brënda, — dhe dëgjoja kërcëllimën e dhëmbëve të tij.

Ditë më vonë më erdhi edhe mua letër nga shtëpia, ku më thoshin se kishim marrë tokën dhe pjergullën që ishte te vidhi aty ndanë shtëpisë.



Konferencat politike zhvilloheshin rregullisht dhe ne ndjenim nga afër vështirësitë që kish partia dhe pushteti për rindërtimin e vendit. Ne tani ishim shumë të qartë, se armiku i klasës, i ndihmuar moralisht e materialisht nga imperializmi anglo-amerikan dhe fqinjët tanë në kufi, do të mundoheshin të rezistonin e të organizoheshin për të rrëzuar pushtetin, prandaj lufta jonë duhej të bëhej më e ashpër.

Në brigadë nuk qëndruam shumë kohë. Në qershor të vitit 1946 na dhanë urdhërin e transferimit për në komandën e Qarkut të Mbrojtjes së Popullit të Gjirokastrës. Të dyve na caktuan me shërbim në burg. Puna që me të vërtetë e rëndë dhe delikate. Sytë duhej t'i bënim katër. Shërbimi në burg për ne që një shkollë e vërtetë. Ne morëm pjesë në shumë procese hetuesie të kriminelëve të luftës, sabotatorëve dhe armiqve të çdo kallëpi dhe aty u njohëm edhe më mirë me egërsinë, me të cilën po na luftonin armiqtë tanë.

Kështu që, kur na erdhi urdhëri i transferimit për në regjimentin VIII të Divizionit të Mbrojtjes së Popullit, ne qemë të bindur për domosdoshmërinë e luftës kundër bandave të kriminelëve që përfaqësonin bërthamën bazë të ushtrisë kundërrevolucionare, ku kishte mbështetur shpresat imperializmi dhe reaksioni i brendshëm për kryengritjen e armatosur.

\*

\* \* \*

Komanda e Qarkut na dha disa ditë leje të shkonim në fshat për t'u takuar me njerëzit e shtëpisë. U gëzuam se kishim një kohë të gjatë pa vajtur andej dhe na kishte marrë malli.

U nisëm me kamion. Rrugës hasëm vështirësi, se kamioni ecte shumë ngadalë në të përpjetën e qafës së Gllavës, kështu që në Berat mbërritëm me një orë natë. Megjithatë ne nuk qëndruam, po u nisëm më këmbë për te Ura Vajgurore. Duke ecur kujtuam luftën që kishim bërë mbi kala, në Kuçovë, pastaj fjala erdhi për atje ku formuam brigadën dhe ku u njohëm me Xhelalin e njerëzit e tij të shtëpisë në fshatin Gurëz.

— Ta ka qejfi të shkosh atje?

— Shumë. Ti e di sa më është lutur ai. Në çdo letër që më shkruan thotë se më pret.

E ndërpreme bisedën se dëgjuam zhurmën e një kamioni pastaj pamë dritën e fenerëve.

— Po e ndaloi, do të na bëjë nder, se, kështu si e kemi zënë, nesër në mëngjez mbërrim në shtëpi, — i thashë dhe i bëmë shenjë me dorë.

Kamioni ndaloi. Hipëm shpejt. Te Ura Vajgurore Hajdari zbriti dhe lamë fjalë që pas pesë ditësh të takoheshim te ura e Kuçit.



Hajdarin e gjeta ndanë urës.

— Kam dy orë që rri këtu si hu gardhi, — më tha duke më përçafuar. U ulëm të prisnim mos kalonte ndonjë maqinë dhe nisëm të bisedonim për ato që kishim parë e mësuar në fshat. Ai më tregoi:

Në mesnatë iu afrova shtëpisë. Murashi, qeni që e kisha lënë motak, më njohu. M'u hodh drejt, sikur deshte të më përçafonte. E shtrëngova fort, pastaj nisa ta ledhatoja.



— O Rakip, — i thirra vëllait të vogël dhe bëra për nga porta. Po askush nuk m'u përgjegj.

— Rakip, — thirra përsëri.

— Kush është? — dëgjoja zërin e babait dhe fillova të dridhesha nga emocioni.

— Jam unë, Hajdari, — i fola.

— Leme, ngrehu se na erdhi djali, — i tha babai nënës dhe sakaq ai u gjend pas portës.

Ashtu, gjysmë i zhveshur, me sy të përgjumur ai hapi krahët. Iu hodha në qafë dhe e shtrëngova fort.

— Të keqen nëna, o Hajdar, — mërmëriti nëna dhe më rrëmbeu në krahë.

Ndjeva afshin e saj të ngrohtë, dhe lodhja m'u largua në çast. Nëna po më ledhatonte flokët dhe nuk më la vend të fytyrës pa më puthur e pa ma lagur me lot. Qante nga gëzimi.

Rakipi, duke fërkuar sytë, m'u hodh në qafë, pastaj motrat.

Nën dritën e kandilit po shikoja njerëzit e shtëpisë. Ata ishin të gëzuar. Babai sikur ishte gjallëruar. Fytyra e nënës nuk ishte më ajo që shprehte pikëllim e frikë.

Refija, Sosja, dhe Rakipi kishin ndryshuar. Ata kishin hedhur shtat. «Koha ka bërë punën e vet» thashë me vete.

— Refije, hiqja këpucët tët vëllai, — i tha nëna motrës.

— Jo, jo! Kam duar vetë, — dhe nisa të zgjidhja lidhësat.

Të gjithë më vështronin.

Pyeta për Mahmutin, vëllanë e madh e për farëfisin, miqtë e bashkëfshatarët.

— Mahmuti ka shkuar me punë në Berat, po

është mirë, — më tha babai e pastaj nisi të më tregonte për të gjitha ngjarjet që nga ajo ditë, kur unë isha larguar nga shtëpia.

Blegërimat e deleve më bënë të hapja sytë. Dola jashtë te praku i portës. I vështrova delet që po dilnin nga kasollja dhe m'u kujtuan vitet e shkuara të fëmijërisë.

— E, si të duken? — më pyeti babai që doli pas tyre.

— Të shëndetshme janë.

Mbeta i mahnitur. Kudo syri të shikonte gjelbërim. Shtëpitë e fshatit nuk po më dukeshin të trishtuara si në vitet e shkuara. Tej në faqen e bregut bagëtitë tufa-tufa zbardhnin midis atij jeshillëku.

— Hajdar, ejani se ua ngroha qumështin, — foli nëna nga brenda.

Duke ngrënë, babai më tha se do të shkonte në ara. U mata të ngrihesha.

— Rri e çmallu. Ka të tjerë që më ndihmojnë, — më tha ai.

Ditët në fshat më kaluan pa i kuptuar. Ishte koha e prashitjeve. Punoja me qejf, se bujqët kishin bashkuar krahët e punës, pendët e qeve dhe punonin kolektivisht. Kur linim punën, aty rrëzë ledhit, bisedoja shtruar me bashkëfshatarët. Më tregonin për dallaveret që ishin munduar të bënin agallarët kur ishte bërë ndarja e tokave.

Edhe unë tregoja për luftën që po bëhej kundër armiqve. Më dëgjonin me aq vëmendje, sa, kur vinte koha të fillonim punën, ata ngriheshin, por ama mbanin mend se ku e kisha ndërprerë bisedën dhe, sa bënin pushimin tjetër, kërkonin që të vazhdoja.

Ditën që u nisa, bashkëfshatarët më përcollën gjer përtej fshatit. Në çastin që do të ndahesha me ta,



xha Dervishi, si u përshëndosh, më vështroi e më tha:  
— Ikë pa merak dhe këtej mos e ki mendjen, se babanë tënd do ta ndihmojmë ne kur të vijë koha e korrjes.

Dhe Hajdari e ndërpreu fjalën, se aty në kthesë u dha një kamion i vjetër.



Stërvitja taktike ditët e para na u duk e vështirë, në krahasim me atë që ne kishim mësuar në këmbësori. Si Hajdari edhe unë ishim qitës të mirë, por, megjithatë, puna këtu ndryshonte. Në përdorimin e armës dhe të granatave kërkohej të ishe i shpejtë dhe të qëlloje nga çdo pozicion. Po të takonte rasti të të caktonin në zbulim, me të parë kriminelin, duhej të hapje zjarr i pari, ndryshe e paguaje me kokën tënde ose të shokut që kishe përkrah, se banditët qenë të shpejtë dhe plumbi vështirë se u shkonte bosh. Pastaj bandat lëviznin vetëm natën, kështu që, kur të dalloje hijen e tyre, duhej të qëlloje shpejt mu në shenjë.

Na pajisën me municion e granata, na dhanë opinga për t'i përdorur në ndjekje, që të mos shkaktonim zhurmë gjatë ecjes.

Në afërsi të Rrëshenit mbërritëm aty nga pasditja dhe nisëm rrugën drejt fshatit Prosek. Ecnim në varg, ashtu si dikur, kur qemë partizanë. Aty para mesnatës, arritëm në afërsi të pyllit që ishte vendi ku do të vendosej prita e parë. Komandanti i kompanisë caktoi këtu Habibin, komandantin e skuadrës, Hajdarin, mua dhe gjashtë ushtarë të tjerë.

Në qendër të pritës, që u bë në formë trekëndshi, u vendos Habibi, Hajdari dhe unë, ndërsa në krahun e majtë e të djathtë u vendosën ushtarët tre e nga tre, që nuk ishin më larg se njëzet e pesë metra njëri grup nga tjetri. Urdhëri ishte që banda të lejohej e të futej brenda në trekëndësh dhe, kur të qëllonim ne që ishim në thellësi, atëhere të dy krahët anash do të hapnin zjarr të menjëhershëm. Habibi ishte caktuar të kërkonte parrullën, në rast se dikush do të vinte nga kompania.

Zumë vend të tre krah njëri-tjetrit. Qëndronim në heshtje. Habibi për çdo gjysmë ore u hidhte guriçka shokëve që ishin në krahun e majtë e të djathtë. Edhe ata përgjigjeshin me të njëjtën gjë; kështu ai sigurohej që ata nuk kishin humbur lidhjen.

Pushkët i mbanim gati për çdo të papritur. Sytë dalëngadalë po më mësoheshin me errësirën. Bënte ftohtë.

Dëgjoja Hajdarin që psherëtinte. Ma mori mendja se ai vuante si dhe unë, mbasi për herë të parë shkonim në ndjekje dhe nuk ishim mësuar me një pritje të tillë memece. Kurse Habibit, që ishte i stërvitur me këtë punë, nuk i dëgjohej as frymëmarrja.

Dy orë përpara se të agonte, qetësinë e natës e prishi një zhurmë që u dëgjua nga pylli. Shtrëngova belxhikun dhe u bëra gati. Isha i bindur se ajo zhurmë do të qe shkaktuar nga banda e kriminelëve, se ata kishin si taktikë të zgjidhnin vendkalime të tatë-pjeta dhe këtë e bënin me qëllim që, po të binin në ndonjë pritë, të vraponin shpejt për të çarë rrethimin, duke i hedhur granatat larg me lehtësi. Kështu, ata i krijonin vetes lehtësi të largoheshin e të fshiheshin.



Atë kohë Habibi u hodhi shokëve tri guriçka. Ishte sinjali që ata të ishin të gatshëm.

Pritëm kështu një kohë të gjatë, por zhurma as që u dëgjua më.

Me gishtin në këmbëzën e belxhikut mendoja: «Ku vallë ka shkuar banda? Mos ka qëndruar në pyll? Apo mos informata nuk ka qenë e sigurt?»

Me këto mendime në kokë na gjeti agimi. Kur rrezet e diellit nisën të dukeshin në majë të malit, Habibi thirri shokët e tjerë. U ngritëm me vështirësi se këmbët na qenë bërë akull nga të ftohtët.

— Ptu, ta marrë djalli! — shfryu Hajdari gjithë inat.

— U mërzite kaq shpejt? — e pyeti Habibi.

— Qëndruam gjithë natën dhe ata maskarenj nuk u dukën...

— Kjo do të ndodhë sa e sa herë, se ata janë kriminelë të sprovuar e nuk para bijen lehtë në kurthe, — tha Habibi, duke buzëqeshur.

Si të pirë nga pagjumësia e nga të ftohtët, u futëm në thellësi të pyllit, ku do të grumbulloheshim të gjithë. Sapo arritëm në vendin e caktuar, gjetëm komandantin e kompanisë dhe tre njësitet që kishin qenë në prita prapa fshatit. Fytyrat e tyre kishin marrë ngjyrë të hirtë dhe sytë i kishin të skuqur.

Në çastin që do të uleshim, komandanti na u drejtua:

— Do të shpërndahemi këtu përreth. Lëvizjet do t'i bëni me kujdes dhe pa zhurmë. Do të rrimë gjithë ditën këtu të maskuar. Ujët që keni në pagure e ruani me kujdes se askush nuk ka të drejtë të shkojë e të mbushë.

U ulëm të hanim bukë. Goja më ishte bërë far-mak. Hëngra një copë bukë dhe u pështeta te druri

i pishës. Humba në gjumë pa e kuptuar as vetë, por më zgjuan të goditurat e një sopate që dëgjoheshin andej nga fundi i pyllit.

— Të tre shkoni shpejt e shikoni kush është, por me kujdes, — na urdhëroi komandanti.

U futëm mespërmes pyllit, që vende-vende ishte shumë i dendur. Shkonim andej nga vinte zhurma e sopatës. Në të dalë të pyllit, jo shumë larg rrugës së ngushtë, pamë një grua së bashku me një djalë. Qëndruam aty të heshtur, duke vëzhguar gruan që godiste me sopatë drurin.

Djali i vogël, që nuk dukej t'i kalonte të tetë vjetët, si erdhi nja dy herë rrotull duke mbledhur copa drurësh, u ul mbi një trung të madh dhe ia nisi këngës:

*Marku i Gjonit e Gjon Listani  
Vjedhin dhi e i hanë ke stani  
Kët zanat ka kapidani*

Gruaja, sikur ta kishte pickuar diçka, hodhi sopatën, shkoi pranë djalit dhe i zuri gojën.

— Mbylle, se ata të maleve na vrasin, — i tha dhe vështroi sa majtas-djathtas gjithë frikë. Pastaj mblodhi shpejt ato pak dru dhe u largua, duke tërhequr djalin për dore.

Hajdari më hodhi një vështrim pyetës. Mua ma mori mendja se çfarë donte të më thoshte, se edhe unë isha gati të ngrihesha e t'i dilja përpara asaj gruaje mirditore e t'i thosha: «Lëre djalin të këndojë dhe ti merr sopatën e pre dru, se koha e kapidanëve ka mbaruar...»

Po dëshirën që na buronte nga thellësia e zemrës



ishim të detyruar të mos e shfaqnim, se urdhërin e kishim të prerë: «Të vëzhgonim e të heshtnim».

Me ndjekje e prita të fshehta vazhduam për një kohë të gjatë. Kishim qëndruar për pushim në pyllin e lagjes Ten të fshatit Malas. Pylli ishte aq i dendur, sa, po të futeshe në thellësi të tij, vështirë se e shikoje qiellin. Aty pranë nesh u ul dhe komandanti i kompanisë e komisari. Që të dy ishin të vjetër në repartet e ndjekjes, por komandanti kishte vepruar më shumë në këto anë dhe vendin e njihte me pëllëmbë.

— Ja, këtu në këtë pyll, Mark Gjon Marku me përfaqësuesit e të arratisurve të Kukësit, Dibërës, Pukës, Lezhës etj. në shkurt të vitit 1945 bënë mbledhjen dhe formuan «Komitetin e Maleve», si organ më i lartë i kundërrevolucionit. Aty ata krijuan shtatmadhorinë dhe shtabet ushtarake për zonat e ndryshme, të mbështetur në elementin reaksionar. Me qëllim që të trembnin popullatën dhe të hakmerreshin kundër përkrahësve e simpatizantëve të pushtetit, ata krijuan organin e shpagimit, të udhëhequr nga kriminelët më gjakpirës. Madje, për të bërë bujë, udhëheqësve të njëjsteve të formuara ilegalisht, u dhanë gradat dhe postet që do të kishin pas triumfit të kundërrevolucionit. Ndërkohë Mark Gjon Marku, «kryetari i Komitetit të Maleve», përhapi fjalën që të ruhej i shenjtë ligji i kanunit: «çdo derë mirditore i ka borxh një kokë princit të Mirditës». Veç kësaj, për të komprometuar shumë njerëz, Mark Gjon Marku me bandën e tij, grabitën të hollat e Ndërmarrjes së grumbullimit, të cilat ua shpërndau njerëzve të tij, gjoja sikur ato para i kishin dërguar anglezët si ndihmë për «Komitetin e Maleve».

Por shpresat e imperialistëve dhe të reaksionit

të brendshëm të mbështetura te «Komiteti i Maleve» nuk patën jetë të gjatë. Mark Gjon Marku gjeti vdekjen në përpjekje me forcat tona, kurse banda e tij u asgjësua.

Komandanti e komisari nisën të tregonin shumë episode për taktikën e luftës kundër bandave. Hajdari ua kishte qepur sytë dhe dukej sikur po ua rrëmbente fjalët nga goja.

Disa ditë më vonë ndodhi diçka shqetësuese. Dy ushtarëve që kishin kohë në repartet e ndjekjes, dalëngadalë iu dobësua të parët. I dërguam me urgjencë në spital. Pesëmbëdhjetë ditë më vonë, kur na dërguan ushqimet në pikat sekrete, përveç konservave të mishit e djathit kaçkavall kishin dërguar qepë, konserva me zarzavate etj. Infermieri i kompanisë na këshilloi t'i hanim të gjitha llojet e ushqimeve, për të marrë vitaminat e nevojshme, ndryshe shumë nga ne mund të sëmureshin.

Vazhdonim ndjekjen kundër bandave sipas planit të operimit. Në të shumtat e rasteve lëviznim nga një vend në tjetrin aq shpejt e larg sa i detyronim bandat të çorientoheshin. U gjendëm kështu në zonën e Bajrakut të Kthjellët. Me të marrë njoftimin se banda e Llesh Gjon Markut ishte dukur në zonën e Rubikut, me fshehtësinë më të madhe, u vërtitëm disa ditë me prita të fshehta, gjersa më në fund ramë në gjurmët e bandës.

Në errësirën e natës, sipër në pllajën e Valës, u duk zjarri. Nuk kishim çfarë të prisnim. Atje larg ndodhej banda.

Ecnim monopateve për të prerë sa më shkurt, në mënyrë që t'i rrethonim kriminelët përpara mesit të natës. Zumë shtigjet ku mendonim se mund të kalonte banda.



Kishte dhe një orë natë, kur iu afruam vendit. Pritëm aty të shtrirë sa nisi të agonte. Jo shumë larg pamë dy hije që po shkonin drejt pyllit.

— Ndal! Dorëzohuni! — u dëgjua zëri i Pejso dhe atë çast plasën granatat dhe krismat e pushkëve.

— Po vijnë këtej, — tha Hajdari dhe flaku granatën që plasi me krismë të madhe.

Për një kohë ata nuk u bënë të gjallë. Ne nuk lojtëm nga vendi. Pritëm aty buzë shkëmbit të heshur. Hajdari zgjati kokën nga shkëmbi. Atë çast një plumb fishkëlleu dhe këputi një cifël shkëmbi, ndo një pëllëmbë mbi kokën e tij.

— Dësh të mori në lule të ballit, o derëbadhë, — i thashë me zë të ulët.

Pas pak prapa nesh dëgjuam një zë që thirri:

— Hajdar! Ali! Shpejt këtej. — Ishte komandanti. Ai me zor merrte frymë, nga e përpjeta që kishte ngjitur.

— A i patë nga qëlluan? — pyeti ai.

— Janë midis atyre dy dushqeve, — ia pat Hajdari.

— Do të shkoni nga sipër. Duhet medoemos t'i shkulni që andej, po me kujdes. Kurse ju të dy, — dhe iu drejtua dy ushtarëve që sapo erdhën, — do të qëlloni kundër kriminelëve pa pushim, në mënyrë që ata të mos ngrenë as kokat.

Me të zvarritur u ngjitëm gjer sipër, pastaj u drejtuam për te vendi ku ndodheshin banditët. Por atë çast ata hodhën tri granata dhe nga ana e poshtme u bë tym. Duke përfituar nga rrëmuja që u krijua, ata ia morën vrapit dhe qëlluan, po Yzeiri dhe Mersini, që ndodheshin në pritë, i goditën me breshëri dhe ata mbetën të vdekur jo shumë larg tyre.

Me dy kafshë i zbritëm në Rubik, ku u identifi-

kuan. Ishin kriminelët Ndue Jaku dhe Ndrec Shkurti, pjesëtarë të bandës së Llesh Gjon Markut, që bënë pjesë në organin e shpagimit.

Gëzimi ynë që i madh. Sakrificat tona nuk shkuan kot. Do të ktheheshim me fitore në qendër të batalionit për një pushim të shkurtër.

Nuk shkoi shumë kohë dhe mësuam se midis shumë bandave që ishin asgjësuar ishte edhe ajo e Llesh Gjon Markut.



Banditët pikësnyimin e tyre e kishin që të kapeshin te njerëzit e thjeshtë të lidhur me pushtetin, t'i komprometonin ata dhe pastaj t'i vinin në shërbim të tyre. Kështu që ne, sa herë që na takonte të binim në kontakt me fshatarët, nuk e humbisnim rastin për të demaskuar armiqtë. Por puna e propagandës ishte një punë shumë e vështirë dhe delikate se na duhej të bënim dallim midis elementit armik dhe njerëzve të gënjyer nga propaganda e armikut, që me bandat nuk i lidhte asgjë.

Megjithatë ne e bënim shumë mirë propagandën e partisë. Me fshatarët bisedonim me zemër të hapur dhe me shembuj nga jeta jonë, u tregonim të mirat që na solli e që do të na sillte pushteti popullor. Kjo lloj propagande te fshatari zinte aq shumë vend, sa këshillat popullore dhe të frontit, kur shkonim ndër fshatra, na luteshin të qëndronim më shumë se koha e caktuar. Kështu që dalëngadalë ne u futëm thellë në masën e fshatarëve.

Një ditë zbritëm në fshatin Zallëdardhë. Ishim të



lodhur e të raskapitur. Së bashku me Hajdarin shkuan te përroi të laheshim e të pinim ujë. Aty mbi ledh, ndanë përroit, gjetëm një fshatar që, me sa dukej, qe ulur për të pushuar.

Ai, sa na pa, u ngrit të ikte, por Hajdari, që nuk para i shpëtonin këto raste, e përshëndeti me njerëzi dhe i afroi paqetën e cigareve. Vetë Hajdari nuk e pinte duhanin, por paqetën e mbante me vete.

— Jo, jo! Është punë që nuk bëhet. Do të të jap unë, se më gjete, — i tha tjetri dhe nxori nga xhepi i brendshëm qesen e duhanit prej lëkure të paargasur dhe të zhubravitur.

Ndërkaq unë zbrita poshtë, buzë përroit.

Hoqa opingat prej llastiku, që m'i kishin bërë këmbët gjithë djersë dhe futa këmbët në ujë. Hajdari me fshatarin ia kishin shtruar muhabetit.

Kur u ktheva te ata, ky i fundit iu drejtua Hajdarit me seriozitet:

— Askush nuk i do, por kanë frikë.

— Frikë?

— Po, po! Si nga ata djajtë ashtu edhe nga ju.

— Nga ne? E përse të kenë frikë?

— E po ja, të rrasin brënda, pastaj hajde e zgjidhe.

— Nuk është ashtu, more mik i dashur. Ja të marrim shembëll ty ose mua. Ç'na lidh ne me ata? A nuk kemi qenë ne gjithmonë të varfër? Pushteti na bëri zotër të tokës e të punës sonë. Ata na kanë pirë gjakun. Po qe se të zënë derën, këtë punë ata e bëjnë me qëllim që të të lidhin pas qerres së tyre. Në këtë rast unë ose ti me marifet lajmërojmë atje ku duhet, se asnjë nuk të dënon, por, përkundrazi, do të të nderojnë se bërë detyrën e patriotit dhe luf-

ton për të mbrojtur pushtetin tënd. E vërteta është kështu si po të them unë.

— Po sikur kriminelët të shpëtojnë? Shko e zgjidhe pastaj, se të thonë përse ikën...

— Këto janë fjalë të përhapura nga bandat dhe armiqtë e tjerë të brendshëm për të trembur njerëzit.

Pasi biseduan ndonjë orë, fshatari u largua. Hajdari tundi kokën.

— E, si t'u duk? — e pyeta.

— Nga sa kuptova, ai qenka vënë në hall. Donte të ma thoshte hapur, por kishte frikë. Jam i bindur se në shtëpinë e tij venë banditët dhe ai është mër-zitur prej tyre. Do t'i heqë qafe, por dyshon se mos e arrestojnë, meqë ka strehuar kriminelë.

— Ku u bazove ti? Po të bëheshin zbulimet kaq shpejt, nuk do të ishte nevoja të na binte bretku duke i kërkuar.

— Ashtu është, por te ai unë vura re diçka të veçantë.

— Ç'na qenka kjo gjë e veçantë jotja, — i thashë me qesëndi.

Hajdari më vështroi.

— Dëgjo një herë e pastaj tallu.

— Folë, se po të dëgjoj.

— Ti dhe unë kemi biseduar me shumë fshatarë. Disa janë të shqetësuar për detyrimet, se ende nuk e kuptojnë rëndësinë e tyre. Kurse ai miku i kalonte si gjëra të parëndësishme dhe bisedën e binte rrotull për të arratisurit. Donte të sigurohej se do të kishte pasoja apo jo po të denonconte.

Sapo shkuam te shokët, që ishin grumbulluar poshtë te tre lisat, Hajdari shkoi e foli me komandan-tin. Kur erdhi, m'u afrua pranë e më buzëqeshi.



— Të thashë që kam të drejtë? Ata ishin në një mendje me mua.

— Kush? — pyeta nga që nuk e kisha mendjen atë çast.

— Komandanti, madje edhe komisari.

— Si në një mendje? — dhe e vështrova drejt në sy.

— Ata arësyetuan shumë më mirë se ne. Thanë se elementi i lëkundur, viktimë e propagandës së armikut, po bindet çdo ditë e më tepër se forca e pushtetit është e madhe. Kështu që ata duan të shkëpusin përgjithmonë lidhjet me bandat, por tremben dhe tani qëndrojnë sa me ne, sa me ata. Dhe përse ndodh kështu? Se ata nuk e kanë të qartë politikën e diferencimit dhe të luftës sonë, për të shpëtuar njerëzit e thjeshtë, që të mos kalojnë në barrikadën e armikut.

Unë e vështrova duke buzëqeshur.

Ndoshta kjo ngjarje do të ishte harruar, por komisari i kishte vënë në dijeni organet e SMP<sup>1)</sup> dhe pas dy muajsh ne mësuam se ai që kishte shtëpinë e vëçar ndanë pyllit, paskësh qenë me të vërtetë strehues i kriminelëve. Organet e SMP e bindën fshatarin dhe ai pranoi të bashkëpunonte, gjersa bandën e futëm në kurth dhe e asgjësua.



Nga mesi i muajit mars ndodheshim të grumbulluar në qendër të batalionit. Sa mbaruam stërvitjen, mua dhe Hajdarin na thirri komisari.

---

1) SMP — Seksioni i Mbrojtjes së Popullit.

Kur hymë në zyrë, komisari na buzëqeshi dhe nuk na la të paraqiteshim.

— Do të shkoni te instruktori politik i batalionit për të përgatitur dokumentat e partisë. Ai po ju pret.

Lajmi i gëzuar na dehu, ne mbetëm si të ngrirë e nuk po lëviznim, nga vendi.

— Kaq kisha, — shtoi ai që e kuptoi se ne e humbëm.

Nderuam e dolëm jashtë. Instruktori politik na dha nga një fletanketë dhe na tregoi tavolinat ku të uleshim për të shkruar. Pasi u ulëm, instruktori erdhi aty pranë nesh dhe nisi të na shpjegonte se si duhej t'u përgjigjeshim pyetjeve të fletanketës.

— Kurse në autobiografi do t'i shkruani të gjitha, që kur keni qenë të vegjël e gjer më sot. Mos harroni të shkruani për prindërit, vëllezërit e farefisin, ç'punë kanë bërë e bëjnë, qëndrimin e tyre gjatë Luftës nacionalçlirimtare dhe tani pas çlirimit, — shtoi ai.

Hajdari rrotulloi nëpër duar disa herë fletanketën, pastaj e vuri mbi tavolinë e iu drejtua instruktorit:

— Me gojë mund t'i përgjigjem pyetjeve të fletanketës, por me shkrim nuk jam në gjendje se nuk shkruaj bukur.

— Rëndësi ka që të përgjigjesh drejt, — tha instruktori.

— A nuk do të ishte më mirë që ju të na ndihmoni që fletanketa të jetë shkruar bukur? Ndërsa firmën poshtë do ta vë vetë.

— Edhe kjo mund të bëhet, — tha ai dhe i thirri Dhorit, përgjegjësit të rinisë së batalionit.

Atë çast m'u duk sikur Hajdari më hoqi një barrë të rëndë.



«Të lumtë, — thashë me vete, — kurse unë jam ende i drojtur».

Filluam punën për të plotësuar fletanketën. Me ca pyetje e sqarime, më në fund arritëm ta çonim deri në fund. Tani duhej të shkruhej autobiografia. Më kujtohet kur Hajdari i thoshte Dhorit që të shkruante: «Unë jam i vendosur që ta vazhdoj luftën, prandaj kërkoj të futem në parti, se jeta ime është e lidhur me të. Ajo për mua është gjithshka. Kush tjetër përveç partisë do të më jepte këto të drejta? Perëndia, së cilës më kot i jemi lutur brez pas brezi, beu që nuk kishte pikë mëshire e që ishte gjithmonë i pangopur, Zogu apo fashizmi? Të gjithë kërbaçin na tregonin. Kurse partia më zgjoi, më mësoi, më bashkoi me shokët në luftë kundër shtypësve dhe ne fituam. Tani ajo po më mëson si ta mbaj e ta mbroj pushtetin për të ardhmen e gëzuar...»

Qëndruam gjithë paraditen sa plotësuam në rregull dokumentat. Kur dolëm jashtë, ndjeheshim të gëzuar. Ajo ditë kaloi pa u kuptuar. Më 18 prill na lajmëruan se celula do të shqyrtonte pranimin tonë në parti.

Kur u mblodh celula, ne rrinim jashtë derës e prisnim. Të parin thirrën Hajdarin. Prisja me ankth sa të dilte Hajdari e të futesha unë. Isha i bindur se atë do ta pranonin pa diskutim, për karakterin, trimërinë, vendosmërinë e sjelljen e tij të mirë.

Dhe ajo që parandjeja u vërtetua. Hajdari doli i gëzuar.


— Më pranuan, — tha ai dhe më përqafoi.

— Po hë, më thuaj, si?

— Më bënë pyetje e pastaj diskutuan. I pari foli komandanti, Habibi e pastaj të tjerë.

— Çfarë të thanë?

Po ai nuk arriti të më tregonte, se atë kohë më thirrën të futesha brenda.



U nisëm për në ndjekje kundër bandave. Do të vepronim në zonën e Mamurrasit, Krujës, Mirditës e pjesërisht në atë të Burrelit. Detyra jonë në këtë periudhë ishte që, me zbulime, me prita dhe me manovrime të shpejta, të detyronim banditët të vihe-shin në lëvizje, që t'i asgjësonim ata, pas grushtit të fortë që kishin ngrënë nga pikëpamja politike, me zbulimin e shkatërrimin e komplotit të grupit të deputetëve. Kjo situatë kërkonte që të bënim të gjitha përpjekjet, që bandat të mos kishin siguri edhe ndër ata baza që ata i quanin të tyre.

Kënaqësia jonë më e madhe në ndjekje ishte se shikonim që veprimtaria e armikut sa vinte e dobësohej. Elementi i gënjyer dhe i lëkundur nga propaganda e tij dalëngadalë jo vetëm që nuk po e përkrahte, por po ngrihej me armë kundër tij.

Muajt e dimrit me shi, borë e të ftohtë i kaluam në ndjekje të pandërprerë. Kështu që pranvera e vera i gjeti bandat e kriminelëve të demoralizuar shumë. Dhe rezultatet e këtyre ndjekjeve dhanë përfundimet e dëshiruara. Frano Miri, së bashku me bandën e tij, ra në duart e SMP; një numër bandash u asgjësuan; banda e Frrokut, që qarkullonte në zonën e Rrëshenit, u detyrua të copëtohej; Mark Cara, ish-anëtar i shtabit ushtarak dhe pjesëtar i organit të shpagimit, së bashku me Preng Gjeçin, që bënin pjesë në



bandën e Frrokut, tani qëndronin të vetmuar. Asgjësimi i këtyre dy armiqve të popullit kishte rëndësi të madhe. Mark Cara ishte kriminel i rrezikshëm dhe me përvojë. Para pushtimit të vendit, për disa vite me radhë, ai ishte arratisur. Me ardhjen e fashizmit u vu në shërbim të tij dhe u inkuadrua në detachmentet ndëshkimore të milicisë me gradën e nëntogerit. Me batalionin e milicisë, të komanduar nga Tahir Mena, mori pjesë në shumë ekspedita ndëshkimore kundër forcave partizane. Me çlirimin e vendit, për t'i shpëtuar dënimit të popullit, ai, së bashku me shumë armiq të tjerë, u fsheh maleve. Aty vazhdoi punën e tij tradhëtare. Në fillim të vitit 1945 Marku u lidh me Mark Gjon Markun dhe ishte një nga pjesëtarët më aktivë të bandës për të grumbulluar të arratisurit rreth Mark Gjon Markut. Madje Mark Gjon Marku atë e mbante në bandën e tij, se ishte i shpejtë, ecte lehtë dhe kishte dëgjim të mprehtë. Si i tillë, ai ishte gjithmonë pararojë e bandës. Fama e Mark Carës ishte përhapur në Mirditë sikur atë nuk e zinte plumbi.

U endëm kështu ndër male e pyje të dendur në kërkim të tyre për një kohë të gjatë. Shpesh mbeteshim pa ngrënë, se largoheshin shumë nga pikat e furnizimit. Gjatë kohës që ne vazhdonim ndjekjen, organet e SMP vazhdonin punën e tyre. Më në fund ata ranë në gjurmët e tyre. Një ditë, në të perënduar të diellit, na erdhi njoftimi: «... Është e sigurtë se Marku dhe Prenga ndodhen në afërsi të pyllit Kallp. Nga mesnata ata do të largohen. Do të kalojnë nga livadhi, do të zbresin poshtë për të kaluar lumin e Tharkës...»

Vendi, ku ndodheshim ne, nga fshati Perlat ishte larg. Megjithatë u nisëm me shpejtësi dhe mbërritëm

aty nga ora dhjetë e natës. Pritat u vendosën varg gjer poshtë në lumë «te vahu». Komandanti i kompanisë erdhi në pritën ku ishim unë dhe Hajdari.

Hëna ishte e plotë, por era që frynte nga gryka e lumit na thante së ftohti. Përpara nesh ishte një livadh i vogël e pastaj vinte një pyll i shkurtër nën bojën e njeriut. Prapa, jo shumë larg vinte e tatë-pjeta e pyllëzuar që zbriste gjer poshtë në lumë.

Rrinim në pritë të gatshëm. Vështroja drejt nga pylli dhe, nën dritën e hënës, herë-herë drurët e pyllit më dukeshin sikur lëviznin, pastaj më bëheshin miza-miza dhe çdo gjë më errësohej.

Diku larg u dëgjua një e lehur qeni. Hajdari më tundi nga krahu që të isha gati. Hoqa ngadalë siguresën e belxhikut. Grykën e pushkës e drejtova nga rruga e ngushtë e dhive që të nxirrte në livadh. Po rrinim në ankth sa të vinte çasti. Por komandanti i kishte marrë masat dhe llogarinë e kishte bërë mirë. Për çdo pritë kishte gjashtë automatikë dhe tre pushkë, për të patur forcë zjarri qysh në goditjen e parë.

Dy hije qëndruan pa lëvizur për një kohë dhe bënë për në drejtimin tonë. I lamë sa u futën në livadh.

— Zjarr! — thirri komandanti.

Ia dhamë në batore aq shpejt, sa ata nuk patën kohë as të zinin vend. Megjithatë edhe ata na u përgjegjën me zjarr, dhe plumbat vërshëllyen mbi kokat tona. Por shkëmbimi i zjarrit nuk vazhdoi gjatë. Dy hije të zeza dukeshin qartë, të shtrirë midis livadhit.

Hajdari bëri në drejtim të tyre.

— Qëndro! Ku shkon? — i foli rreptë komandanti.

— Të shkoj përpara, — shtoi ai.



— Të presim, se nuk i dihet. Mos e hiqni vështrimin nga ata dhe, po lëvizën, hapni zjarr!

Qëndruam një çast, pastaj Hajdari duke u zvarritur u nis drejt tyre.

Duke ndjekur me sy siluetën e tij, qëndroja i gatshëm me gishtin në këmbëzën e pushkës.

— Hajdeni, se kanë mbetur të dy thes, — thirri Hajdari.

I gjetëm të rënë pranë njëri-tjetrit. Errësira nuk linte të dalloheshin fytyrat e tyre.

— Na duhet t'i çojmë poshtë në fshat, — tha komandanti.

— Gjer poshtë i heqim, zvarrë, — ndërhyra unë.

— Dhe pastaj të na mbetet që këta qenër t'i ngremë në krah? Më mirë të vemi në fshat, të gjejmë ndonjë kafshë dhe t'i ngarkojmë, — tha Hajdari.

— Kështu si thotë Hajdari do të bëjmë. Ti Ali shko në fshat e merr një kafshë. Kur të zbresësh poshtë, lajmëro shokët të lënë pritat e të grumbullohen te sheshi i shkollës, — përfundoi komandanti.

Shkova në fshat dhe u ktheva te vendi bashkë me kryetarin e këshillit dhe një anëtar të frontit që tërhiqte kalin për kapistre.

Sa kishte nisur të zbardhte dita. Të dy kriminelët ishin bërë shoshë nga plumbat. Ishin aq shumë të leckosur, sa edhe qeni nuk kishte ku t'i kapte. Flokët dhe mjekrat i kishin të rritura dhe u mbulnin fytyrat. Aty pranë Markut ishte një gavetë e mbushur me mish të zier, kurse Prenga kishte të varur një torbë, ku dukeshin masurët e mirrave.

— Për hundësh u doli misri i Nikollës nga Rubiku, që i vodhën tri javë të shkuara, — tha kryetari i këshillit dhe bëri me dorë të afronin kafshën.

— A do ta besojnë që Marku e hëngri plumbin?  
— pyeti Hajdari të dy fshatarët.

— Para një viti ndoshta jo, por tani populli është zgjuar. Pallavrat se Markun nuk e zë plumbi, nuk i ha më njeri. Ja, shikoni, pa rroba në trup kanë mbetur, më keq se kështu s'ka ku të vejë, — tha fshatari dhe tërhoqi kapistrën e kalit.

I ngarkuam dhe i çuam te sheshi ku ishte mbledhur populli i fshatit Perlat.

Vështroja njerëzit. Ata pritën të qetë sa u shkarkuan kufomat nga kafsha. Pastaj një burrë në moshë të kaluar u shkëput nga mesi i turmës dhe u drejtua nga banditët. Me shkopin që kishte në dorë, ai i lëvizi kokën të vrarëve dhe i vështroi mirë.

— Marku e Prenga janë. Qeveria e partia janë të forta. Na shpëtuan nga këta kriminelë, se me frikë shkonim rrugës, me frikë punonim, me frikë rrinim, edhe në kasollet tona, — shtoi plaku dhe i pështyu të vrarët.

Hajdari ia kishte ngulur sytë plakut.

— Të kujtohet kush është ky plak? — i thashë.

— Posi jo. Ai që na dha dhallë sipër në stan.

Burra e gra shkuan i panë të vrarët. Kufomat e tyre u ngjallën edhe një herë urrejtjen për krimet që ata kishin bërë.

\*  
\*  
\*

Pas një muaji u kthyem në qendër të batalionit. Bëmë mbledhjen e jashtëzakonshme të organizatës, ku punuam vendimet e Plenumit XI të KQ dhe u njohëm me veprimtarinë armiqësore të revizionistëve



jugosllavë kundër partisë e vendit tonë. Na u bë e qartë se ne duhej të forconim me urgjencë kufirin, për t'u prerë rrugën diversionit të armiqve në thellësinë e tokës sonë. Kështu, me shpejtësi, na transferuan në regjimentin e kufirit që u formua në Dibër dhe na caktuan në togën rezervë të regjimentit.

Aty, buzë kufirit, u ndodhëm ballëpërballë me armiqtë. Vendet ku ishin posta jonë dhe ajo e përtej-kufirit i ndante një përrua. Unë, Hajdari dhe dy shokë të tjerë, po ecnim bregores së përroit. Ata po na vështronin. Pas pak oficeri i grumbulloi ushtarët dhe diç u tha. Ata filluan të shanin me fjalët më të ndyra.

— Asnjë të mos ndalet, — tha Hajdari dhe vazhdoi rrugën.

Ata vazhdonin të ulërinin si qentë e tërbuar. Në çastin që ne do të kaptonim qafën, dëgjuam krismat e mitralozit dhe plumbat që fishkëllyen mbi kokat tona.

— Vrap te qafa! — briti Hajdari.

Të them të drejtën, gjaku më hipi në kokë. Sa zura vend pas gurit, lëviza me shpejtësi siguresën e pushkës dhe u bëra gati të qëlloja.

— Mos hap zjarr! — thirri Hajdari dhe më hodhi dorën mbi pushkë.

— Nuk u mjaftojnë të sharat, por dashkan edhe të na vrasin...

— Do t'i qëllojmë vetëm po të hedhin qoftë edhe një hap në tokën tonë. Janë provokatorë. A më kupton?

— Ke të drejtë, — i thashë.

Pas pak krismat pushuan. Ata të përtej-kufirit nisën të largoheshin drejt postës së tyre duke bërë titur e sharë.

Por në kufi të sharat e goditjet me armë, si

të thuash, nuk ishin gjë para provokacioneve të tjera që ishin shumë të rrezikshme. Buzë kufirit dhe në thellësi të tokës sonë, herë-herë ata futnin fshehurazi agjentë të tyre, të cilët hidhnin materiale propagandistike, ku i bënë thirrje popullit të ngrihej kundër partisë e qeverisë, provokonin dhe nxitnin njerëz që të arratiseshin së bashku me familjet e tyre, lidheshin me të arratisurit për të krijuar banda etj.

Për këtë, shërbimi në kufi u forcua shumë. Ishim të detyruar të qëndronim në prita në shi, borë e të ftohtë, sepse muajt e dimrit ishin koha më e përshtatshme për të kaluar kufirin.

Në mbrëmje Hajdarit, mua dhe katër ushtarëve të tjerë na u ngarkua detyrë të zinin pritë në dy shtigjet rrëzë kodrës nga ishte pylli. Sa zumë vendet, ia nisi një shi i furishëm që pastaj u kthye në breshër. Mbas mesnate koha u kthjellua. Era frynte e lehtë. Mali i Korabit që ngrihej lart e që dukej sikur bashkohej me qiellin, ishte ai që na tregonte se vija e kufirit nuk ishte larg.

Nga larg dëgjua zhurmë. Pas një farë kohe zhurma nuk u dëgjua më. Megjithatë ne rrinim të gatshëm. E dinim se bandat e diversantëve në vendet ku ata kishin dyshim, qëndronin në një vend për një farë kohe dhe përgjonin sa të siguroheshin mirë, pastaj nisin rrugën.

Më në fund pamë hijet e tyre që zbrisnin poshtë, njëri pas tjetrit. Qëndruam të gatshëm duke pritur që të katër kriminelët të futeshin te gryka.

— Zjarr! — thirri Hajdari dhe zëri i tij u shoqërua nga krismat e forta të armëve. Qëllonim drejt tyre pa kursyer fishekët. Por edhe ata kishin ecur me masa të forta sigurimi. Të tjerët që kishin mbe-



tur sipër tyre na i hodhën granatat pothuaj mbi kokat tona. Për fat, vendi ishte i pjerrët dhe granatat ranë më poshtë nga ku ishim vendosur ne. Kudo u ndez flakë. Shkëmbimi i zjarrit vazhdoi për një kohë të gjatë dhe ne nuk mundëm t'i gozhdonim plotësisht. Kur na erdhën në ndihmë dy njësitet e krahut të djathtë, mbeturinat e bandës së diversantëve u larguan. I ndoqëm nëpër errësirë gjer buzë kufirit, por ata arritën të hidheshin përtej.

Të katër diversantët u gjetën aty te gropa. Tre kishin vdekur, kurse njëri ishte plagosur rëndë e bërtiste nga dhembjet.

Nga hetimet e mëvonshme u zbulua se grupi i diversantëve përbëhej nga tetë vetë, të cilëve u qe ngarkuar si mision të shkaktonin turbullira në thellësi të tokës sonë.



Nga fillimi i muajit shkurt bëmë mbledhjen e përgjithshme të komunistëve, ku i deleguari i Seksionit Politik të Divizionit të Mbrojtjes së Popullit na punoi udhëzimin e Komitetit Qëndror të Partisë.

Mbledhja kishte një rëndësi të veçantë. Problemi ishte se një pjesë të madhe të nënoficerëve që kishin dhënë prova gjatë Luftës nacionalçlirimtare dhe pas çlirimit në ndjekjen kundër bandave të kriminelëve, Komiteti Qendror kishte menduar që, për nevoja të partisë, t'i shpërndante. Disa do të dërgoheshin në terren me punë partie e në pushtet, një pjesë do të dërgoheshin në shkollë për të dalë ofi-

cerë, ndërsa pjesa tjetër do të mbeteshin nënoficerë të karrierës në kufi.

Pasi foli i deleguari, shumë nga shokët tanë diskutuan. Në diskutimet e tyre ata shprehën gatishmërinë që të bënin ashtu si do të vendoste partia.

Kur dolëm nga mbledhja, nisa të mendoja për vete, kisha dëshirë të qëndroja në repartet e mbrojtjes, qoftë në ndjekje apo në kufi, se tashmë isha mësuar me këtë jetë. Fillin e mendimeve ma ndërpreu Hajdari.

— Ali, paske rënë në mendime të thella...

— Të thella që ç'ke me të. Mendoj se ku do të më caktojnë.

— Ama për këtë po e vret mendjen aq shumë?  
— dhe ai më goditi lehtë në gjoks.

— E vogël të duket kjo? — i thashë.

— Po dhe aq e madhe jo.

— Ti si do të bësh?

— Do të shkoj ku të më thotë, partia.

— Si? Edhe në fshat?

— Lufta dhe atje duhet bërë. Pastaj, o Ali, i deleguari na e tha hapur: «Ndoshta ndokujt do t'i pëlqente të qëndronte në kufi, por interesat sot e kërkojnë më shumë në sektorë të tjerë më të rëndësishëm...» Pastaj, në qoftëse do të nisemi pas dëshirave tona, për partinë nuk kemi për të menduar kurrë...

Kjo bisedë më hoqi atë lëkundjen që pata.

Pas disa ditësh na komunikuan se unë e Hajdari ishim ndër ata që do të shkonim në terren pranë vendlindjes.

Atë ditë e kaluam me këngë e valle. Në mëngjez oficerët e nënoficerët që do të mbeteshin në kufi na përcollën gjer jashtë qytetit. Hipëm në kamio-



na dhe u nisëm; ata po na përshëndesnin duke na uruar udhë të mbarë.

Maqinat që ecnin varg njëra pas tjetrës qëndronin në çdo qytet. Zbrisnin shokët, përshëndeteshim me ta e përsëri niste rruga. Numri ynë në çdo ndalesë pakësohej.

Po ja, aty te ura e Kuçit i erdhi radha edhe Hajdarit të zbriste.

— Shiko, të më shkruash, — më tha dhe më shtrëngoi pas vetes.

— Po, po! — iu përgjegja dhe sytë m'u mbushën me lot.

Kur ai u zhduk te kthesa e fundit, ndjeva një boshllëk dhe psherëtita. Isha ndarë nga shoku me të cilin kisha kujtimet e një lufte pesëvjeçare.

\*  
\*      \*

M'u desh një farë kohe të ambientohesha me jetën e fshatit që kishte punë e halle plot. Veç punës në bujqësi, ku ishte e domosdoshme të isha shembëll, duhej të punoja edhe me bashkëfshatarët për t'u sqaruar atyre politikën e partisë e të qeverisë, lidhur me sistemin e ri të grumbullimit, ku armiku i klasës na luftonte. Vështirësitë qenë të mëdha, se ata duhej të sqaroheshin për kushtet e rënda ekonomike që po kalonte vendi ynë.

Mora letrën e parë nga Hajdari. U gëzova pa masë se m'u duk sikur u takova me të. Ai më shkruante se organizata e partisë e Syzezit, që përmblihte edhe fshatrat Malas e dy Goricanët, e kishte caktuar të punonte me rininë e fshatit dhe të përgjigjej

për mbjelljet dhe dorëzimet, në bazë të planit të pushtetit. Më poshtë ai më shkruante: «I deleguari atëhere kishte të drejtë. Të punosh në terren qenka me të vërtetë e vështirë. Por ne nuk duhet të thyhemi. Sa herë që më del ndonjë pengesë, sidomos nga ato ekonomiket, lexoj letrën që udhëheqësi i partisë sonë i ka dërguar Safet Malajt. Atje e gjej forcën për të kaluar vështirësitë...

Kulakët punojnë shumë nën rrogëz. Ata përhapin lloj-lloj parullash, se, gjoja, toka nuk prodhon mish, vezë, qumësht e sa e sa të tjera si këto. Kur e shohin se nuk u del gjë, kapen pas mungesave e vështirësive që ka ekonomia për furnizim. Por ne luftojmë e punojmë dhe i demaskojmë edhe me shembujt tanë...»

Nga fundi i letrës ai nuk kishte harruar të më shkruante edhe çështjet e thjeshta personale: «Së shpejti këtej do të vijë Xhelali i Gurëzës. Ti e di mirë që mua më rreh mendja te Filja dhe besoj se do ta përfundoj...»

Kështu, letërkëmbimet tona vazhduan për një kohë të gjatë, si rruga e vetme që mbante gjallë miqësinë tonë.

\*  
\* \*

Megjithëse tregimet e Aliut më bindën, unë nuk mund t'i shkruaja pa u bërë një verifikim për saktësinë e tyre. Studjova historikun e Brigadës X S. u takova me bashkëkohësit e tij, ish-partizanë, komandantë e komisarë të periudhës së luftës e të reparteve të ndjekjes, që e kishin njohur Hajdarin nga afër



në luftë e në punë. Doli se Aliu, në tregimet e tij, nuk kishte ngatërresa ngjarjesh. Prandaj ato i shkrova pa asnjë ndryshim.

Në kërkimet e mëvonshme gjurmët e aktivitetit të tij i gjeta në repartet e ndjekjes nga fundi i muajit prill 1949, kur Hajdari mori nga komiteti i partisë njoftimin që të paraqitej urgjent te sekretari i parë.

Kur hyri në zyrën e sekretarit, vuri re se aty ndodhej një oficer, fytyrën e të cilit diku e kishte parë.

Pasi u përshëndosh me të dy, u ul në karrige.

— Si na shkojnë punët andej nga Goriçani?  
— e pyeti sekretari, duke i zgjatur paqetën e cigareve.

— Përgjithësisht mirë, — u përgjegj Hajdari dhe filloi t'i tregonte shkurt për gjendjen në fshat dhe për parullat që përhapnin kulakët.

— Për këtë edhe të kam thirrur, — ia ndërpreu fjalën sekretari dhe, pasi bëri me kokë nga oficeri vazhdoi: — Shoku është i deleguari i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe na ka paraqitur propozimin që ju të inkuadroheni në efektivin e batalionit special që është duke u krijuar. Komandant është emëruar ky shok. Ne, si komitet partie, duke marrë parasysh se ke shërbyer për një kohë të gjatë në repartet e ndjekjes dhe ke mjaft përvojë, e aprovuam këtë propozim.

Ishte koha kur imperialistët, në vlerësimin e gjendjes, të nisur nga vështirësitë e mëdha ekonomike në të cilat ndodhej vendi ynë, nga izolimi gjeografik, nga veprimtaria armiqësore e Koçi Xoxes dhe e revizionizmit jugosllav kishin arritur në përfundimin sa do të përmbysnin pushtetin popullor

kryesisht duke krijuar, organizuar dhe aktivizuar banditizmin politik...

Zbulimet armike, që punonin me etje për të shtuar numrin e të arratisurve, mundoheshin të merrnin lidhje me ta e të aktivizonin të gjithë kriminelët ordinerë që ndodheshin të arratisur. Përveç punës për shtimin e numrit, duke futur në radhët e tyre kuadro me përvojë e të pregatitur me kujdes, ato do të punonin për t'i marrë nën drejtimin e tyre të arratisurit brenda vendit, t'i organizonin, t'i furnizonin dhe t'i hidhnin në aksione kundër pushtetit popullor...

Hajdari e dëgjoi me vëmendje sekretarin dhe, kur ai mbaroi, tha:

— Për mua ka rëndësi që partia mendon të inkadrohem në batalionin special. Kur dhe ku duhet të paraqitem?

— Për këto çështje bisedoni me komandantin, — i tha sekretarit dhe i shtrëngoi dorën fort duke buzëqeshur.

Tri ditë më vonë Hajdari u la lamtumirën një-rëzve të shtëpisë, shokëve e bashkëfshatarëve dhe u nis për në Lezhë.

\*  
\*      \*

Në repart Hajdari mësoi me hollësi sa i nevojshëm që krijimi i batalionit special. Bandat e shpartalluara të kriminelëve, shumica e të cilëve kishin kaluar përtej kufirit, qenë rikthyer të pregatitura nga zbulimet e huaja dhe po mundoheshin të rigrupoheshin për t'u hedhur në aksione.



Toga në të cilën bënte pjesë Hajdari, u nis për operim në zonën e Kashnjetit. Gjithë natën, gjer herët në mëngjez, ata ruanin burimet, përrenjtë, rrugët këmbësore që hynin thellë në pyje, mirëpo diversantët, nga frika se mos binin në prita, shpesh nuk shkonin për të pirë ujë në burimet e përrenjtë dhe, për të shuar etjen, i lagnin buzët me vesën e mëngjezit që binte në gjethet e pemëve. Në pyje forcat gjenin edhe vende ku diversantët ndiznin zjarr. Përvoja në ndjekje i kishte mësuar të përcaktonin se kur ishte ndezur zjarri. Kështu, ata arritën të vinin në lëvizje bandën e Mark Jakut. Dy javë më vonë organet e sigurimit njoftuan se ai me bandën ndodheshin të strehuar në malet e fshatit Mnel.

U përgatitën dhe u nisën me shpejtësi. Vendi ishte gjithë shkëmbinj e gurë të thepisur. Në grykat ku mund të kalonte banda u vendosën prita të veçanta. Kur nisi të agonte, forcat panë hijet e diversantëve që po lëviznin drejt pyllit nga krahu i i djathtë, ku zona ishte më e dendur dhe mundësia për t'u larguar në rast rreziku ishte më e madhe. Mirëpo kriminelët nuk arritën të futeshin në pyll. Plasjet e granatave dhe krismat e automatikëve jehuan në të katër anët. Banditët, të çorientuar, u shpërndanë e zunë pozicione. Qëllonin me breshëri të shkurtëra dhe ndërronin vend shpesh. Kërkonin me çdo kusht t'i shmangeshin përpjekjes dhe të largoheshin përpara se të zbardhte dita. Me një sulm të furishëm ata vërshuan atje ku kishte zënë pritë Hajdari me njësitin e tij. Po e ndaluan sulmin, se aty ranë në një zjarr të dendur. Pasi luftuan gjysmë orë dhe nuk mundën të çanin dot rrethimin, ata u tërhoqën nga krahu i majtë, kaluan buzë përroit dhe sulmuan poshtë, te fundi i pyllit. Duke për-

fituar nga errësira, banda mundi të çante rrethimin, duke lënë dy të vdekur.

Në javën e dytë të muajit korrik, Hajdari me disa nënoficerë të batalionit, u thirrën në mbledhje nga komandanti. Ai u njoftoi se ishin caktuar për të shkuar urgjent me një mision me shumë rëndësi.

Me të dalë nga mbledhja, hipën në kamionin që priste jashtë derës së madhe.

Nisën rrugën, pa ditur ku do të shkonin. Të gjithë mendonin se do të venin në Tiranë, por, kur kamioni mori kthesën për në drejtim të Durrësit, shoku që ishte në krah të Hajdarit e pyeti:

— Thua të na çojnë në Durrës?

Hajdari mblodhi supet dhe nuk i dha përgjegje. Në Vorë kamioni mori kthesën nga e djathta. Kur iu afruan Durrësit, dielli ishte në të perënduar. Te ura e Dajlanit kamioni bëri përsëri kthesë dhe u drejtua për në Kavajë.

Zhurma monotone e kamionit e zhyti Hajdarin në një dremitje të lehtë.

Kur hapi sytë, pa se errësira kishte pllakosur ngado dhe dritat e maqinës ndriçonin dobët një pjesë të rrugës që shkiste me përtim.

— Ku jemi? — pyeti shokun që ndodhej përbri tij. Nuk mori përgjegje. Ai flinte.

— Kemi gjysmë orë që kaluam Fierin, — iu përgjegj Simoni, një shok.

Në Vlorë mbërritën në mesnatë. Kamioni qëndroi përpara godinës ku ndodhej Dega e Punëve të Brendshme.

Sapo zbritën, një oficer i shoqëroi në kazerme.

— Shtrihuni dhe merrni një sy gjumë, se nesër



do të nisemi përpara se të agojë, — u tha ai dhe u largua.

U shtrinë në krevate. Drita e elektrikut ishte e pakët dhe i jepte dhomës së madhe një pamje të çuditshme. Qenë të lodhur dhe gjumi i kapiti në çast.

\*  
\*  
\*

Pas mbledhjes që bënë me «Pëllumbin», punëtorin operativ, të dymbëdhjetë nënoficerët e batalionit u sqaruan për punën që i priste. Do të shoqëronin tre diversantë të hedhur me parashutë në vendin tonë nga zbulimi italian dhe do të qëndronin së bashku me ta gjersa të përfundohej misioni.

Detyra që me të vërtetë e rëndë dhe delikate, se ishte e para herë që do të ruanin armiqët e betuar, të palidhur, në malet e veshura me pyje e gremina e, sidomos, natën pa hënë e në kohë të keqe.

Vebiut nuk iu durua dhe i tha Hajdarit:

— Si do t'ia bëjmë për t'i siguruar?

— Punë si me sëkëlldi është. Por sytë do t'i bëjmë katër ditë e natë. Pastaj ti e dëgjove në mbledhje që na thanë: «Kjo punë ndryshon nga radhët e tjera».

— Po a u zihet besë atyre? Ne i kemi pasur të lidhur dhe janë munduar të arratiseshin, dhe jotani që janë të lirë...

— Ne nuk do të hamë bar. Në grykë do t'u hidhemi, po lëvizën, — dhe Hajdari e ndërpreu fjalën se diversanti i parë doli në prakun e derës. Kishte trup mesatar, fytyrë ezmere, flokë të zes dhe mustaqe të prera spic. Ai vështroi me drojtje dhe uli

kokën. Pas tij doli diversanti i dytë, një djalosh trup-gjatë, bardhosh në fytyrë. Më pas ishte i treti, me ca sy të fryrë e si të shqyera, me buzë të trasha e kokë të vogël.

Diversanti me mustaqe ishte kryetar i grupit dhe quhej nga ata të përtejdetit me emrin «Fiore».

Deri në një farë vendi ata udhëtuan me maqinë, pastaj nisën të ecnin në këmbë. Qielli kishte filluar të zbardhte, dhe yjet po e humbnin ndriçimin. Rruga nga po kalonin ishte e ngushtë e gjithë shkëmbinj.

Ecnim me vëmendje, se vende-vende rruga kalonte rrëzë malit dhe dukej sikur do t'i zinte nën vete. Ndërsa në krah, poshtë, ishte humnera.

Hajdari ecte në krah të Fiore, me hap të sigurt, i gatshëm për çdo të papritur.

Qëndruan për të pushuar sipër në qafën e malit. Diversantët vështruan tej malet, pikërisht andej ku i kishte lëshuar aeroplani.

Hajdari ishte ulur mbi një shkëmb të vogël dhe vështronte poshtë grifshën që fluturonte nga një pishë në tjetrën e trembur.

Qeshi. «Grifsha nuk do njerëz të huaj në vendin e saj», i tha shokut që kishte aty pranë.

Në vendin e caktuar mbërritën shëndoshë e mirë. Mirëpo aty mbetën me të vërtetë të habitur. Aparatet e radiostacioneve dhënës e marrës ishin të vendosur në shesh e të gatshme për punë. Një oficer i pakët e i hequr në fytyrë, me pseudonimin «Lidhja», kishte vënë në vesh kufjet dhe po rrotullonte çelësin e radios.

Kur ata u ulën të pushonin, erdhi «Pëllumbi» që ishte bërë qull në djersë. Si vëhtroi përreth, ai i bëri me shenjë «Lidhjes» të shkonte te ai.

Hajdari vështronte diversantin me emrin «Fio-



re», që kishte vënë një fije bari në gojë dhe e lëviste në buzë mendueshëm. Ishte banor i kësaj krahine, prandaj dhe zbulimi armik i kishte caktuar këtë zonë. Pa hequr sytë nga ai, Hajdari pyeste veten: «Mos vallë i kujtohen vitet e kaluara të fëmijërisë, kur bridhte i shkujdesur në këto anë?» Dhe i përgjigjej vetë: «Por ti tashmë e ke tradhëtuar këtë vend të shenjtë, i verbuar nga shkëlqimi i parasë; ti i ke hedhur mënjanë ndjenjat fisnike që të lidhin me atdhenë; apo ndoshta ti mendon ato kohë «të mbara», kur, si zëvendëskomandant i policisë, tundeshe e shkundeshe me kobure në brez, duke e zhytur thellë e më thellë dorën tënde në gjak shqiptarësh te pafajshëm? Këtë po, me siguri, këtë mendon, tek po përdredh në buzë atë fije bari që po humbet ngjyrën...»

Diversanti me emrin «Fosko» e kishte mbështetur bërrylin në tokë dhe pinte cigare duke ndjekur me sy shtëllungat e tymit që ngriheshin lart e shpërndaheshin sakaq.

Pranë tij qëndronte diversanti me emrin «Mosko», i cili dukej i shqetësuar në fytyrë dhe diç bluan-te në mendje. Kaluan orë dhe «Moskoja» ishte në të njëjtën gjendje. Në drekë hëngri shumë pak e si me zor.

Shqetësimet e «Moskos» ranë në sy edhe të shokëve të tjerë.

— Si të duket? — i tha Hajdari Ramadanit, shokut të vet.

— I shqetësuar shumë. Shikoja sytë si i lëviz sa andej këtej me frikë!...

— Ki kujdes se mos na bën gjë, djalli, — tha Hajdari dhe shkoi të «Pëllumbi» që ta informonte për gjendjen.

Afroi mesnata që pritej me aq ankth. Përreth ishte qetësi. Vetëm fishkëllima e bulkthit dëgjohej pa ndërprerje. Dy lampa të vogla ndriçonin dobët fytyrën e «Lidhjes» që rrinte pranë radios. «Foskoja», dhe «Lidhja» që e kontrollonte, vunë në vesh kufjet, mbajtën përpara letrën e numrave të shifruara. Diversanti nisi të jepte të dhënat. «Tak, tak», ndiheshin goditjet e morsit që çanin rrugën përtej detit. «Lidhja» dëgjonte me kujdes sinjalet që jepte «Foskoja» dhe vështronte «Pëllumbin» duke tundur kokën në shenjë aprovimi. Hajdari e shokët e tjerë vështronin me kureshtje luftën e heshtur që po bëhej midis organeve të Sigurimit të Shtetit dhe zbulimit armik. Më vonë Hajdari mësoi edhe për pregatitjen e kësaj radioloje. Ja ç'kishte ndodhur:

«Besniku», udhëheqësi kryesor i veprimeve, i drejtoi vetë hetimet kundër grupit të diversantëve dhe pas shumë pyetjesh e ballafaqimesh, me prova të pakundërshtueshme, u siguruan të dhëna shumë të rëndësishme.

Grupit të diversantëve, përveç detyrave të posaçme që u ishin dhënë, iu zbuluan parullat, zona e veprimit me koordinatat, udhëzimet që kishin për datën e fillimit të transmetimit, me çfarë radioje do të punonin dhe kohën e caktuar për lidhjet, kush do të fliste i pari, kush i dyti e të tjera të dhëna të nevojshme.

Kjo u arrit pas një punë të madhe psikologjike me grupin e diversantëve. Kryesorja ishte që ata të bindeshin se veprimtaria e tyre dhe ato që zbulimet armike do të ndërmerren në të ardhmen do të dësh-tonin. Nga kjo punë diversantët u detyruan të pranonin se e vetmja rrugëdalje ishte të punonin në organet e Sigurimit të Shtetit.



Me të dhënat e grupit të diversantëve organet e Sigurimit të Shtetit u përgatitën me të gjitha hollësitë e nevojshme, për të ndërmarrë një punë të hollë e shumë delikate kundër agjunkturës italiane.

Edhe për shqetësimin e «Moskos», nga sa mësoi Hajdari më vonë, kishin marrë masa «Besniku» dhe «Pëllumbi». Ata e dinin se qendra e zbulimit njoftimet me radiogram i priste vetëm nga «Moskoja» pavarësisht se të tre ishin në gjendje të punonin me radio dhe njihnin kodin e shifrës.

Me qëllim që «Moskoja», si ndërlidhësi kryesor i grupit, të izolohej për aq kohë, u shfrytëzua me shumë takt gabimi i pilotit, që, në lëshimin e diversantëve, kishte lëvizur nga vendi i caktuar. Kjo jepte mundësi të përdorej «Foskoja» si ndërlidhës, përdërisa tjetri të «shërohej» nga plagët që kishte marrë gjatë rënies me parashutë.

Por qendra e zbulimit, megjithëse e vazhdonte në rregull punën me grupin e diversantëve, vazhdonte të bënte herë pas here kontroll, për të hequr çdo dyshim, duke shtyrë nga një javë në tjetrën plotësimin e kërkesave të grupit.

Më në fund, pas shumë përpjekjesh, qendra e zbulimit italian hyri në vallen që shkante pas ritmit të morsit «tak, tak, tak».

\*  
\* \*

Një mbrëmje, kur sapo kishte rënë errësira, Hajdari e tre shokë të tjerë morën urdhër të përgatiteshin për rrugë. Do të shoqëronin punëtorin operativ, së bashku me diversantin «Fiore», në një mision të rëndësishëm.

U veshën me rrobat e diversantëve dhe u nisën për rrugë. Nuk kishin ecur as gjysmë orë, kur ia nisi shiu. Errësira ishte aq e zezë, sa rruga mezi dallohej. Shpejt këpucët iu ngarkuan me baltë të kuqe dhe ishte rrezik të rrëshqisnin nga një çast në tjerin. Ecnin me kujdes.

Nga mesi i rrugës, në një të përpjetë, «Fiores» i shkau këmba.

— Oh! — thirri ai.

Hajdari e zuri në çast përkrahu.

— Vazhdoni rrugën, — tha Hajdari.

Në mesnatë ata mbërritën në afërsi të shtëpisë-objekt. Punëtori operativ i urdhëroi të qëndronin. Atë kohë tre ndriçime xixëlluan në errësirë.

— Prisni këtu, — shtoi operativi dhe shkoi andej nga xixëlluan dritat. Por nuk u vonua. Iu afruan shtëpisë-objekt. Hajdari dhe Ramadani zunë vend nga ishte dritarja, dy të tjerët përballë portës, ndërsa operativi me «Fioren» morën drejtim për të hyrë brenda.

Shtëpia ishte e vjetër, me mure vende-vende të plasura. Në atë shi që binte me rrëmbim, ajo dukej sikur do të shembej nga çasti në çast.

Dy të trokitura u dëgjuan në derë. Pas pak nga të çarat e kanateve të dritares, shndriti drita e kandilit.

— Duket se ata i prisnin, — i tha Ramadani Hajdarit me zë të ulët.

Pas një gjysmë ore në dhomë u bë përsëri errësirë. Ata dolën nga shtëpia dhe të gjithë së bashku morën rrugën andej nga kishin ardhur. Në të aguar mbërritën në bazë. Ishin të raskapitur. Zhveshën rrobat që u qenë bërë qull dhe ranë të pushonin.





Në mesnatë ishte ora e takimit me qendrën e zbulimit; «Lidhja» dhe «Foskoja» me kufjet në vesh, shënonin njoftimet që jepte Roma. Kur mbaruan, ndihmësoperativi, me letrën në dorë, shkoi të deshi-  
fronte radiogramën.

Hajdari po rrinte aty pranë «Lidhjes» e diversantëve dhe dëgjonte me vëmendje bisedën e tyre për llojet e aparateve të radiostacioneve. Por nuk qëndroi gjer në fund se e lajmëruan për të marrë shërbimin.

Gjatë kohës që Hajdari e shokët e tij bënë roje, «Pëllumbi» kishte nxjerrë një të dhënë shumë të rëndësishme nga «Fiorja», që siguroi vazhdimin e mëtejshëm të punës dhe që kishte lidhje edhe me personin e shtëpisë-objekt, ku ata kishin vajtur atë natë.

Këtë gjë Hajdari ndoshta nuk do ta kishte mësuar, por, pas tre muajsh, kur kishte mbaruar veprimi e kishin zbritur në qytet, ishte takuar me ndihmësoperativin, i cili i tregoi:

— Kur ti shkove të merrje shërbimin, pas pak erdhi «Pëllumbi». Ashtu i qetë siç është, ai u ul dhe hyri në bisedë. Fjala hapi fjalën dhe shkoi gjer te shpërblimi që u paguante diversantëve qendra e zbulimit. «Pëllumbi», me të qeshur, iu drejtua «Fiores»:

— Paratë që u jepnin si shpërblim i mbanit me vete, apo i siguronit në bankë?

— Në bankë? Në asnjë mënyrë!

— I prishnit të gjitha?

— Përkundrazi. I ruanim dhe shkonim me shpresë që t'i shtonim.

— Duket se blenit aksione?

— Aksionet kishin një fitim shumë të vogël dhe donin kohë të gjatë. Pastaj me ato nuk kishte siguri, se në të shumtat e rasteve shoqëritë aksionare falimentonin ose përhapnin lajme se ishin duke falimentuar. Kështu të detyronin t'i shisje me gjysmë çmimi ose me një të katërtën. Me aksionet andej bëhej biznes i madh. Ndërsa me kambiale po, kishte leverdi, se i jepje një me dy për një kohë të shkurtër.

Operativi qeshi:

— Tani që ti mbete këtej, ata që të kanë borxh do të gëzohen?

— Nuk kanë me se. Kur u nisa, vetëm një kambial prej pesëmbëdhjetëmijë liretash më mbeti një duhanshitëse në rrugën nr. 28, mbasi afati i skadimit ishte pas një muaji.

— Sido që të jetë, duhanshitësja i përfitoi?

— Nuk do ta ketë atë fat, se ajo nënshkroi një kambial të ri në emër të «De Lenës». Madje, kur ia dorëzova atij, ishim vetëm për vetëm.

— Domethënë paratë t'i paska gllabëruar «De Lena», si përgjegjës i kursit?

— Në djall të shkojë me gjithë paratë, — tha ai i dëshpëruar.

Operativi atë çast iu drejtua «Fiores» me ton serioz:

— De Lena është i shqetësuar dhe pyet nëse i ke dhënë ndonjë tjetri para borxh...

— Ai pyet për këtë?

— Po!

— Ai e di mirë se unë nuk i kam dhënë askujt para. Ç'kërkon tani? — mermëriti «Fioria».

— Të kujton të kaluarën.



— Le të bëjë si t'i pëlqejë. Shpresë për t'u kthyer atje më s'ka.

— Veç pesëmbëdhjetëmijë lretave që të ka borxh duhanshitësja, të tjera nuk ke shpërndarë?

— Jo.

— Ta besojmë si të vërtetë? — i tha operativi, por me një ton të tillë që diversanti «Fiore» ndjeu se diçka serioze ishte pas kësaj.

— Për këtë jam i sigurt, se paratë i kam dhënë me duart e mia. Pastaj ne për para vrasim njëri-tjetrin dhe jo t'i lëmë të na i hajë ndokush për bu-dalla.

— A është e saktë sasia e të hollave dhe adresa?

— Shumë.

— Do mbani përgjegjësi, po doli ndryshe, — i tha operativi dhe e vështroi drejt në sy «Fioren».

— Jam shumë i sigurtë.

Operativi bëri radiogramën dhe pas dy orësh ia transmetoi qendrës së zbulimit, e cila po bënte drejt-përdrejt verifikimin e fundit. Sipas mendimit të qendrës së zbulimit, po të jepej brenda disa orësh informata e kërkuar, për ata do të quhej se grupi punonte i pavarur dhe nuk kishte rënë në duart e Organeve të Sigurimit Shqiptar. Në rast se informata nuk do të jepej në afatin e caktuar, grupin do ta quanin të djegur. Ata i kishin bërë llogaritë me kalem në dorë. Dinin kuadratin nga bëheshin njoftimet si dhe largësinë nga qyteti, me vajtje e ardhje, që ishte më shumë se shtatë orë. Pra, duke dhënë një kohë shumë të shkurtër, ata qenë të sigurt se do ta zbulonin, po qe se grupi kishte rënë në ndonjë kurth.

— Po ai diversanti radist që e kapën te stani mbi shkëmb, a të kujtohet? — i tha ndihmësoperativi Hajdarit.

— Si jo. E kam shoqëruar disa herë.

— Ai, së bashku me një grup diversantësh, ishte dërguar nga zbulimi grek për të verifikuar në se grupi i «Fiores» punonte i lirë. Diversanti radist ndër të tjera i kishte thënë se si grup ndodheshin në Greqi. Aty ishin futur në një kurs special. Një paradite përgjegjësi i kursit i kishte mbledhur dhe i kishte njoftuar se së shpejti do të ndërprisnin kursin dhe do të përgatiteshin për t'u hedhur në Shqipëri, me mision për të marrë kontakt, ose, në pamundësi, për t'u informuar për grupin e «Fiores». Para se të niseshin, përgjegjësi i kursit i kishte dhënë parullat, disa baza ku mund të merrnin të dhëna të sigurta, kodin e shifrës për të komunikuar... Në fund i kishte porositur të kishin parasysh se në këtë mision interesat e zbulimit grek ishin të mëdha.

Kaluan kufirin në një natë të errët, me tufan e me shi. Sa u futën në thellësi, sipas udhëzimit, u ndanë në dy grupe. Me shumë vështirësi, pas dymbëdhjetë ditësh arritën më në fund të merrnin kontakt me njerinë e shtëpisë-objekt. Aty mësuan se diversanti «Fiore», së bashku me grupin e tij, paskëshin shkuar atje. Njeriu i shtëpisë i kishte treguar se «Fioria» koken dhe dorën e kishte të lidhur, sepse aeroplani i kishte lëshuar mbi disa shkëmbinj. Të dhënat e tij përputheshin plotësisht me ato që u kishte dhënë përgjegjësi i kursit kur u nisën.

Kryetari i grupit e urdhëroi që të shkonte me shpejtësi te stani mbi shkëmb, ku ishte baza e tyre e sigurt. Sa dha njoftimin me radio dhe po përgatitej të largohej, papritur dikush iu hodh nga prapa dhe e vuri poshtë...

Pas këtyre verifikimeve të njëpasnjëshme qen-



dra e zbulimit njoftoi datën, orën, kuadratin dhe sinjalet për të pritur zbarkimin e aeroplanit...

Hajdari dhe gjithë shokët e tjerë filluan punën për të bërë gropat e gjera e të thella për sinjalet me zjarr që do të ndizeshin kur të vinte aeroplani. Punonin me qejf dhe shpejt. Fusha ku aeroplani do të zbarkonte ishte një pllajë e thepisur, që nga lindja binte thikë mbi një përrua. Nga ana tjetër ngrihej mali i veshur me bredha të gjatë e të drejtë, që i jepnin vendit një bukuri të jashtëzakonshme.

Pas asaj pune të lodhshme, nata e dëshiruar erdhi. Dy nga dy zunë vend pranë vendit ku ishin stivosur drutë e thata. Kishin nga një bidon me benzinë për të ndezur zjarrin.

Hajdari dhe Ramadani rrinin të heshtur pranë gropës dhe mbanin vesh mos dëgjonin ndonjë zhurmë aeroplani. Kaloi një orë dhe asgjë nuk po dëgjohej. Yjet lart në qiell shndritnin e i shoqëronin në këtë luftë të heshtur. Kaloi dhe një orë tjetër dhe, megjithatë, asgjë.

— O Hajdar! Ejani se aeroplani nuk vjen, — thirri ndihmës operativi.

— Pt, djajtë! Duket se dyshojnë, — foli Hajdari dhe u ngrit.

Grupi e kaloi ditën i shqetësuar. Qielli u mbulua me re të zeza dhe tutje në horizont herë pas here dukeshin degëzimet e zjarrta të vetëtimave. Siç mësuam nga «Pëllumbi», qendra e zbulimit të Romës njoftonte se, për arësye atmosferike, aeroplani nuk mund të fluturonte. Atëhere «Fioria» iu përgjegj qendrës se ai ishte i detyruar të ndërpriste lidhjen për mungesë baterish.

Përgjegjja nuk vonoi. Qendra e zbulimit njoftoi të prisnin zbarkimin.

Hajdari e Ramadani aty pranë gropave, duke u dridhur nga të ftohtët, dëgjuan si mbyturazi zhurmën e një aeroplani. Hajdari rrëmbeu bidonin me benzinë, zbriti në gropë dhe nisi të spërkaste drutë. Zhurma e aeroplanit u bë më e fortë.

Kur ajo u dëgjua mbi kokat e tyre, vështruan drejt qiellit, por nuk dalluan gjë.

Në çast flaka e zjarrit shkëlqeu andej nga ana ku ishte operativi.

— Ndize! — briti Ramadani.

Sa hodhi Hajdari në dru shkrepjen e ndezur, flaka u ngrit lart.

Aeroplani në qiell fluturonte, ndërsa ata, aty poshtë te gropat, pranë flakëve të zjarrit, ndiqnin zhurmën e tij. Pasi bëri disa rrotullime, aeroplani u largua.

— Duket se nuk hodhi gjë? — tha Ramadani.

— Ndoshta, — iu përgjegj Hajdari, pa e ndarë vështrimin nga qielli.

— Pritën një çast.

— Pashë një dritë të kuqe që u ndez lart, — foli Hajdari duke zënë për krahu shokun.

— Nuk po shoh gjë, — i tha Ramadani, por atë kohë aty pranë tyre u dëgjua zhurmë.

— Ka hedhur! Ka hedhur! — Hajdari u ngrit e shkoi drejt, nga dëgjoi zhurmën.

Edhe Ramadani e ndoqi nga pas, kur ai i thirri:

— Ja tek është parashuta. Ja dhe arka.

Parashuta e bardhë dukej si çarçaf i hapur për-tokë.

— Unë po ngrë arkën, kurse ti mblidh parashutën, — i tha Hajdari shokut të tij dhe, pasi e hodhi atë në kurriz, mori rrugën drejt vendit ku ishte «Pëllumbi».



Aeroplani parashutat me dengjet e arkat e lidhura i kishte lëshuar ashtu kuturu. Ju desh të bridhnin në errësirën e natës, që mëngjezi të mos gjente asnjë shenjë.

U kthyen në bazë të këputur nga lodhja, por të gëzuar, se puna me aq sakrifica po jepte frutet e dëshiruara.

\*  
\*      \*

Komunikimi me qendrën e zbulimit pas zbarkimit u bë i rregullt. Kjo fitore për të gjithë grupin shoqërues krijoi një ndjenjë entuziazmi.

Dy ditë më vonë bënë një mbledhje me «Pëllumbin». Ai u bëri të ditur sulmin e monarkofashistëve kundër vendit tonë. Detyrat e tanishme do të ishin më të rënda...

Të gjithë ishin të një mendimi: të shkonin atje në front, ku po kërciste pushka. Por «Pëllumbi» u tha: «Askush nuk e mohon që ju e doni partinë e vendin dhe jeni gati të sakrifikoni edhe jetën. Por lufta kundër armikut bëhet edhe këtu, po aq e madhe dhe e ashpër, sa edhe në front. Prandaj të keni kujdes, se misioni që iu është besuar është i barabartë sikur të jeni në vijën e frontit, përkrah shoqëve...»

Pas kësaj, zhvillimin e luftimeve ata e ndiqnin me anë të gazetës dhe me sqarimet që iu bënte operativi.

Në fillim të nëntorit koha u keqësua. Të ftohët dhe shiu nisën radhë dhe hera-herës me shtrëngata, që ua vështirësonte shërbimin. Në të shumtën e rasteve, nga koha e keqe lidhjet me qendrën e

zbulimit ndërpriteshin. Të gjithë mendjen e kishin mbledhur se puna aty do të vazhdonte gjatë. Por, papritur, u dha urdhëri të përgatiteshin për të zbritur në qytet. Aty Hajdari dhe të njëmbëdhjetë shokët e tij u njoftuan se do të bënin pjesë në efektivin e brigadës së Sigurimit të Shtetit, që ishte krijuar.

\*                      \*

Hajdarin e caktuan skuadërkomandant të skuadrës së parë të togës së tretë. Komandant toge ishte një mesoburrë, fytyrë ezmer, që nuk i kalonte të tridhjetë e pesë vjetët. Ishte nga fshatrat e Skraparit dhe i vjetër në repartet e ndjekjes.

Stërvitja e filluar kishte një program të ngjeshur, sa në mbrëmje, kur shkonin në kazermë shtriheshin në krevate dhe në çast i kapiste gjumi.

Me t'u plotësuar efektivi i Batalionit 75, në bazë të organikës, u bënë mbledhjet e përgjithshme të komunistëve të çdo kompanie, për të zgjedhur byronë dhe sekretarin e organizatës.

I deleguar për zgjedhjet në kompani ishte komisar i batalionit. Komisar i kompanisë hapi mbledhjen.

Përpara se të fillonin nga puna, komisar i batalionit foli për rëndësinë e zgjedhjeve, rolin e organizatës në kompani dhe, së fundi, u kujtoi rregullat për procedimin e zgjedhjeve në bazë të statutit.

I pari, për në listën e byrosë, u propozua komisar i kompanisë, nga një shok që e njihnte atë gjatë luftës e në ndjekje. Pas diskutimeve ai u aprovua që të vihej në listën e byrosë.



Propozimin për kandidatin e dytë e bëri komisar i kompanisë.

— Propozoj për në byro shokun Hajdar Tafa, — tha ai dhe u kollit. Pastaj vështroi shokët dhe nisi të fliste për meritat e tij në repartet e ndjekjes. Andej nga fundi ai ngriti zërin.

— Duhet të keni parasysh se Hajdari me disa shokë të tjerë, kanë qenë të ngarkuar me një mision të posaçëm e shumë delikat. Atje ai është treguar i vendosur e i palodhur. Nga sa na kanë rekomanduar shokët përgjegjës që drejtonin veprimet, Hajdari është luftëtar i vendosur për çështjen e partisë, i kujdesshëm dhe vigjilent në zbatimin e detyrave.

Pas komisarit u ngrit Ramadani:

— Hajdarin unë e njoha gjatë misionit që kishim. Ato që tha komisar i janë të vërteta. Jam i bindur se, po të zgjidhet në byro, organizata do të ketë një shok aktiv për të zbatuar vijën e partisë.

Diskutuan dhe katër shokë të tjerë. Komisar i batalionit vështronte Hajdarin e buzëqeshte. Me vota unanime ai u aprovua që të vihej në listën e kandidatëve për në byro.

Kur u plotësua lista e kandidatëve, u bënë votimet. Komisar i batalionit tha:

— Shokët e zgjedhur të byrosë të vijjnë jashtë, — dhe doli i pari së bashku me komisarin e kompanisë.

Gjysmë ore më vonë në derë u dhanë komisar i kompanisë, i deleguari, Hajdari, i skuqur në fytyrë, e shokët e tjerë.

Kur në dhomë u bë qetësi e madhe, Hajdari, që rrinte në mes të shokëve të zgjedhur, u ngrit e nisi të fliste.

— Byroja në mbledhjen e saj të parë, më ngarkoi me detyrën e sekretarit.

— Urime, urime, — i thanë shokët njëzëri, duke duartrokatur, ndërsa ai vazhdoi:

— Detyra është e madhe dhe e rëndë, por unë do të vë të gjitha forcat dhe jam i bindur se, me ndihmën tuaj, do t'ia arrijmë qëllimit.

Shokët dëgjonin në heshtje fjalët e thjeshta të Hajdarit. Në këto fjalë ata ndjenin një betim të vërtetë.

\* \* \*

Dimri në Tiranë atë vit kishte hyrë shpejt dhe, megjithëse shirat qenë të rralla, koha ishte ftohur mjaft. Në rrugicat e ngushta shtëpitë njëkatëshe dukeshin të strukura pranë njëra-tjetrës. Po afronte viti i ri dhe njerëzit qenë vënë në lëvizje.

Më 29 dhjetor filloi një borë e hollë. Ishte me të vërtetë një bukuri për qytetin.

Batalioni 75, ku bënte pjesë Hajdari, mori urdhër të përgatitej. Më 30 dhjetor, në drekë, reparti hipi në kamion.

Natën vonë batalioni mbërriti në Mamurras. Të nesërmen në mëngjes, sipas vendimit të byrosë, Hajdari lajmëroi për mbledhjen e organizatës. Në rend të ditës kishin për të diskutuar masat që duhej të merrnin komunistët për të zbatuar me sukses planin e veprimit.

Kur komunistët u grumbulluan, Hajdari zuri vend në tavolinë. Ashtu i qetë ai u ngrit, shfletoi bllokun, vështoi shënimet e nisi të fliste.



— **Shokë**, në zonën e Krujës, të Lezhës, të Mirditës e në vende të tjera janë duke qarkulluar disa banda diversantësh të pregatitura nga zbulimet imperialiste amerikane, angleze, italiane në bashkëpunim me blokun independent. Një pjesë e këtyre bandave janë hedhur nga ajri me parashutë, ndërsa një pjesë tjetër janë futur fshehurazi nëpërmjet kufirit tokësor... Tashmë të gjithë janë në dijeni se qëllimi i tyre është që, në bashkëpunim me armiqtë e brendshëm, të pregatisin kryengritjen e armatosur për të rrëzuar pushtetin...

Kompanisë sonë i është vënë detyrë që të veprojë në zonat Laç, Mali i Bardhë, Skuraj, Gallatë e Gjorm. Të mbështetur në të dhënat e Degëve të Punëve të Brendshme, ne do të kontrollojmë në male e pyje, që bandat e diversantëve t'i vëmë në lëvizje. Përvoja neve nuk na mungon, se, gati të gjithë, kush më shumë kush më pak, i dimë këto gjëra, se kemi shërbyer në repartet e ndjekjes ose në kufi. Përveç informacionit e bashkëpunimit me popullin, që në punën tonë zënë vendin kryesor, gjatë kërkimeve duhet të shfrytëzohen gjurmët në tokë, në borë. Sidomos të shihen me vëmendjen më të madhe zjarret e shuara, plaçkat e lëna, si bishta cigaresh, kuti konservash, etj., gurët e lëvizur në vëndet e pjerrëta, ku mund t'ua marrë mendja se banda ka kaluar...

Komunistët bënë diskutime të gjalla dhe vendosën që ata të ishin të parët e shembëll në veprime. Pasdite kompania nisi rrugën varg deri në një farë vendi, pastaj u nda. Toga ku ishte Hajdari u drejtua për nga Mali i Bardhë, që ishte mbuluar krejt me borë.

Hajdari, i shtrirë në pritë në mes të borës, me automatikun nën kapotë që ta mbronte nga lagështia, rrinte i heshtur. Hëna me dritën e saj të zbehtë zbardhte vendin. Hajdari vështronte drurët e lartë të pyllit, të ngarkuara me borë. Papritmas i shkoi ndër mend se në atë çast përreth pemëve të vitit të ri, ngriheshin dollitë e rrëkëlleheshin gotat duke uruar. Një copë borë u shkëput nga pema e iu fut nën jakën e kapotës. Ndjeu në qafë ftohtësinë e saj, që i ndërpreu fillin e mendimit. «Duket se më kujtoi që po hyn viti i ri», tha Hajdari me vete dhe vështroi nga tre shokët që rrinin të shtrirë e fërkonin duart nga të ftohtët. Donte t'u thoshte: «Gëzuar vitin e ri», por u përmbajt se ishte në pritje.

«Tak, tak», u dëgjuan të trokiturat e dy gurëve në krahun e djathtë nga ana e shkëmbit ku kishte zënë pritë një njësit i skuadrës së dytë. Hajdari i dha kundërparullën me tri të trokitura guri. Pas pak ata panë një hije që po lëvizte drejt tyre.

— Kujdes, se është yni, — i tha Hajdari, shokëve të njësitit.

Hija po afrohej. E njohu. Ishte Thanasi, komandanti i kompanisë.

— E, si e ndjen veten? — pyeti ai Hajdarin me zë të ulët.

— Mirë, po është ca ftohtë, — u përgjegj Hajdari.

— Kur do t'i kontrollosh tre njësitet e skuadrës së tretë?

— Sa të kalojë mesi i natës, — tha Hajdari.

— Mirë, ...dhe gëzuar Vitin e ri, shokë! — u tha



komandanti të gjithëve dhe u largua nga kishte ardhur.

Qëndruan gjithë natën në pritë pa asnjë rezultat. Pas disa ditësh, nga të dhënat e organeve të sigurimit, ata mësuan se diversantët, natën e Vitit të ri, kur forcat ndodheshin në prita, ishin strehuar në një shtëpi të fshatit Skuraj.

Kështu kaluan shumë ditë. Bora e të ftohtët nuk po u ndahej për asnjë çast dhe qëndrimi në pritë po u bëhej përherë më i vështirë. Me kërkime, kompania kishte hyrë në zonën e Mirditës. Një ditë, sipas të dhënave të organeve të sigurimit, toga zuri pritë në pyjet e Prosekut. Në mëngjez herët, në krahun e sipërm, ku ishte vendosur një njësit i skuadrës së Hajdarit, u dëgjua zhurmë këmbësh që vraponin. Nuk vonoi dhe ata panë banditët që vinin drejt tyre.

— Zjarr, — briti Hajdari dhe zëri i tij humbi në krismat që ushtuan.

Banditët kërkuan dy herë të çanin përpara, po zjarri i dendur i bëri të tërhiqeshin dhe të mbeteshin brenda rrethimit, tamam në atë kohë kur nisi të agonte mirë dhe mjegulla po hiqte perden e saj. Komandanti urdhëroi që njerëzit të lëviznin për të shtrënguar edhe më tepër darën e rrethimit. Banda përbëhej prej pesë kriminelësh. Banditët e kuptuan rrezikun dhe u lëshuan tatëpjetë për nga ana e lumit, që ishte fryrë nga shirat dhe nga shkrirja e borës.

Atëhere komandanti i bëri shenjë Hajdarit, që, me njësitin e tij, të zinte shtegun nga krahu i poshtëm, buzë lumit, për të mbyllur kështu kalimin.

Ata shkuan shpejt. Pritën aty, po banditët nuk u dukën.

Të pesë kriminelët, duke e parë keq punën, për të shpëtuar, u hodhën në lumin e rrëmbyeshëm.

— Më jep belxhikun, — i tha Hajdari shokut të vet. — Atë kohë u dëgjuan krismat e mitralozit. Dy kriminelë humbën në thellësinë e lumit të turbullt dhe nuk u dukën më, ndërsa tre të tjerët gati po dilnin në anën tjetër të lumit, kur mitralozi nisi përsëri të qëllonte. Edhe dy kriminelë mbetën pa lëvizur. Vetëm njëri bandit mundi të shpëtonte, por edhe ai nuk mbeti gjallë. Pas 10 ditësh ranë në gjurmët e tij dhe e rrethuan në një kasolle. I bënë thirrje të dorëzohej, por ai u mundua të çante rrethimin dhe gjeti vdekjen, sa u ngrit nga vendi ku ishte fshehur.

Muajt po ia linin vendin njëri-tjetrit, ndërsa repartet vazhdonin ndjekjet. Në të hyrë të verës komanda e batalionit urdhëroi që kompanitë të pregatiteshin për veprim.

Ditën që komanda e kompanisë nxori urdhërin për veprim, binte shi i fortë. Në qiellin e ngarkuar me re të dendura, bubullimat gjëmonin me të madhe. Komandanti së bashku me komisarin mblodhën togëkomandantët dhe i vunë në dijeni se, sipas të dhënave, në Ujë-Lurth, te sheshi i Shqarshit, grupet e diversantëve prisnin të vinte afër mesnatës një aeroplan për të zbarkuar diversantë të tjerë dhe materiale të ndryshme. Madje, për të qenë më të sigurt, ata e kishin organizuar këtë zbarkim në kohë të keqe.

Pa humbur kohë, Hajdari mblodhi komunistët dhe shtroi detyrat që u dilnin atyre që aksioni të përfundonte me sukses. Pasdite vonë ata hipën në kamiona dhe u nisën. Te ura e Fanit zbritën dhe u nisën në varg buzë lumit, duke lënë xhadenë prapa.

Era e ftohtë që frynte me rrëmbim nga gryka e lumit ua thante fytyrat e duart. Opingat prej llastiku,



që filluan të mbusheshin plot me ujë, ua vështirësonin ecjen. Ecnin në rrugë e pa rrugë, duke u kapur pas njëri-tjetrit që të mos humbisnin drejtimin nga errësira e madhe.

Kreu i kolonës njoftoi të shpejtonin. E përpjeta po ua merrte shpirtin. Ngjiteshin me të gulçuar. Ishin ende larg vendit, kur shiu pushoi. Pas pak kohe dëgjuan zhurmë lart në qiell.

— Shpejtoni se aeroplani, — njoftoi kreu i kolonës.

— Mirëpo ata kishin akoma rrugë për të bërë, derisa të shkonin e të zinin shtigjet për të bërë rrethimin.

Hajdari qëndroi në vend.

— Shpejt! Shpejt! — u thoshte ai shokëve që i kalonin si hije në varg.

Me mundim të madh mbërritën në vendet e caktuara. Aeroplani kishte një kohë të gjatë që kishte kaluar.

Rrinin në prita duke u dredhur nga të ftohtët se shiu i kishte lagur deri në palcë.

— Të ketë zbarkuar aeroplani? — pyeti Bajrami, komandanti i skuadrës së dytë.

— Në të aguar do të merret vesh kjo punë, po ki kujdes nga krahu i majtë, — iu përgjegj Mediu.

Një orë përpara se të agonte u dëgjua një zhurmë në thellësi të pyllit. Njësitet u njoftuan të rrinin në gatishmëri.

Pritën pa lëvizur, por asgjë nuk po dukej.

— Do të ketë qenë ndonjë kafshë a shpend, — tha një nga ushtarët.

— Nuk i dihet, — i tha prerë Hajdari.

Kur nisi të zbardhte dita, vendi u duk qartë.

— Paska zgjedhur vend të sigurt, — tha Bajrami, që shkelle për herë të parë në ato anë.

— Të futesh më thellë është më keq, sa me zor ta shohësh.

— Sa më thellë të futesh, aq më keq është, vështirë se do ta shohësh njerinë edhe dhjetë metra larg, — iu përgjegj një ushtar.

Komandanti i kompanisë zbriti nga lart dhe thirri Hajdarin e Bajramin.

— Mblidhni skuadrat. Do të futemi në pyll për kërkime, por me kujdes.

— Krahun e majtë do ta marr unë, kurse Bajrami të shkojë nga e djathta, ku pylli është më irrallë, se ai këtë vend e njeh pak. — Pastaj iu drejtua Bajramit: — Do të takohemi lart te tri pishat e djegura.

— Mirë. Nisuni! — urdhëroi komandanti.

Skuadra hyri në pyll për kërkim me automatikët gati. Dy shokët që kishin lënë prapa kishin qëndruar dhe ndiqnin me vështrim Hajdarin e shokët e tjerë, të gatshëm t'i mbulonin me zjarr po që se binin në përpjekje.

Jo shumë larg vendit ku kishin zënë pritë, lart mbi një pishë, panë parashutën dhe dengun që varej poshtë saj.

— Shko njofto Bajramin të këtë kujdes se aeroplani ka zbarkuar, pastaj njofto komandantin e togës që të dërgojë ushtarë për t'i marrë, — urdhëroi Hajdari një ushtar.

Po ecnin duke kërkuar. Sapo i afroreshin vendit ku kishin lënë pikën e takimit me skuadrën tjetër, nga ana e përtejme e pyllit plasën krismat e armëve dhe të granatave.



— Kini kujdes nga krahu i djathtë, — u tha Hajdari shokëve.

Më tutje, duke kërkuar, gjetën edhe një parashutë tjetër, por pa deng.

— Diversanti duhet të jetë futur diku, — tha Hajdari dhe bëri përpara.

— Ndërkohë, andej krismat e armëve nisën të rralloheshin.

Në pikën e takimit skuadrat mbërritën në një kohë. Hajdari vendosi aty një pritë për çdo të papritur dhe vazhduan kërkimin. Aty afër drekës u dha sinjali që forcat të grumbulloheshin. Kur shkuan në vend, panë parashutat e dengjet që kishte zbarkuar aeroplani. Mësuan se forcat kishin vrarë dy diversantë.

Komandanti i batalionit u tregoi se, midis diversantëve që kishin organizuar këtë zbarkim, ndodhej dhe Alush Leshanaku, i dërguar si emisar i zbulimit italian.

\*

\* \*

Kur u kthye në repart, Hajdari mbeti i çuditur. Pothuajse të gjithë shokët kishin mësuar që ai kishte bërë fejesë e martesë në një kohë dhe nisën ta uronin.

— Na i ke bërë me hile, — i tha Bajrami dhe e goditi me dorë në krahë.

— Ndodhi ashtu papritur, — dhe Hajdari nisi t'u tregonte si kishte ngjarë.

— Rëndësi ka se u martove, megjithëse duhej të na kishe lajmëruar, se dhe ne shokët e tu, helbe-

te, nuk do të rrinim duarlidhur. Në mos shumë, një telegram do ta bënim, apo jo? — shtoi Bajrami duke iu drejtuar shokëve.

— Të trashëgohesh, o Hajdar. Megjithatë ne nuk do ta lëmë pa e lagur, — u hodhën ushtarët njëzëri.

Sakaq mbi ledh u duk komandanti i kompanisë dhe komisari.

— Rrini, mos luani, se e paskeni zënë mirë këtë hije. Si është puna që po qeshni? — tha komandanti.

— E vendosëm, — iu përgjegj Bajrami.

— Çfarë?

— Ja, do ta shtrojmë me rastin e martesës së Hajdarit.

— Pa shih! Pa shih! Shumë bukur! Veç në këtë mes duhet të na futni dhe ne, — tha komandanti dhe vështroi komisarin, i cili e miratoi duke tundur kokën, me buzëqeshje.

Ata u ulën në hije së bashku me ushtarët e nisën të bisedonin. Pas pak korieri i pruri komisarit një letër. Ai hapi zarfin e nisi të lexonte. Komisari i batalionit e njoftonte se së shpejti do të mblidhej aktivi i partisë së batalionit për të analizuar punën e kryer dhe detyrat që u dilnin organizatave dhe efektivit për të ardhmen. Për këtë ai duhej të njoftonte sekretarin e organizatës për të bërë mbledhjen e byrosë, ku do të caktoheshin anëtarët e partisë që do të merrnin pjesë në aktiv.

Të gjithë vështronin komisarin, po ai iu drejtua Bajramit:

— Me pregatitjen e gostisë kush do të ngarkohet?



— Për këtë mos ki merak, se do ta rregullojmë vetë, — iu përgjegj Bajrami.

Hajdarit nuk iu durua.

— Me gjithë mend e paskeni? Po më duket e tepërt, — u tha ai dhe fytyra i mori të skuqur.

— Kjo është puna jonë. Dhëndrrin duhet ta gëzojmë. Pa le të kishim edhe nusen. Gostia do të ishte edhe më e mirë, — shtoi komisari.

Pastaj komandanti iu drejtua komisarit dhe Hajdarit:

— Shkojmë të bisedojmë për mbledhjen që lajmëron komisari i batalionit.

Ata u ngritën. U larguan të tre dhe morën drejtim për nga komanda.

Në të perënduar të diellit, Hajdari bëri mbledhjen e byrosë së organizatës, për të caktuar shokët që do të merrnin pjesë në mbledhjen e aktivitetit.

Si mbaruan punë, ai shkoi në fjetore. Postëroja kishte shuar dritat. Vetëm një llampë elektrike ndriçonte dobët. U zhvesh pa bërë zhurmë dhe u shtri në krevat. Sa mbylli sytë, mendja i fluturoi larg te shtëpia. Kujtoi dasmën, Filen që nusëronte, darkën, dollinë që ngriti i ati. Pastaj nënën kur e përqafoi dhe kur tha: «Të më trashëgohesh, biri im!»



Në Shënpal, ku kishte qendrën batalioni, u bë mbledhja e aktivitetit të partisë. Hajdari rrinte pranë Ramadanit.

Komisari i batalionit nisi të fliste. Të gjithë dëgjonin me vëmendje.

Nga mesi i raportit komisari e ngriti zërin më tepër: «Zbulimet e huaja imperialiste, në bashkëpunim me revizionistët e kanë ngritur banditizmin politik në art taktik, për të realizuar strategjinë e tyre. Në shumë shtete, ku nuk ka pasur një parti të shëndoshë komuniste dhe pushteti nuk ka pasur lidhje të ngushta me popullin, taktika e banditizmit politik u ka dhënë atyre rezultate të dëshiruara dhe ata kanë vendosur në pushtet elementë reaksionarë, që ndjekin qorrazi politikën e imperialistëve.

Ne, duke e njohur rrezikshmërinë e imperializmit e të revizionizmit, e vlerësuam banditizmin politik ashtu siç na mëson partia. Prandaj dhe patëm suksese. Dëshmia më e gjallë e vendosmërisë së efektivitetit dhe e popullit për të mbrojtur fitoret e revolucionit dhe të pushtetit tonë popullor nga diversioni i huaj e i brendshëm, janë bandat e diversantëve që kemi shfarosur, si ajo e Prenk Dod Gjinkëqit, e përbërë prej shtatë vetësh, e Nikoll Jakut e përbërë prej 3 vetësh, e Pjetër Gallatës, e përbërë prej katër vetësh, e Gjon Prenk Jakut, e përbërë prej tre vetësh, e Gjon Dod Perbunës e përbërë prej tre vetësh...»

Duke përfunduar, komisari iu drejtua shokëve të aktivitetit: «Tani që kemi hyrë në periudhën e verës e gjethja në bjeshkë ka nisur të rritet, diversantët shpresojnë ta kenë më të lehtë, por veprimet tona do të dendësohen në mënyrë që, edhe nëqoftëse një ose dy banda mund t'i shpëtojnë asgjësimit, bazat e tyre për dimër të bëhen të vështira...»

Pas disa diskutimesh u ngrit Thanasi, komandanti i kompanisë. Ai hapi fletoren, bëri një të kollitur të thatë që i mundonte vazhdimisht gjoksin dhe foli për sukseset e arritura, për të metat që



qenë dukur gjatë ndjekjes dhe masat që organizata e partisë e komanda kishin marrë për mënjanimin e tyre. Pastaj tha: «Këtu ne po bëjmë analizën e punës sonë, po kritikojmë të metat, por më e rëndësishmja është se ne po këmbëjmë përvojën për t'i luftuar këto të meta më mirë, më shpejt, në mënyrë që ndjekja kundër bandave të diversantëve të ketë rezultatet që pret partia... Ne e dimë se diversantët vijnë të përgatitur nga zbulimet e huaja, u kemi njohur atyre taktikën, me ata kemi provuar armët në përpjekje dhe i kemi parë edhe të vranë. Megjithatë, prapë themi se duhet të mësojmë më shumë nga taktika e armikut. Këtu midis nesh kemi shokë si Hajdarin, Ramadanin e të tjerë që i kanë mbi-këqyrur diversantët me muaj të tërë, ditë e natë, në kushte të vështira. Siç e dinë edhe këta, diversantët janë të përgatitur shumë mirë në qitje me armë të gjata e të shkurtëra dhe janë në gjendje të qëllojnë nga çdo pozicion. Duke mësuar këto gjëra, unë kërkoh që efektiv, në stërvitjen e zjarrit, të përvetësojë qitjen dhe, njëkohësisht, të dijë të mbrohet. Kësaj detyre ne themi se ia kemi arritur, se gjatë përpjekjeve nuk kemi pasur dëmtime të rënda, as plagosje, qofshin ato të lehta. Megjithatë në të ardhmen rëndësi më të madhe do t'i japim stërvitjes së zjarrit, që pushka e ushtarit të godasë pa gabim mbi diversantët...»

Pas shumë diskutimesh, në fund, komisari përcaktoi detyrat e hollësishme për periudhën e ardhshme.

Gjatë periudhës së verës e të vjeshtës ndjekjet e bandave të diversantëve u bënë aq të pandërprera e me lëvizje të shpeshta, sa të bandat u krijua mendimi se numri i forcave të ndjekjes ishte shumë i madh. Prandaj si rrugë të vetme shpëtimi ata zgjodhën taktikën të lëviznin pak nga një zonë në tjetrën për të humbur gjurmët. Kjo taktikë e imponuar nga forcat e ndjekjes, i çoi bandat në disfatë të tyre dhe të bazave që i strehonin e i ushqenin.

Më 19 nëntor komanda e batalionit thirri në mbledhje komandën e kompanisë, togëkomandantët, si dhe Hajdarin, sekretarin e organizatës dhe u njoftoi se me urdhër të komandës së brigadës Nr. 38, tepër sekret, forcat do të niseshin për në zonën e Fanit, me mision për t'u vënë në ndjekje të bandës së diversantëve që udhëhiqej nga Gjon Marka Ndoi (Gjini).

Më 22 nëntor kompania nisi rrugën drejt Fanit. Vendin e kishte mbuluar bora dhe, sipas të thënave të banorëve, dimri këtë vit do të ishte i fortë, me ngrica e të ftohtë të madh.

Sa më tepër futeshin forcat në thellësi, aq më e madhe ishte dhe bora.

Në mbrëmje hynë në zonat e Fanit. Komisari me togëkomandantët dhe Hajdarin e takuan me punëtorin operativ të zonës së Fanit. Zunë vend në një kasolle gjysmë të rrëzuar, të lënë nga barinj të gjatë verës. Ndezën shpejt zjarr të madh me dru, që aty pranë kishte pa hesap.



Punëtori operativ, një burrë me trup mesatar e i shëndetshëm, që ulur këmbëkryq pranë komisarit dhe fliste për veprimet që ishin parashikuar në planin e përgjithshëm dhe për rrugët e mundshme të një kontrolli të rreptë gjatë kërkim-zbulimit.

Të gjithë e dinin rrezikshmërinë e bandës së diversantëve, që ata po ndiqnin, por aty ata mësuan shumë hollësi, se Gjon Marka Ndoi, të cilit zbulimi italian i kishte besuar drejtimin e bandës, kishte qenë roja i bindur i «Princit të Mirditës» që kur ishte në moshën e re. Pasi i shërbeu për vite të tëra derës së Gjon Marka Gjoni, ai kishte filluar karrierën e xhandarit, pastaj që bërë mercenar i fashizmit. Si qen i «princit» dhe i padronëve pushtues, ai kishte bërë krime nga më të tmerrshmet. Kur forcat partizane kishin çliruar vendin, për t'i shpëtuar dënimit të popullit, ai ishte arratisur jashtë shtetit.

Organet e sigurimit ishin vënë në dijeni se më 24 dhjetor të vitit të kaluar Gjon Marka Ndoi, së bashku me tetë diversantë ishin hedhur me parashutë në livadhet e Stroit të zonës së Fanit. Nga të dhënat e sigurta, dilte se banda, në bazë të rekomandimeve të zbulimit të huaj dhe të «princit Gjon Marka Gjoni», kishte marrë kontakt me mbeturinat e organizatës «Besëlidhja», që ishte krijuar nga gjermanët në tetor të vitit 1944 për t'u vënë barrikatë sulmeve të forcave partizane për çlirimin e zonave të Veriut, si dhe u ishte drejtuar shumë njerëzve me letra, që të ishin të gatshëm të bashkëpunonin, se së shpejti pushteti i komunistëve do të përmbysej.

Banda për një kohë kishte bërë çmos që të humbiste gjurmët. Ajo kishte pasë dimëruar në pyjet

e Larit dhe qe strehuar në një tunel të bërë nën breth të ngarkuar me borë të madhe, që u shërbente si filtrim për të zhdukur ngjyrën e tymit.

Organet e sigurimit, nëpërmjet «Ahut» dhe rrugëve të tjera, zbuluan se Gjoni me bandën e tij kishin organizuar dhe vrarë Ndrec Preng Lokën, sekretarin e organizatës bazë të partisë të Domgjonit dhe, më vonë, Ndue Preng Lokën e ishin larguar nga zona e Fanit në drejtim të Mirditës.

Pas shumë gjurmimeve të heshtura më së fundi organet e sigurimit, nga mesi i muajit shtator, me anën e «Ahut» ndiqnin me vëmendje lëvizjet e bandës në pyjet e Komit, Larit, Lugjeve të Këqinj, Melth e në të tjera.

Disa javë më vonë organet e sigurimit morën nga «Ahu» njoftimin: «Gjoni është shumë i rafinuar. Ndërlidhjen e bën gjithmonë nëpërmjet «Mikut»... Nga sa mësova prej «Mikut», me Gjonin do të takohen këto ditë. Duket se diçka i shqetëson, por...»

Ndërkohë «Guri» kishte njoftuar: «...Mbrëmë në mesnatë Gjoni erdhi... Më kërkoi ushqime me shumicë. U premtova se do t'ua gjej pas disa ditësh. Më dhanë të holla, veç ato t'ua siguroja doemos».

Nga java e parë e muajit nëntor «Ahu» njoftoi: «...Pas shumë përpjekjesh, më së fundi «Mikut» ia shkëputa të fshehtë. Çeku është i besuari dhe informatori i bandës. Jam duke e vëzhguar hap pas hapi...»

Organet e sigurimit nëpërmjet kanaleve të tjera bënë verifikime të shumta. U pa qartë se Çeku ishte i vetmi person me anën e të cilit do të hidhej në dorë banda ose do të asgjësohej ajo në një kohë sa më të shpejtë.



Në kohën që ata bisedonin rreth zjarrit për bandën, nga jashtë u dëgjua zhurmë.

— Komisari a është aty? — pyeti dikush rojen.

— Po.

Te praku i kasolles ata panë Ramadanin.

— Zeqirin e kemi të sëmure, — i tha ai komisarit me shqetësim.

— Nga se?

— Nuk di, shoku komisar. Është mbytur në djer-së dhe të nxehtët po e përvëlon.

— Infermieri ç'tha?

— Kemi dërguar ta thërrasim.

— Hajde të shkojmë, — tha komisari dhe u ngrit.

— Po vij dhe unë, — dhe Hajdari shkoi pas tij.



Era jashtë frynte me fishkëllimë e shoqëruar nga një borë e dendur. Ishte koha që forcat do të nisnin kërkimet. Hajdari ngrohu duart në zjarrin që vazhdonte të digjte kërcunjtë e trashë, veshi dorezat dhe doli jashtë. Këmbët iu futën thellë në borë. «Në këtë kohë vetëm gjuetarët e ujqëve qëndrojnë jashtë», mermëriti ai me vete dhe u bashkua me shokët e togës.

Mes atij tufani forcat e togave, të shpërndara në skuadra, çanin borën. Kontrollonin me kujdes, të gatshëm e me masa mbrojtëse çdo rrënjë bredhi dhe ahu, se nga përvoja e dinin që diversantët shpesh ndërronin edhe dy a tri baza brenda njëzet e katër orëve nga që i brente dyshimi e frika.

Dolën lart në majë të malit, ku tufani po u merrte frymën dhe era e ftohtë sikur ua qëllonte fytyrën me kamzhik. Nisën të zbrisnin me të rrëshqitur në anën tjetër të faqes së malit dhe filluan përsëri kërkimin.

Hajdari ecte në krye të njësitit. Sa iu afrua pyllit me bredha, ai u bëri shenjë shokëve të ishin të gatshëm.

Në drekë toga u grumbullua nën degët e bredhave të mëdhenj. Megjithëse ishin të lodhur e të raskapitur, asnjë ushtar nuk e bënte veten. Qëllimi i tyre ishte një, të asgjësonin banditizmin politik në emër të mbrojtjes së revolucionit e të socializmit.

Komandanti i togës, që ishte mbështetur pas trungut të një bredhi, lëvizi me dorë një degë dhe vështroi lart qiellin.

— Do të kemi përsëri borë, — u tha ai shokëve.

— Do ta pranoja me qejf, por këtë tufan jo, se na e mori shpirtin, — shtoi një ushtar që rrinte ulur përballë tij.

Kështu nisi biseda. Hajdari shihte fytyrat e shokëve që dukeshin të përhirta nga refleksi i borës dhe nga të ftohtët si dhe buzët e tyre që kishin marrë ngjyrë si në blu. Atëhere ai u kujtoi shokëve se çdo ushtar duhej të përballonte me guxim vështirësitë.

— Të gjithë ne që përbëjmë efektivin e brigadës, këtë vështirësi e kemi kaluar në luftën partizane, në ndjekje e në kufi. Apo jo?

— Mirë thotë Hajdari, ashtu është. Diversantët që janë të paguar nga zbulimet e huaja, pa asnjë që-



llim në jetë e pa mbështetje të sigurt për të fshehur kokën, po rezistojnë ditë e natë me frikë, kurse ne që jemi në fuqi dhe i kemi vënë vetes misionin e lartë, jemi njëmijë herë më të fortë, — tha Hysniu, një nga ushtarët që ishte paraqitur nga të parët në efektivin e brigadës.

Pas pushimit vazhduan përsëri kërkimet. Ushhtarët çanin borën më shpejt. Kontrollin e bënin më të imtë dhe asnjë nuk mbeti prapa.

Kur errësira mbuloi vendin, toga u strehua në disa kasolle dhe ndezi zjarr për t'u ngrohur. Komisari i kompanisë njoftoi togëkomandantët se ushqimi do të vonohej mbasi nga pika e furnizimit ndodheshin larg. Për këtë ai urdhëronte që të viheshin në dijeni ushtarët. Togëkomandanti me Hajdarin shkuan në kasollen ku kishte zënë vend skuadra e dytë. U thanë ushtarëve se ushqimi do të vonohej, por Andrea, një ushtar që kishte shërbyer për një kohë të gjatë në ndjekje dhe që i dinte mirë vështirësitë e transportit, iu drejtua shokëve:

— Qameti nuk do të bëhet se do ta kalojmë natën me barkun bosh. Nesër dita është jona e do të hamë ca më shumë, — dhe zuri t'u tregonte një episod nga ato të viteve të para të ndjekjes.

Ata shkuan edhe në dy skuadrat e tjera, por nga ushtarët morën të njëjtën përgjegje.

Ushhtarët ishin strukur pas njëri-tjetrit e flinin. Gërhimat e tyre të lehta përziheshin me ulërimën e ujqve e të tufanit që sa kishte filluar. Hajdari, pas mesnate u zgjua nga të ftohtët. Zjarri ishte gati në të shuar. U ngrit, mori një krah dru andej nga fundi dhe i hodhi në zjarr. Ato pas pak u ndezën dhe flaka nisi të ndriçonte.

Ai, i heshtur, shikonte fytyrat e shokëve. Nuk

po i dukeshin ashtu të përhirta. Sytë i vajtën te togëkomandanti. Ai ishte zgjuar dhe po vështronte flakën mendueshëm.

— Fli, fli! Ka dhe tri orë natë, — i tha me zë të ulët.

— Ku të lënë ulërimat e atyre djajve, — tha ai dhe u afrua pranë zjarrit, ku kaluan orët e natës duke biseduar.

Për nëntë ditë u endën nëpër malet e pyjet e dëndura e të ngarkuara me borë. Më datën 1 dhjetor, mes atij tufani, që askush nuk besonte të lëvizte këmbë njeriu, forcat e kompanisë hynë në fshatin Sangë. Ishin të lodhur e të rraskapitur.

Kur ushtarët u ndanë në shtëpitë e para të fshatit, erdhi zëvendëskryetari i Degës së brendshme dhe zëvendëskomandanti i postës së policisë të Fanit. Ata shkuan në shtëpinë ku ishte komisarri dhe disa shokë të tjerë. Nën dritën e kandilit fytyrat e tyre dukeshin se qenë të lodhura.

— A mbërritët mirë të gjithë? — e pyeti zëvendëskryetari komisarin.

— Patëm një ushtar të sëmurë, por tani është shëndoshë e mirë.

Zëvendëskryetari me komisarin u tërhoqën mënjandë, ndërsa punëtori operativ nisi t'i tregonte zëvendëskomandantit të postës për vështirësitë e rrugës.

— E ne këtej nuk e patëm të lehtë. Çeku na ka lodhur tepër.

— Ka shkuar andej?

— Dy takime ka bërë.

— Pastaj?

— Si e di vetë. Rri me veshët ngritur se mos dëgjon gjë, që t'ua shpjerë atyre të freskët.



— Po sikur të ikë? — pyeti një nga togëkoman-  
dantat i shqetësuar.

— S'ka ku të shkojë. Është nën kontroll ditë e na-  
të. Pastaj ai është syri e veshi i bandës, — shtoi  
Zëvendëskomandanti i postës, i bindur për ato që  
thoshte.

Hajdari dëgjonte me vëmendje, kur Zëvendës-  
komandanti i postës filloi të tregonte për bukuri si  
shkonte në takim, si sinjalizonte bandën për reziqet  
që u kanoseshin e të tjera.

Zëvendëskryetari me komisarin u kthyen. Pa e  
zgjatur, zëvendëskryetari u bëri të ditur se, me  
veprimet që kishte kryer kompania gjatë këtyre di-  
tëve sipas planit të parashikuar, u arritën rezultatet  
që dëshiroheshin. Te informatorët dhe bazat e ban-  
dës u krijua përshtypja se forcat janë duke i kër-  
kuar diversantët shumë larg nga vendi ku ndodhe-  
shin. Pastaj ai shtoi:

— Forcat e kompanisë me një orë natë duhet të  
kenë rrethuar lagjen Dardhë e Larë të fshatit Xhuxhë  
dhe të kenë zënë shtigjet që të çojnë në pyllin e  
Larit. Punëtori operativ do të shoqërojë togën që do  
të rrethojë lagjen Dardhë, ndërsa Zëvendëskomand-  
anti i postës atë që do të rrethojë pyllin e Larit.  
Kontrolli do të bëhet vetëm në ato shtëpi që kemi  
caktuar dhe ku, siç jemi në dijeni, janë bazat e ban-  
dës. Gjatë kontrollit zëvendëskomandanti i postës  
të vëzhgojë me kujdes Çekun dhe ta arrestojë atë,  
vetëm kur ai të ketë mbërritur te vendi ku është  
vendosur... Sapo të marrë njoftimin e arrestimit të tij,  
punëtori operativ, së bashku me forcat, të niset me  
shpejtësi, gjoja sikur shkon në drejtim për nga Ku-  
kësi, të kapërcejë qafën e pyjeve të Konit nga krahu  
i djathtë, me qëllim që bandës t'i presë rrugën për  
në pyllin e lagjes Melth...

Pas tij foli komisari. Ai tha:

— Toga e parë (me të cilën do të shkonte edhe ai vetë) do të rrethojë lagjen Dardhë, toga e tretë lagjen Lari, ndërsa toga e dytë do të sigurojë me prita shtigjet.

Pastaj u përcaktoi togëkomandantëve taktikën që duhej të zbatonin, sidomos kur të jepej sinjali për rrethimin e bandës...

Në orën tre pas mesnate forcat e kompanisë u nisën. Jashtë të ftohtët ishte i madh. Kalonin në varg njëri pas tjetrit. Megjithëse ishte errësirë, bardhësia e borës ua vriste sytë dhe rruga u dukej e sheshtë.

Pas dy orësh rrugë, toga, ku bënte pjesë Hajdari, iu afrua lagjes Lari, që ishte ende në gjumë. Togëkomandanti dhe zëvendëskomandanti i postës caktuan vendet dhe bënë rrethimin e plotë. Hajdari, me katër ushtarë, u caktua te fundi i kreshtës së zhveshur, për të kapur Çekun.

Sa nisi të agonte forcat u vunë në lëvizje. Hajdari me të katër ushtarët qëndronte i fshehur pas drurëve të bredhave dhe vështronte drejt lagjes. Pritën aty një orë, po Çekun nuk po e shihnin.

Në këtë kohë zëvendëskomandanti i postës ecte rrëzë monopatin në drejtim të tyre.

— Duket se ai paska ikur, — tha një nga ushtarët.

— Mos lëvizni, se zëvendëskomandanti nuk ecën kot fshehurazi, — u foli Hajdari me ton urdhërues.

Zëvendëskomandanti mbërriti duke gulçuar, u fsheh prapa drurit të rrëzuar e filloi të vështronte me dylbi nga fshati. Pa i hequr ato nga sytë, ai buzëqeshi.

— Po vjen. Kini kujdes, — tha.



Ata ndiqnin me sy njeriun që ecte mbi borën e bardhë. Sopatën e kishte hedhur mbi sup dhe në dorë mbante një litar. Nxitonte. Te fundi i kreshtës, aty ku ishin të fshehur ushtarët, ai qëndroi dhe hodhi vështrimin nga lagjja ku dukeshin ushtarët që shkonin për nga shtëpia që ndodhej rrëzë malit. Pastaj me mëngën e xhaketës prej shajaku fërkoj ballin, pështyu mbi borë dhe eci drejt.

— Nga kështu, o Çek? — i foli zëvendëskomandanti i postës, që doli nga trangu ku rrinte fshehur. Ai qëndroi. Ia njohu zërin. — Ktheu kokën.

— Këtej, shoku komandant, — u përgjegj ai dhe bëri të ecte.

— Prit, mos nxito.

— Më shkoi vonë, — dhe shpejtoi këmbët.

Atë çast Hajdari dhe tre ushtarët iu hodhën dhe e mbërthyen.

— Aman, o shoku komandant, — briti ai.

— Mbylle gojën, qen i poshtër! — i tha zëvendëskomandanti me të rreptë dhe, si iu afrua, hoqi nga brezi prangat e i lidhi duart.

Pastaj caktoi një nga ushtarët të shkante të lajmëronte komisarën e punëtorin operativ për arrestimin e tij.

Pa e zgatur, zëvendëskomandanti iu drejtua Çekut.

— Çek, ku po shkoje?

— Të bëja dru, shoku komandant.

— Këtej ka pisha e bredha që është e ndaluar të priten.

— Do futesha thellë për nga pylli, Lugjeve të Këqinj.

— Përse shkon kaq larg, kur sipër në fshat ka ahe?

— Se janë dru të hollë, — shtoi ai, ndërsa buzët i dridheshin dhe fytyra i ishte bërë dyllë e verdhë.

Po zëvendëskomandanti nuk e la të mblidhte veten nga hutimi.

— Se në pyllin e Lugjeve të Këqinj është Gjoni me bandën e tij. Ti po shkon ta lajmërosh, siç ke bërë dhe herë të tjera. Ke kujtuar se mos na e ke hedhur, por ke qenë i gabuar. Folë! Ku janë? Dhe sa janë?

Çeku po dridhej. Uli kokën e qendroi i heshtur.

— Folë, — turfulloi zëvendëskomandanti i postës së policisë, gjithë inat.

— Janë tetë vetë atje te pylli i lugjeve të Këqinj.

— Duam vendin e saktë.

— Në pyll brenda, — tha pa forcë Çeku.

Zëvendëskomandanti vështroi shokët dhe tha:

— Po fryn erë e lehtë. Të ngjitemi te shkëmbi. Prej andej duket sipërfaqja e pyllit, — dhe nisi rrugën i pari.

Hajdari mori litarin, ia lidhi në brez Çekut dhe ia shtrëngoi krahët fort.

— Tani, po të duash, mundohu të ikësh, — mërmëriti ai dhe e tërhoqi për tu ngjitur mbi shkëmb.

Para tyre shtrihej pylli i dëndur e pa fund.

Komandanti i togës mbërriti bashkë me forcat. Caktoi tre ushtarë për të çuar të arrestuarin në postën e policisë dhe u nisën me shpejtësi drejt pyllit të Lugjeve të Këqinj.

Rruga e keqe e me të përpjeta po ua merrte frymën. Në afërsinë e një kreshte zëvendëskomandanti i policisë, që ishte i lindur dhe i rritur në këto vende, preu pak nga e djathta.



— Këtej rruga bize më shkurt, por është me rrezik.

— Udhëhiqna, — dhe komandanti i shkoi nga pas.

Përpara kishim një faqe mali të pjerrët që binte poshtë në përrua. Por asnjë nuk pyeti për rrezikun. Duke shkarë mbi borë njëri pas tjetrit me kujdes, toga zbriti në përrua dhe kaloi poshtë me vrap.

Pas një ore ata hynë në zonën e pyllit të Lugjeve të Këqinj me drurë të lartë e të dëndur bredhi, pishë dhe ahu. Gjatë dimrit erozioni kishte gërryer tokën dhe vendi që me gremina e shkëmbinj të thepisur.

Komandanti caktoi pritrat në varg gjer afër përrroit, pastaj vështroi poshtë:

— Hajdar, me katër ushtarët do të zësh grykën. Ki kujdes!

— Pas meje, — u foli Hajdari ushtarëve dhe nisi të zbriste poshtë.

Lart në mal gjëmuan krismat e armëve. Diver santët, sa kishin parë forcat në lagjen Lari, kishin braktisur strehimin dhe me shpejtësi ishin nisur për të kaluar në pyllin e Melthit. Por sipër te qafa kishin rënë në përpjekje me togën që kishte mbërritur pesë minuta më parë. Ata ishin hedhur në sulm, por zjarri i dëndur dhe vrasja e Zef Ndrecës, e detyruan bandën të tërhiqej e të zbriste poshtë përrroit.

Hajdari mbërriti te vendi, mirëpo aty u gjend në një situatë të paparashikuar. Shkëmbi e ndante përrroin në dy degëzime. Nuk kishte kohë të kërkonte ndihmë. Vendosi katër ushtarë në anën e majtë, ndërsa në degëzimin e vogël, në anë të shkëmbit, qëndroi vetë.

Përpara ishte pylli i dëndur. Zhurma që vinte nga lart po bëhej më e madhe. Diversantët, pa e ndalur vrapin, dhanë ballë tek degëzimi i vogël. Hajdari tërhoqi këmbëzën e automatikut. Zjarri i pandërprerë i detyroi ata të bëheshin njësh me tokën.

Në shkëmb plasën granatat dhe, në atë pësh-tjellim të madh, breshëritë e automatikëve nga të dy anët nuk pushuan së vjelluri zjarr. Diversantët u tërhoqën në thellësi. Aty buzë përroit, mbi borë, kishte mbetur i vdekur një prej tyre.

Hajdari u shtri përsëri nën shkëmb. Ai ishte i bindur se diversantët do të sulmonin. Hoqi nga brezi dy granatat e i vuri pranë vetes.

Po vështronte andej nga qenë tërhequr diversantët. Pas pak ata filluan të afroheshin duke u zvarrisur. Shtërngoi granatën me dorën e djathtë dhe tërhoqi siguresën. Ua hodhi mu përpara. Ajo plasi me krismë të madhe. Dheu, i përzier me borën e bardhë, u ngrit lart. Pastaj zbrazi drejt tyre automatikun me breshëri. Atë kohë në anë të shkëmbit, pranë tij, plasën tri granata. Iu shurdhuan veshët, por nuk lojti nga vendi. Ishte i bindur se diversantët kishin zbuluar se që i vetëm në pozicion dhe se do të sulmonin përsëri.

Me shpejtësi hoqi karikatoreën që ishte boshatisur dhe i futi tjetrën. Atë çast Gjoni, kryetari i bandës, doli nga prapa trungut të ahut dhe hodhi dy granata drejt shkëmbit. Ato plasën me gjëmim të madh. Kur u shpërnda tymi, Hajdari ngriti kokën. Banditët u hodhën në sulm, por ai i priti përsëri me breshërinë e automatikut. Gjoni briti dhe ra. Tre plumba kishin depërtuar në trupin e tij. Ata sulmuan përsëri me zjarr të dendur, por, kur e panë që



nuk çanin dot nga breshëria e automatikut që nuk pushonte aty te shkëmbi, banda u tërhoq në thellësi të pyllit. Hajdari vështroi drejt, atje ku kishte rënë Gjoni.

— E paskan tërhequr, — mermëriti dhe futi dorën në çantë. I kishin mbetur vetëm tri granata. Karikatorja e automatikut kishte ende dhe pak fishekë.

— Do t'i mbaj, gjersa të vijnë shokët, — mendoi i heshtur.

Në degëzimin e madh dëgjoi jehonën e shkëmbimit të armëve. Gryka e përroit pas tij ra në qetësinë e përhershme.

Lart, si në mjegull, dalloi forcat që zbrisnin duke shpejtuar, shtrëngoi fort automatikun, se e mori me mend që ndihma, për shkak të vendit të thyer, do të vinte me vonesë.

Edhe diversantët i vunë re forcat që vinin në drejtim të grykës së përroit nga të dy anët. Ata u turrën në degëzimin e ngushtë. Hajdari i priti me breshëri të gjata automatiku. Për një çast ata mbetën të mbërthyer në vend. Pastaj sulmuan të gjithë së bashku. Hajdari hodhi dy granata, pastaj nisi t'i qëllonte me breshëri automatiku, gjersa karikatorja u boshatis.

Atëhere rrëmbeu me shpejtësi granatën, i tërhoqi siguresën dhe po rrinte gati. «Jo, nuk do t'i lë» — tha me vete. — «Le të vdes...» Dhe, kur diversantët iu afruan fare pranë, ai u hodh mes tyre duke përplasur me forcë granatën në tokë.

Vendi u tund. Tre diversantë mbetën të vvarë. Hajdari ra përmbys.

Komandanti i togës dhe zëvendëskomandanti i postës, së bashku me forcat që kishin parë prej së

largu Hajdarin kur doli të shkëmbi, shpejtuan, por arritën vonë.

Komandanti i togës, për një çast, mbeti i ngrirë para trupit të Hajdarit. Pastaj mblodhi veten, i ktheu trupin nga ana e fytyrës dhe pa se ajo ishte mbuluar me gjak. Edhe bora përreth skiuqte nga gjaku.

— Hajdar! Hajdar! — i foli me zë të dridhur.

Po ai nuk jepte asnjë shenjë jete. Nga plaga e kokës vazhdonte t'i rridhte një curril i kuq.

Komandanti nuk ishte në gjendje të thoshte asnjë fjalë. Ai kishte shtrënguar nofullat që të mban-te lotët. Qëndronte si i mpirë me sytë të mbërthyer nga drurët e dëndur të Lugut. I doli përpara sysh Hajdari i shkrirë me trungjet e lartë. E pa ndenjor, të menduar, me ballin e rrudhur, ashtu siç rrinte sa herë që merrte ndonjë vendim serioz e më në fund me granatën në dorë, duke u hedhur mbi armiqtë...

E vështroi përsëri. Sytë e mbyllur i jepnin shprehjen e një fëmije që flinte. Gjaku i tharë mbi ballë e faqe nuk mund ta prishte këtë pamje.



Redaktor: SONJA VILA  
Kopertina: ZEF SHOSHI

Tirazhi 4.000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-72

---

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike  
Shtypshkronja «8 NENTORI» — Tiranë, 1973